



KOMANDA E DOKTRINËS DHE STËRVITJES

REVISTA USHTARAKE

**Organ teoriko–shkencor
i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes**

Nr. 3/2011

Tiranë, shtator 2011

Bordi i Botimit të Revistës Ushtarake

Miratuar me Urdhër të Ministrit të Mbrojtjes Nr. 1426, datë 05/09/2011

Kryetar

Gjeneral Brigade Prof. Asoc. Dr. Agim Lala

Anëtarë

Kolonel (R) Thimi Hudhra

Kolonel Perikli Koliçi

Gjen. Major (R) Prof. Dr. Ruzhdi Gjatoja

Gjen. Major (R) Prof. Dr. Kostaq Karoli

Redaktore

Silvana Markgjonaj

Përktheu në anglisht

Renalda Manushi

Operatore

Lindita Kuçana

Art design

Teuta Mullisi

Tirazhi

300 kopje

Copyright © 2010 nga Qendra e Analizave të Mbrojtjes (QAM) të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes).

Copyright © 2010 by the Centre for Defence Analyses (CDA) of the Albanian Training and Doctrine Command.

Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në Revistën Ushtarake janë tërësisht të autorëve dhe jo domosdoshmërisht reflektojnë politikat apo pozicionet zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm dhe Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes.

Autorët e shkrimeve të Revistës Ushtarake nuk do të jenë subjekt i ndëshkimit për shprehjen e lirë të qëndrimeve e pozicioneve të tyre individuale edhe sikur përmbajtja e tyre të mos jetë në përputhje me qëndrimet zyrtare të institucionit të mbrojtjes.

Autorët mbajnë përgjegjësi për shpifjet, shtrembërimet e fakteve, sharjet si dhe kopjimet e pa referuara të krijimeve dhe mendimeve të autorëve të tjerë.

Ky botim i Revistës Ushtarake gjendet në website <http://www.tradoc.mil.al/>

Në rast se nuk mund të merrni informacionin që kërkoni në internet lutemi të kërkoni një kopje të tij në adresën: e-mail: revistaushtarake@aaf.mil.al ose qam@aaf.mil.al

Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes

Qendra e Analizave të Mbrojtjes, Dega e Botimeve

PËRMBAJTJA

RUBRIKA E PARË: Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes

Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes

Për çfarë Skenarë duhet të përgatitet FA e RSH, si vend Aleat?

Kol. (R) Thimi Hudhra, MA. Adriatik Mema,

6 - 19

“Rishikimi i Strategjisë së Mbrojtjes”

Kolonel Tonin Marku

20 - 26

RUBRIKA E DYTË: Çështje të Arsimimit dhe Trajnimit të FASH

“Arsimimi në akademitë e mbrojtjes të vendeve europiane -Refleksione-”

Gj.M.(R)Shpëtim Spahiu, Kol. Kristaq Xharo

28 - 36

“Arsimi ushtarak Shqiptar përballë sfidave reale të integritetit”

Dr. Simon Gega

37 - 48

“Stërvitja dhe kaloritë në krijimin e trupit”

MSc. Valbona Zeka

49 - 55

“Komunikimi strategjik dhe rëndësia e tij”

Docent Jaup Zenuni

56 - 69

RUBRIKA E TRETË: Analiza, Sinteza dhe Vlerësime të Sigurisë

“Zhvillimi i doktrinës ushtarake në mjedisin e ndryshuar të sigurisë e të mbrojtjes”

Kolonel Ahmet Leka

71 - 78

“Kodi etik dhe lidhshipi”

Dr. Edmond Braneshi

79 - 86

“Doktrina Obama” - Lidhshipi strategjik global amerikan në skenën ndërkombëtare

Granit Zela

87 - 97

“Emigracioni ilegal, krimi i organizuar & terrorizmi”

Nën/Komisar Renaldo Ndoni

98 - 103

RUBRIKA E KATËRT: Studime historike

“Beteja e Fushë-Kosovës e vitit 1389 dhe arti i saj ushtarak”

Nënkolonel (R) Kadri Dauti

105 - 115

Përmbledhja në anglisht

Renalda Manushi

116 - 123

Kujtesë për bashkëpunëtorët e Revistës Ushtarake

124

RUBRIKA E PARË

RISHIKIMI STRATEGJIK I MBROJTJES

Në këtë rubrikë, Revista Ushtarake vazhdon të informojë lexuesin mbi zhvillimet e fundit në procesin e Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes (RSM) që po kryhet në Republikën e Shqipërisë. Rishikimi Strategjik është aktualisht në Fazën e Tretë të tij: atë të zhvillimit të Skenarëve të angazhimit të Forcave të Armatosura në vitet e ardhshme.

Kjo rubrikë jep mendime origjinale të autorëve se si mund të aktualizohen skenarët e përdorimit të FA për situatën e re të integritit në Aleancë. Rubrika trajton përjasjen e ndjekur në këtë fazë të RSM për zhvillimin e një pakete të skenarëve të ardhshëm, mbi të cilët do të bazohet reforma e organizimit, e trajnimit dhe pajisjes së kapaciteteve të forcës së ardhshme.

Po ashtu, në këtë rubrikë jepen mendime për përmirësimin e dokumenteve strategjike të sigurisë dhe të mbrojtjes së vendit, në përputhje me mesazhet e Konceptit të ri Strategjik të Lisbonës dhe Direktivës Politike të Aleancës. Dokumentet aktuale të sigurisë dhe të mbrojtjes së vendit janë aktualisht në proces ripunimi, kështu që shkrimet e kësaj rubrike mund të ndihmojnë grupet e punës të ngritura për këtë qëllim.

Me këtë rast, të gjithë lexuesit janë të mirëpritur të kontribuojnë me mendimet e tyre në këtë proces të zhvillimit të dokumenteve strategjike

Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes

Për çfarë Skenarë duhet të përgatiten FA të RSH, si vend Aleat?

Kol. (R) Thimi Hudhra,
Shef i Qendrës së Analizave të Mbrojtjes
MA. Adriatik Mema,
Drejtor i Përgjithshëm i Politikave të Sigurisë dhe të Mbrojtjes, MM

Abstrakt. *Lexuesit e Revistës Ushtarake janë vënë në dijeni mbi procesin e Rishikimit Strategjik që po kryhet në Republikën e Shqipërisë. Ky Rishikim po kryhet në përputhje me mesazhet e Konceptit të ri Strategjik të Lisbonës dhe Direktivës Politike të Aleancës.*

Rishikimi Strategjik po kryhet nën drejtimin e Grupit të Rishikimit Strategjik (RSM) të Ministrisë së Mbrojtjes, me pjesëmarrjen e të gjithë institucioneve të tjera të sigurisë së vendit dhe në bashkëpunim me një ekip amerikan, të mbështetur nga Departamenti i Mbrojtjes i SHBA.

Rishikim Strategjik është aktualisht në Fazën e Tretë të tij: atë të zhvillimit të Skenarëve të angazhimit të Forcave të Armatosura në vitet e ardhshme. Shqipëria ka pasur deri tani skenarë si vend partner dhe aspirant, por ato janë relativisht të paaktualizuara për situatën e re të integritetit.

Synimi i autorëve është të japin një panoramë të përgjithshme të planifikimit të skenarëve strategjikë dhe operacionalë të përfshirjes së FA të RSH, si vend anëtar i NATO-s. Zhvillimi i një pakete/ seti skenarësh sa më realë do të orientojë drejt reformat për zhvillimin e kapaciteteve ushtarake dhe civile të mbrojtjes për 10 vitet e ardhshme.

Ky artikull trajton pikërisht përfaqsimin e ndjekur në këtë fazë të RSM për zhvillimin e një pakete të skenarëve të ardhshme, mbi të cilat do të organizohet, trajtohet dhe pajiset forca e ardhshme. Të gjithë lexuesit janë të mirëpritur të kontribuojnë me mendimet e tyre në këtë proces.

Hyrje

Anëtarësimi 'de jure' në Aleancë dhe, më vonë, edhe në BE, sjell një etapë të re në planifikimin e skenarëve ku mund të angazhohen njësitë e FA në vitet e ardhshme. Faza e mëparshme e statusit të vendit partner dhe aspirant ka shërbyer si një fazë përgatitore me vlera të konsiderueshme.

Pjesëmarrja në misionet e Forcave të Armatosura, në dy dekadat e fundit, ka pësuar një dinamikë të paparashikueshme. Çdokush mund të befasohet nga harta e skenarëve të angazhimit të tyre në këtë periudhë, në tre kontinente, me rreth 6000 forca gjithsej. As planifikuesi më optimist nuk mund të parashikonte këtë angazhim 20 vite më parë.

Me këtë retrospektivë në mendje, është normale të ngremë një perspektivë përpara si vend aleat dhe të bëjmë pyetjen: Cila mund të jetë harta e skenarëve të angazhimit të njësitë të FA në vitin 2020? Po ashtu, cilat mund të jenë në sasi dhe cilësi kapacitetet e forcës së ardhshme të FA? Sa prej tyre mund të angazhohen jashtë vendit dhe sa brenda vendit? Sa prej tyre luftarake, sa për përgjigjen ndaj krizave, dhe sa për emergjencat civile?

Këto janë disa nga pyetjet që do t'iu jepet përgjigje nëpërmjet Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes. Tani, si vend aleat, duhet ta bëjmë këtë gjë në mënyrë shumë më të organizuar se 20 vite më parë. Spektri i operacioneve të sotme është zgjeruar ndjeshëm, ai i operacioneve të ardhme parashikohet të bëhet akoma më i gjerë. Vendi ynë nuk i ka as mundësitë dhe as luksin të zhvillojë një forcë të armatosur që të bëjë gjithçka. Sot, sidomos për vendet e vogla, kërkohen forca të armatosura të fokusuara në module të specializuara, për të bërë vetëm ato misione që kërkohen me përparësi nga vendimmarrësit e tyre politikë.

Në logjikën e mësipërme, zhvillimi i të gjitha llojeve të kapaciteteve ushtarake do të ishte absurd dhe i pamundur. Përparësi duhet të ketë zhvillimi i atyre kapaciteteve që kanë probabilitet të lartë për t'u përdorur, ndërsa të tjerat mund të mos zhvillohen apo të lihen për një periudhë të mëvonshme. Koncepti i përdorueshmërisë (*usability*) së forcës është vendimtar në kushtet e resurseve të kufizuara. Ky është edhe thelbi i planifikimit të forcës të bazuar mbi skenarët dhe mbi kapacitetet e nevojshme për përballimin e tyre.

Skenarët e Planëzimit

Shumë autorë ia atribuojnë futjen në përdorim të skenarëve studiuesit Herman Kan (Herman Kahn)¹, themeluesit të Institutit Hudson, në vitet 1950 kur punonte në korporatën RAND për Departamentin e Mbrojtjes së SHBA. Ai zhvilloi teknikat e përshkrimit të alternativave të së ardhmes nëpërmjet përdorimit të skenarëve. “*Skenari është përshkrim i një situatë që parashikohet me gjasa të përafërta se mund të ndodhë në të ardhmen*”².

Sot, planifikimi i bazuar mbi skenarë është një metodë e planifikimit strategjik që përdoret nga organizata të ndryshme për të zhvilluar plane afatgjata, me fleksibilitet të lartë. Teorikisht, është e pamundur të përcaktohen qysh sot me saktësi të plotë të gjithë skenarët e së ardhshmes. Ajo që mund të bëhet është përcaktimi me përafërsi i spektrit të skenarëve që rrjedhin nga roli dhe misioni i FA si dhe i forcave që nevojiten për angazhimin e suksesshëm në to.

Cilat janë disa nga karakteristikat e skenarëve të ardhshëm të angazhimit të FA:

- *Në pikëpamje të përqsjes*, skenarët e përfshirjes së FA të vendit tonë mund t'i ndajmë në dy grupime: grupi i parë i skenarëve janë operacionet ku forca e armatosur do të veprojnë së bashku me aleatët (NATO/BE/OKB/Koalicione), ndërsa grupi i dytë janë operacionet ku forcat e armatosura do të veprojnë më vete.
- *Në pikëpamje të nivelit*, skenarët e përfshirjes së FA të vendit tonë mund t'i ndajmë përsëri në dy kategori: kategoria e parë e skenarëve është e *natyrës politiko-ushtarake* të nivelit strategjik, ndërsa kategoria e dytë është e *natyrës ushtarake* dhe përfshin nivelin strategjik, operativ dhe taktik.
- *Në pikëpamje të mundësisë së ndodhjes*, skenarët e përfshirjes së FA të vendit tonë mund t'i klasifikojmë në dy lloje: *në skenarë realë* (real) të cilët ka më shumë gjasa të ndodhin me kundërshtarë realë, në situata reale dhe në rajone konkretë si dhe në *skenarë të përgjithshëm* (*generic*) të cilët ka mundësi të ndodhin në përgjithësi, por jo në situata e rajone reale, por kryesisht fiktive.

Misioni kushtetues ka qenë dhe do të mbetet shtylla kurrizore e skenarëve kryesorë të përdorimit të njëjësive të forcave të armatosura. Si vend aleat, misioni kushtetues i Forcave të Armatosura ngelet i njëjtë, por mënyra e përmbushjes së tij do të pësojë ndryshime në përputhje me situatën e re të mbrojtjes kolektive dhe të integritimit. Ai duhet të përkthehet me

realizëm dhe krijimtari në skenarë strategjikë realë për përdorimin e njësive të FA të RSH brenda dhe jashtë vendit.

Në këtë kontekst, rekomandojmë që seti i skenarëve strategjikë të planëzimit të FA të ruajë një ndarje logjike që i përgjigjet situatës së sotme të kryerjes së misionëve të tyre, brenda dhe jashtë vendit. Pra, për lehtësi studimi, fushat e skenarëve strategjikë mund të organizohen me grupe nën-skenarësh, të cilat mund të jenë: nën-skenarë për mbrojtjen e vendit dhe mbrojtjen kolektive; nën-skenarë për kontributin në përgjigje të krizave ndërkombëtare; nën-skenarë për përballimin e emergjencave civile si dhe nën-skenarë për operacione të mëvetësishme të FA.

Të dy llojet e para të skenarëve nuk do të kryhen asnjëherë më vete, por si pjesë e operacioneve ndërkombëtare, pra të drejtuara nga NATO, BE, OKB, apo Koalicione, etj. Llojet e tjera të skenarëve do të kryhen në mbështetje të, ose në bashkëpunim me institucionet e agjencitë e tjera kombëtare të sigurisë, ku sipas rastit, FA mund të kenë rol drejtues ose mbështetës.

Misioni Kushtetues i FA

Sipas Kushtetutës së RSH, misioni i Forcave të Armatosura është **“Ruajtja e sovranitetit, pavarësisë dhe integritetit territorial të Republikës së Shqipërisë; mbrojtja dhe mbështetja e popullit në kohë paqjeje, krize e luftime; dhënia e kontributit për paqen dhe sigurinë në rajon e më gjerë”**³

Siç shihet, misioni kushtetues i FA të RSH ka tre shtylla kryesore: *shtylla e parë* është misioni klasik i çdo force të armatosur, pra, sovraniteti, pavarësia dhe integriteti nga jashtë; *shtylla e dytë* ka të bëjë me kontributet brenda vendit për mbrojtjen dhe mbështetjen e popullit shqiptar dhe *shtylla e tretë* e misionit lidhet me kontributin për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.

Para anëtarësimit në NATO, përmbushja e misionit kushtetues binte tërësisht mbi FA të RSH dhe pavarësisht ecjes përpara të vendit tonë si vend partner dhe aspirant, Aleanca nuk kishte ndonjë detyrim ‘*de jure*’ për mbrojtjen e pavarësisë, sovranitetit apo integritetit territorial të vendit tonë, përveç konsultimeve që rrjedhin nga Dokumenti Kuadër i PFP⁴.

Me anëtarësimin në NATO dhe afrimin drejt BE-së, megjithëse misioni i FA të RSH ngelet i njëjtë, ndryshe nga më parë, një pjesë e konsiderueshme e këtij misioni do të përfitohet nga siguria dhe mbrojtja kolektive. Po ashtu, zgjerohen njëkohësisht edhe detyrimet dhe kontributet e vendit ndaj mbrojtjes dhe sigurisë kolektive. Misioni i FA bëhet më i larmishëm në formë dhe më dinamik në përmbajtje se më parë.

Pikërisht ky është edhe synimi kryesor i këtij shkrimi. Ai synon t’i japë përgjigje pyetjeve që kanë të bëjnë me mënyrën se si do të përmbushet misioni i forcave të armatosura të RSH tani si vend anëtar i NATO-s. Çfarë ndryshon në përmbushjen e misionit, krahasuar me statusin e kaluar të vendit partner dhe aspirant, etj? Çfarë skenarë të rinj duhet të zhvillojmë e çfarë skenarë të vjetër duhet të ndryshojmë? Cila mund të jetë një paketë e re e skenarëve politiko-strategjikë dhe ushtarakë të vendit tonë mbi të cilën duhet të organizohen, trajnohen, pajisen dhe përgatiten njësitë e FA të RSH për sot e për të ardhmen? Jemi në kohën e duhur t’i japim përgjigje të organizuar këtyre pyetjeve nëpërmjet Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes.

Vetë NATO, si institucion i sigurisë dhe mbrojtjes kolektive, ka 3 lloje misionesh,⁵ me 17 detyra kryesore dhe me 39 skenarë/ situata planëzimi brenda dhe përtej zonës Euroatlantike. Ashtu siç mbrojtja kolektive e Aleancës ka detyrimet e saj ndaj sigurisë dhe mbrojtjes

individuale të vendeve anëtare, edhe vendet anëtare kanë detyrime ndaj sigurisë dhe mbrojtjes kolektive.

Mbi këtë koncept, pra të balancës së përfitimit dhe kontributeve të mbrojtjes kolektive, në vijim rekomandojmë një paketë të skenarëve strategjikë më të mundshëm të angazhimit të FA të RSH, si dhe të institucioneve të tjera të sigurisë kombëtare. Këta skenarë planëzimi përfshijnë të gjithë spektrin e misionit të tyre, qysh prej planëzimit të operacioneve të mëvehtësishme kombëtare e deri tek pjesëmarrja në operacionet e mbrojtjes kolektive të Traktatit të Atlantikut të Veriut, të BE, të OKB, e të Koalicioneve të ndryshme, nën konceptin e një “*single set of forces*”.

Këta skenarë strategjikë mund të jenë ‘realë’ ose ‘të përgjithshëm’, bazuar në tendencat e zhvillimeve të mjedisit të sigurisë dhe sensitivitetin e tyre. Projekti i mëposhtëm parashikon një paketë të skenarëve të planëzimit strategjik të angazhimit të institucionit të FA të RSH, ndërsa për angazhimin e institucioneve të tjera të sigurisë mund të kërkohet një trajtim i mëtejshëm nga ekspertë të fushave specifike.

Skenarët e planëzimit politiko-strategjik të mëposhtëm janë orientues kryesorë për zhvillimin e kapaciteteve përkatëse (*Force/Capability Requirements*) të forcës së ardhshme të FA të RSH si dhe të institucioneve të tjera të sigurisë. Kërkesat e forcës për çdo skenar të veçantë do të bëhen bazuar në zhvillimin e kapaciteteve modulare sipas ‘*Capability Codes and Statements*’⁶ dhe secilit prej 7 Kapaciteteve Kryesore Operacionale (EOC).

Po ashtu, skenarët e planëzimit do të përcaktojnë edhe nivelin e gatishmërisë së nevojshme të forcave për çdo skenar, në veçanti dhe si forcë e armatosur, në tërësi. Bazuar në skenarët e planëzuara do të përcaktohet sa kapacitete duhet të jenë të reagimit të shpejtë (HRF), sa duhet të jenë të gatishmërisë më të ulët (FLR) dhe sa të gatishmërisë afatgjatë ose rezervë (LTBF). Në zhvillimin e forcës objektiv 2020, duhet të mbajmë në konsideratë ndërtimin e një sistemi të organizuar të gatishmërisë së forcave, duke mbajtur në konsideratë që forcat e gatishmërisë së lartë kanë kosto shumë më të lartë se forcat e tjera.

Skenarët strategjikë do të shërbejnë gjithashtu si ‘*drivers*’ për detajimin e mëtejshëm të tyre në skenarë operacionale, të cilët kërkojnë përfshirjen e stafëve civilë dhe ushtarakë të nivelit strategjik, operativ dhe taktik. Me miratimin e skenarëve strategjikë, të gjitha institucionet përkatëse të sigurisë së vendit do të zhvillojnë planet operacionale të zbatimit të tyre. Si rregull, çdo skenar strategjik do të zhvillohet më tej në plane operacionale nga institucioni që është ‘*në drejtim*’ të skenarit përkatës, ndërsa institucionet që janë në mbështetje do të zhvillojnë pjesën e tyre të planit të mbështetjes. Skenarët operacionale do të testohen në stërvitje të ndryshme ndër-agjenci apo të institucionit përkatës.

Në Forcat e Armatosura, skenarët strategjikë do të përpunohen nga Shtabi i Përgjithshëm, skenarët operacionale nga komandat e forcave (ose QBO) dhe skenarët taktikë nga niveli brigadë/ batalion e poshtë. Koncepti dhe përmbajtja kryesore e veprimit të FA do të bëhet nëpërmjet formatit të organizimit të forcës së bashkuar për detyrën, pra të forcës modulare të tipit “*joint task force*”

Bazuar në një mjedis të ri të sigurisë kolektive dhe kombëtare të RSH, rekomandojmë marrjen në konsideratë të paketës/setit prej 5 skenarësh strategjikë dhe 23 skenarësh operacionale të angazhimit të FA të RSH dhe të institucioneve të tjera të sigurisë së vendit. Këto skenarë janë organizuar në këtë mënyrë për lehtësi studimi, në interes të përmbajtjes së tyre, por nuk përjashtohet mundësia e organizimit të tyre në formate të tjera:

Skenari Strategjik Nr. 1: Mbrojtja e vendit në kuadrin e mbrojtjes kolektive të NATO-s (Neni 5) dhe organizmave të tjera të sigurisë ndërkombëtare.

Fusha e Skenarit Strategjik Nr. 1 mund të përfshijë zhvillimin dhe planëzimin e disa nën-skenarëve më të mundshëm që rrjedhin nga neni 5 i Traktatit të Atlantikut të Veriut, përsa i përket përfshirjes së Aleancës së NATO-s në sigurinë dhe mbrojtjen e vendit tonë (*më vonë edhe të ESDP*), në rast të një situatë të një kërcënimi të përshkallëzuar ndaj vendit tonë, apo ndaj një grupi vendesh aleate të rajonit tonë.

Këto nënskenarë do të zhvillohen në bashkëpunim me komandën e SHAPE-it dhe shtabin përkatës të Aleancës. Këto skenarë do t'i vihen në dispozicion vendit tonë kur të kryhet planëzimi i mbrojtjes kolektive të shteteve të rajonit tonë, përfshirë edhe Shqipërinë. Nga këto skenarë aleate, ne duhet të planifikojmë operacionet e forcave tona, në kuadrin e planifikimit të përgjithshëm aleat. Si operacione të nenit 5 (CONPLAN apo SDP⁷), në përputhje me përshkallëzimin e mundshëm të konfliktit, planëzuesit tanë duhet të planëzojnë pjesëmarrjen e forcave tona në një '*Operacion të Madh Joint - MJO*' të Aleancës, por nuk duhet të përjashtohet mundësia e angazhimit deri në '*Operacion të Vogël Joint - SJO*'⁸.

Përveç sa më sipër, kjo nuk do të thotë që ne nuk duhet të përgatitemi për të reaguar shpejt dhe me forca të caktuara në drejtime të caktuara për të penguar/vonuar forcat e një kundërshtari të mundshëm, deri në ardhjen e forcave të Aleancës, pas arritjes së aktivizimit të vendimmarrjes së mbrojtjes kolektive. Edhe ky skenar duhet të vlerësohet si një nga skenarët më të vështirë për frenimin e një kundërshtari të mundshëm.

Duke qenë se operacionet e mbrojtjes së vendit, në kuadrin e mbrojtjes kolektive (neni 5), janë të natyrës ushtarake, edhe skenarët e tyre duhet të jenë të natyrës ushtarake. Këta skenarë duhet të zhvillohen nga Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Komandën e SHAPE-it⁹ apo atë të komponentit rajonal (JFC Naples). Pjesëmarrja e forcave në këtë tip skenari nga ana jonë do të jetë në nivelin maksimal të pjesëmarrjes së forcave kombëtare (*aktive dhe rezervë!!*). Kështu që skenarët do të kenë, përveç situatës së përgjithshme politiko-ushtarake të ndodhjes së tyre, edhe implikimet ushtarake të përfshirjes së forcave kundërshtarë dy shkallë më lart.

Lloji i Operacioneve do të jetë i natyrës luftarake, por që mund të shoqërohen edhe me operacione të tjera të gjithë spektrit të operacioneve, në përgjigje të krizave. Natyra e Operacioneve do të jetë multinacionale, pra do të dominohet nga operacionet '*joint*' dhe '*combined*' të Aleancës/ Koalicionit. Komandim-kontrolli do të jetë transferuar si OPCOM¹⁰ komandës eprorë të SHAPE-it, ndërsa FULLCOM do të jetë në duart e Komandantit të Përgjithshëm të FA.

Largësia e Operacioneve të forcave tona do të jetë kryesisht brenda kufijve kombëtarë, por sipas misionit të përgjithshëm aleat, ajo mund të dalë edhe përtej kufijve kombëtarë. Operacionet kryesore në nivel strategjik, operativ dhe taktik do të jenë mbrojtja, mësymja, pengimi, operacione të emergjencave civile, etj.

Forcat pjesëmarrëse do të jenë forca të luftimit, të mbështetjes së luftimit dhe të mbështetjes me shërbime. Do të ketë gjithashtu edhe pjesëmarrje të kufizuar të forcave për menaxhimin e emergjencave civile, brenda dhe jashtë forcave të armatosura.

Sasia e përgjithshme e nënskenarëve të këtij lloji që mund të planëzohen mund të jetë deri 8 nën-skenarë përfaqësues operacionalë. Kërkesat e forcës për çdo nënskenar do të llogariten sipas 7 elementëve themelorë operacionalë (EOC) dhe kodit të kapaciteteve. Bazuar në

situatën konkrete, 1 prej këtyre skenarëve operacionalë mund të jetë ‘real’ dhe 1 mund të jetë ‘i përgjithshëm’. Nënshkenarët operacionalë të fushës së këtij skenari strategjik mund të jenë:

- a) *Një Nënshkenar i nenit 5, kur vendi ynë mund të përfshihet në konflikt si pasojë e një agresioni strategjik ndaj Aleancës në tërësi ose një grupi shtetesh aleate, ndër të cilat edhe vendi ynë;*
- b) *Një Nënshkenar i nenit 5, kur vendi ynë mund të përfshihet në një situatë konfliktuale si pasojë e një situatë rajonale të paqëndrueshme;*

Skenari Strategjik Nr. 2: Kontributi për sigurinë dhe mbrojtjen kolektive të Aleancës në kuadrin e nenit 5.

Fusha e Skenarit Strategjik Nr. 2 mund të përfshijë zhvillimin dhe planëzimin e një apo disa nën-skenarëve më të mundshëm që rrjedhin si detyrime të vendit tonë, në kuadrin e nenit 5 të Traktatit të Atlantikut të Veriut (*më vonë edhe të ESDP¹¹*), përsa i përket pjesëmarrjes së njësisive të Forcave tona të Armatosura në sigurinë dhe mbrojtjen e vendeve të tjera të Aleancës, brenda zonës së saj të përgjegjesisë.

Duke qenë se pjesëmarrja në operacionet e mbrojtjes kolektive (neni 5) të territoreve të Aleancës janë të natyrës ushtarake, edhe skenarët e tyre duhet të jenë të natyrës ushtarake. Këta nënshkenarë duhet të zhvillohen nga Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me Komandën e SHAPE-it apo atë të komponentit rajonal (JFC Naples). Këto nënshkenarë do t’i vihen në dispozicion vendit tonë në kohën e duhur, në kuadrin e planifikimit të përgjithshëm aleat.

Ndonjë prej këtyre skenarëve mund të jetë ‘real’, duke pasur parasysh skenarin përkatës të Aleancës për përdorimin e grup-batalionit tonë sipas FG 0035. Po kështu, ndonjë skenar tjetër mund të jetë ‘i përgjithshëm’, duke pasur parasysh një skenar tjetër të angazhimit të Aleancës në periferi apo larg territoreve të saj (pra mund të bëhet në një teatër të caktuar, por mund të përdoret për të gjithë territorin e Aleancës). Në këtë tip nënshkenarësh, forcat tona do të jenë pjesë përbërëse e zbatimit të ‘CONPLAN’ apo ‘SDP’¹² të nenit 5 të komandës së SHAPE-it për mbrojtjen e territoreve aleate. Në përputhje me përshkallëzimin e mundshëm të konfliktit, planë-zuesit tanë duhet të përgatiten të planëzojnë pjesëmarrjen e forcave tona deri dy shkallë më lart, pra në ‘Operacione të Mëdha Joint - MJO’ të Aleancës (*Korpus plus*), por nuk përjashtohet mundësia e ‘Operacioneve të Vogla Joint - SJO’ (*Brigadë plus*).

Pjesëmarrja e forcave tona në këtë tip skenari do të jetë e llojit ‘task force’ të nivelit të grup batalionit, sipas objektivit të forcës FG 0035, por ky grupim taktik mund të organizohet sipas misionit konkret. Lloji i operacioneve mund të jetë sipas atyre të parashikuara në nenin 5 apo jashtë nenit 5, por do të tentojnë të jenë operacione të mirëfillta luftarake, të kryera në kushte të vështira të motit dhe të terrenit. Këto do të jenë operacionet më të vështira të njësisive të Forcave të Armatosura, jashtë territoreve të vendit.

Lloji i Operacioneve do të jetë kryesisht luftarak, por nuk përjashtohet mundësia që, në etapa të ndryshme të operacionit, të nevojiten edhe forca të operacioneve ndryshe nga lufta. Forcat pjesëmarrëse do të jenë forca të luftimit, të mbështetjes së luftimit dhe të mbështetjes me shërbime. Nuk përjashtohet mundësia e përdorimit të kapaciteteve civile në fazat e fundit të konfliktit dhe të paskonfliktit, për ndërtimin e institucioneve dhe zhvillimin e vendit të konfliktit.

Largësia e Operacioneve do të jetë kryesisht larg territoreve kombëtare, kryesisht në kufijtë e territoreve të Aleancës ose përtej tyre. Kërkesat e forcës për çdo nënshkenar do të llogariten

sipas 7 elementëve themelorë operacionalë (EOC) dhe kodit të kapaciteteve. Sasia e nënskenarëve të këtij skenari strategjik mund të jetë 1 skenar i përgjithshëm ‘generic’:

- a) *Një Nënskenar i kontributit të vendit tonë, në kuadrin e detyrimeve të nenit 5 të mbrojtjes kolektive, nëse sulmohet një nga vendet e Aleancës.*

Skenari Strategjik Nr. 3: Kontributi në Operacione, në Mbështetje të Paqes, të drejtuara nga Aleanca dhe organizma të tjerë të sigurisë, jashtë zonës së tyre të përgjegjësisë (NA5CRO).

Fusha e Skenarit Strategjik Nr. 3 mund të përfshijë planëzimin dhe pjesëmarrjen në disa nga nënskenarët më të mundshëm që rrjedhin nga Traktati i Atlantikut të Veriut, përvoja e përkjet Operacioneve të Mbështetjeve të Paqes, të drejtuara nga Aleanca “jashtë nenit 5” të Traktatit të Uashingtonit, jashtë zonës së saj të përgjegjësisë në nenin 5. Po ashtu, këtu mund të përfshihen edhe skenarë të mundshëm të pjesëmarrjes në operacionet e drejtuara nga BE, OKB, apo Koalicione të Përbashkëta.

Duke qenë se pjesëmarrja në Operacionet e Mbështetjes së Paqes është e natyrës civilo-ushtarake, edhe skenarët e tyre duhet të jenë të natyrës civilo-ushtarake. Këta skenarë duhet të zhvillohen nga Ministria e Jashtme me Ministrinë e Mbrojtjes, në bashkëpunim me strukturat përkatëse në NATO HQ, si dhe Komandën e SHAPE-it apo atë të komponentit rajonal (JFC Naples). Nëse operacioni drejtohet nga një organizëm tjetër ndërkombëtar, ndiqet e njëjta strukturë e zhvillimit dhe zbatimit të skenarëve.

Gjykoj që pjesëmarrja më e madhe e forcave ushtarake në këtë tip skenari të jetë e llojit ‘task force’ e nivelit deri në kompani, ose kapacitete të specializuara ‘niche’. Skenarët do të kenë përveçse situatat e përgjithshme politiko-ushtarake të ndodhjes së tyre, edhe implikimet ushtarake të përfshirjes së forcave dy shkallë më lart, pra në nivel të Brigadës. Pjesëmarrja e kapaciteteve civile do të bëhet rast pas rasti, sipas angazhimit dhe mundësive konkrete të vendit tonë për kontributin në operacionin konkret, bazuar në Objektivat e Forcës për Stabilizim dhe Rindërtim.

Ndonjë prej këtyre skenarëve mund të jetë ‘real’ duke pasur parasysh skenarin përkatës të Aleancës ku mund të përdoren nënrepartet tona të FASH (duhet të nxirren nga SDP ose CONPLANS të Aleancës). Po kështu, ndonjë tjetër mund të jetë ‘i përgjithshëm’, duke pasur parasysh një skenar tjetër të angazhimit të Aleancës në periferi apo larg territoreve të saj (pra mund të bëhet në një teatër të caktuar, por mund të përdoret për të gjithë territorin e Aleancës). Skenarë të tjerë mund të përfshijnë pjesëmarrjen në operacione të Bashkimit Europian, në operacione të Kombeve të Bashkuara apo Koalicioneve të ndryshme.

Natyra e Operacioneve do të jetë multinacionale, pra do të dominohet nga operacionet ‘joint’ dhe ‘combined’ të Aleancës/ Koalicionit. Komandim-kontrollit operacional. OPCOM do të transferohet zakonisht pranë komandës eprore të SHAPE/ komandës së operacionit aleat. Planëzuesit tanë duhet të përgatiten kryesisht për pjesëmarrje të forcave tona në një ‘Operacion të Vogël Joint – SJO’ të Aleancës, por me tendencë deri në ‘Operacion të Madh Joint – MJO’ të saj.

Lloji i Operacioneve do të jetë operacione në përgjigje të krizave që variojnë në një spektër të gjerë ku plekset lufta dhe paqja, kështu që forcat duhet të jenë të përgatitura për ‘full spectrum operations’.

Largësia e Operacioneve do të jetë jashtë kufijve kombëtarë dhe territoreve të Aleancës, kryesisht në zona të largëta të krizave rajonale dhe globale. Forcat pjesëmarrëse do të jenë forca të luftimit, të mbështetjes së luftimit dhe të mbështetjes me shërbime. Do të ketë

gjithashtu edhe pjesëmarrje të kufizuar të forcave për menaxhimin e emergjencave civile në teatrin e operacionit.

Kërkesat e forcës për çdo nënskenar do të llogariten sipas 7 elementëve themelorë operacionalë (EOC) dhe kodit të kapaciteteve. Ky skenar strategjik mund të përkthehet në një sasi prej 3 nën-skenarësh operacionalë, të gjithë të natyrës ‘të përgjithshëm’:

- a) *Një Nënskenar, bazuar në skenarët e Operacioneve në Përgjigje të Kri-zave të Aleancës, mbi bazën e planeve SDP dhe CONPLANS të NATO-s;*
- b) *Një Nënskenar, bazuar në skenarët e Operacioneve në Përgjigje të Kri-zave të Bashkimit Europian mbi bazën e Planeve të Kontingjencave të BE-së;*
- c) *Një Nënskenar, bazuar në skenarët e Operacioneve në Përgjigje të Kri-zave të Kombeve të Bashkuara, mbi bazën e Planeve të Kontingjencave të OKB-së.*

Skenari Strategjik Nr. 4: Angazhimi i FA në Operacionet e Emergjencave Ci-vile (EC) Kombëtare, në mbështetje të autoriteteve civile.

Fusha e Skenarit Strategjik Nr. 4 mund të përfshijë zhvillimin dhe planëzimin e disa nën-skenarëve të parashikuar në setin e rreziqeve dhe kërcënimeve të shprehura në Planin e Emergjencave Civile kombëtare, n, përputhje me ligjin n, fuqi (*emergjencat civile natyrore, industriale, apo të shkaktuara nga njeriu*).

Normalisht, Forcat e Armatosura planëzojnë dhe ofrojnë mbështetje të autoriteteve kombëtare, kur emergjencat civile i kalojnë mundësitë dhe kapacitetet e institucioneve të tjera, të caktuara me ligj për këto misione. Sipas shkallës së emergjencave civile, angazhimi i FA në operacionet në mbështetje të autoriteteve civile mund të jetë proporcional dhe në nivel strategjik, operativ dhe taktik.

Disa prej skenarëve të emergjencave civile, kryesisht ata natyrorë, mund të jenë ‘realë’ duke pasur parasysh rajonet dhe intensitetin e ndodhjes së tyre sipas statistikave në 100-200 vitet e fundit (*mund të përmendim këtu tërmetet, përmbytjet, borën e madhe, zjarret, rrëshqitjet masive të dheut, aksidentet e mëdha natyrore, industriale, etj*). Disa të tjerë mund të jenë ‘të përgjithshëm’, duke pasur parasysh ata aksidentalë nga njeriu apo industrialë në zona me densitet të lartë industrial dhe njerëzor (*pra ata mund të planëzohen në një teatër të caktuar, por mund të përdoren si model për të gjithë territorin e vendit me veçoritë përkatëse*).

Zakonisht, forcat e armatosura, në këto lloje operacionesh, do të organizohen sipas formatit të forcës për detyrën ‘*task force*’ të nivelit kompani e lart, kështu që skenarët do të kenë përveçse situatat e përgjithshme politiko-ushtarake të ndodhjes së tyre, edhe implikimet ushtarake të përfshirjes së forcave dy shkallë më lart, pra në nivel të ‘*task force*’-s së grup-batalionit të përforcuar e lart.

Duke qenë se operacionet e emergjencave civile janë të natyrës jo-luftarake, edhe skenarët e tyre janë të natyrës jo-ushtarake. Këta skenarë duhet të zhvillohen nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile). Përgatitja dhe pjesëmarrja në këto operacione, e të gjithë aktorëve shtetërorë në përballimin e emergjencave civile, bëhet bazuar në ligj të veçantë. Njësitë e Forcave të Armatosura, përveçse në rastet e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, nuk duhet të jenë në krye të operacionit. Nga ana tjetër, njësitë e forcave të armatosura do të ruajnë zinxhirin e komandim-kontrollit ushtarak, bazuar në misionin e marrë nga plani i

përgjithshëm i operacionit, të drejtuar nga autoritetet civile.

Natyrë e Operacioneve të emergjencave civile do të imponojë që, për këto operacione, duhet, qysh në kohë paqeje, të ketë planëzim të përbashkët, rikonjicione të përbashkëta, trajnime dhe stërvitje të përbashkëta si dhe standardizim të pajisjeve të nevojshme për operacione të tilla.

Largësia e Operacioneve do të jetë kryesisht brenda kufijve kombëtare, por nuk përjashtohet mundësia e kryerjes së tyre në shtetet fqinje të rajonit si dhe të pritjes së kapaciteteve të tyre për operacionet brenda kufijve tanë.

Forcat Armatosura marrin pjesë në emergjencat civile kryesisht me forca nga njësitë/repartet që kanë mision të veçantë angazhimin në operacione të tilla, por nuk përjashtohet mundësia e pjesëmarrjes së forcave të mbështetjes me shërbime të njësisve të tjera.

Sasia e përgjithshme e nënskenarëve të këtij skenari strategjik mund të jetë deri në 7, duke pasur parasysh strategjinë dhe planin e përgjithshëm kombëtar të emergjencave civile. Kërkesat e forcës për çdo nënskenar do të llogariten sipas 7 elementëve themelorë operacionalë (EOC) dhe kodit të kapaciteteve. Bazuar në situatën konkrete, 2-3 prej këtyre skenarëve operacionalë mund të jenë ‘*realë*’ dhe 4-5 prej tyre mund të jenë ‘*të përgjithshëm*’. Skenarët operacionalë të këtij skenari strategjik mund të jenë:

- a) *Një Nënskenar EC për eliminimin e pasojave të një tërmeti në territorin e Republikës së Shqipërisë;*
- b) *Një Nënskenar EC për eliminimin e pasojave të përmbytjeve nga reshjet e shiut apo të përmbytjeve në një territor të madh të vendit;*
- c) *Një Nënskenar EC për eliminimin e pasojave të një situatë të rënduar të reshjeve të borës në territorin e Republikës së Shqipërisë;*
- d) *Një Nënskenar EC për eliminimin e pasojave të një situatë të rënduar të zjarreve masive në një pjesë të territorit të Republikës së Shqipërisë;*
- e) *Një Nënskenar EC për eliminimin e pasojave të një situatë të rënduar nga aksidentet e mëdha industriale apo gabimet njerëzore në një pjesë të territorit të Republikës së Shqipërisë;*
- f) *Një Nënskenar EC për eliminimin e pasojave të një situatë të rënduar të rrë-shqitjeve masive të dheut në territorin e Republikës së Shqipërisë.*

Skenari Strategjik Nr 5: Angazhimi i FA në operacione të mëvetësishme kombëtare, në bashkëpunim me institucionet e tjera të sigurisë.

Fusha e Skenarit Strategjik Nr. 5 mund të përfshijë planëzimin dhe zhvillimin e disa nënskenarëve më të mundshme të operacioneve të mëvetësishme të njësisve të Forcave të Armatosura, që nuk përfshihen në 4 fushat e Skenarëve Strategjikë të mësipërm.

Këta mund të përfshihen në të gjithë operacionet e mundshme të përkohshme e me intensitet të ulët dhe që nuk përfshihen as në operacionet “*brenda nenit 5*” për mbrojtjen kolektive, as në operacionet “*jashtë nenit 5*” për përgjigjen ndaj krizave, si dhe as në operacionet e emergjencave civile.

Duke qenë se pjesëmarrja e mëvetësishme e kapaciteteve të vendit dhe e njësisve të Forcave tona të Armatosura është e natyrës civilo-ushtarake, edhe skenarët e tyre duhet të jenë të natyrës civilo-ushtarake. Këta skenarë duhet të zhvillohen nga Ministritë përkatëse të Linjës, bazuar në misionin dhe detyrat e tyre, apo nga disa Ministri në bashkëpunim.

Nënskenarë tipikë të operacioneve të tilla mund të jenë operacionet speciale kundër terrorizmit, kundër përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, apo kundër trafiqeve të paligjshme. Skenarë të tjerë të veçantë mund të përfshijnë operacionet kundër hackerave dhe

'*cyber defence*', ose operacione speciale kundër rreziqeve të natyrës hibride apo të natyrave të paparashikuara. Po ashtu, nuk duhen neglizhuar skenarë të tillë si rrëmbimi i një avioni të rastit '*renegade*', shpërthimi i një depo municionesh, rrëzimi i një avioni në qendrat e banuara, menaxhimi i dëmtimit të infrastrukturave strategjike, menaxhimi dhe kontrolli i turmave, lëvizjet separatiste, etj.

Një skenar i veçantë operacional mund të jenë edhe operacionet për Mbështetjen e Vendit Pritës (HNS), ku Shqipëria mund të jetë vend pritës në kuadrin e një skenari strategjik të NATO/BE/OKB/Koalicioni, për të gjithë spektrin e operacioneve të tyre.

Një skenar i veçantë mund të jenë edhe operacionet e pengimit (vonimit) të forcave tona, në kushtet e periudhës së arritjes së konsensusit të mbrojtjes kolektive të Aleancë, apo në kushte të tjera jo të favorshme. Operacionet e forcave tona, në rastet e një agresioni ndaj Republikës së Kosovës, mund të jenë një skenar tepër specifik që ne duhet ta zhvillojmë.

Pjesëmarrja e forcave në këtë skenar strategjik do të jetë e llojit '*task force*' e nivelit nga taktik e deri strategjik, kështu që skenarët do të kenë, përveç situatës së përgjithshme politiko-ushtarake të ndodhjes se tyre, edhe implikimet ushtarake të përfshirjes së forcave dy shkallë më lart.

Lloji i Operacioneve do të jetë i natyrës kryesisht kombëtare dhe që do të kërkojë vlerësim të veçantë për çdo skenar specifik. Largësia e Operacioneve do të jetë kryesisht brenda kufijve kombëtarë, por nuk përjashtohet mundësia që ato t'i tejkalojnë ato për qëllime të caktuara.

Forcat pjesëmarrëse do të jenë forca të luftimit, të mbështetjes së luftimit dhe të mbështetjes me shërbime. Do të ketë gjithashtu edhe pjesëmarrje të kufizuar të forcave për menaxhimin e emergjencave civile, brenda dhe jashtë forcave të armatosura, kapacitete të specializuara '*niche*', etj.

Pjesëmarrja e njëhershme e forcave duhet të llogaritet sipas nivelit të pranuar të ambicies dhe përcaktimit të kodit të kapaciteteve. Sasia e përgjithshme e skenarëve operacionalë të këtij skenari strategjik mund të jetë deri në 10 skenarë, të gjithë të natyrës '*të përgjithshëm*':

- a) *Një Nënshkenar në rastet e një sulmi terrorist ndaj vendit tonë, të sponsorizuar nga shtete, grupe apo individë ekstremistë ndaj vlerave kombëtare apo kolektive;*
- b) *Një Nënshkenar për eliminimin e pasojave të një krize ekonomike e financiare që sjell pasoja në sigurinë e vendit tonë;*
- c) *Një Nënshkenar për kërkim-shpëtimin (SAR) e jetës së njerëzve gjatë katastrofave dhe aksidenteve të mëdha në një pjesë të territorit të Republikës së Shqipërisë;*
- d) *Një Nënshkenar për eliminimin e pasojave të një shpërthimi të një depoje municioni apo aksidenti ajror pranë qendrave të banuara;*
- e) *Një Nënshkenar për eliminimin e pasojave të një sulmi kibernetik ndaj rrjeteve zyrtare të informimit të Republikës së Shqipërisë;*
- f) *Një Nënshkenar për eliminimin e pasojave të dëmtimit të infrastrukturave strategjike të vendit (objekteve me rëndësi të veçantë si porte, aeroporte, hidrocentrale, tunele, stadione, tubime të ndryshme, etj);*
- g) *Një Nënshkenar për zhvillimin e kontrollit të hapësirës ajrore dhe policimit ajror për ushtrimin e sovranitetit në hapësirën ajrore, në bashkëpunim me NATINADS¹³;*

- h) *Një Nënshkenar për zhvillimin e kontrollit të hapësirës detare dhe patrullimit detar për ushtrimin e sovranitetit dhe zbatimin të ligjit në hapësirën detare të RSH;*
- i) *Një Nënshkenar për menaxhimin e një situatë ajrore 'renegate' gjatë rrëmbimit të një avioni apo gjatë një katastrofe ajrore në territorin e RSH;*
- j) *Një Nënshkenar për eliminimin e pasojave gjatë ndotjeve të mëdha të mjedisit tokësor, detar dhe ajror;*
- k) *Një Nënshkenar për lehtësimin e pasojave gjatë epidemive të rënda të sëmundjeve infektive apo të ndotjeve nga faktorë biologjikë, kimikë apo radiologjikë.*

Disa përfundime:

Sa më sipër, mund të jetë një kuadër i përgjithshëm me 5 Skenarë Politiko-Strategjikë si vend anëtar i Aleancës, të cilët mund të gjenerojnë minimalisht deri në 23 Nënshkenarë, mbi të cilat do të zhvillohen kapacitetet përkatëse nga institucionet e sigurisë. Normalisht, midis 23 nënshkenarëve mund të bëhet një përzgjedhje e skenarëve të përfaqësues, duke integruar dy-tre nënshkenarë në një, për të rezultuar në një paketë prej 12-15 nënshkenarësh përfaqësues, nga të cilët do të fillojë procesi i kërkesës së planifikimit të forcës.

Skenarët janë nyja lidhëse midis planifikimit të forcës dhe planëzimit operacional. Në këtë kontekst, bazuar në skenarët e mësipërm, MM/Shtabi i Përgjithshëm duhet të fillojë planëzimin operacional në nivel strategjik dhe pastaj ato të shtrihen edhe në nivelet e tjera (operativ dhe taktik). Kjo gjë mund të përdoret në kontekstin metodologjik edhe nga institucionet e tjera të sigurisë kombëtare.

Kjo përfaqësojë për përcaktimin e skenarëve strategjikë dhe nënshkenarëve operacionalë jep një 'roadmap' mbi të cilin do të zhvillohen, përgatiten dhe përdoren forcat e armatosura dhe kapacitetet e tjera të sigurisë. Sigurisht që kjo listë nuk është përfundimtare, ajo mbetet dinamike në kohë dhe në hapësirë.

E një rëndësie të veçantë është futja e skenarëve të rinj strategjikë dhe operacionalë në procesin mësimor të përgatitjes së shtabeve, të trajnimit të personelit në kurset e larta të Akademisë së Mbrojtjes si dhe trajnimin e personelit të institucioneve të sigurisë.

Të gjithë ata që mund të kontribuojnë me mendimet e tyre pro ose kundër, apo të plotësojnë idetë e këtij artikulli mbi skenarët e ardhshëm të Forcave të Armatosura, janë të mirëpritur t'i shprehin ato në edicionin e Revistës Ushtarake të muajit dhjetor, 2011.

Bibliografia:

- Kushtetuta e RSH, botim i vitit 1999.
- Strategjia e Sigurisë Kombëtare, botim i vitit 2005.
- Strategjia Ushtarake e RSH, botim i vitit 2007.
- Koncepti Strategjik i NATO-s, Lisbonë, Nëntor 2010.
- Nato Capability Codes and Statements, 2009.
- NATO Task List NTL-90.

Referenca

¹ Herman Kahn (1922 – 1983) është një nga futuristët më të shquar amerikanë të gjysmës së dytë të shekullit XX-të.

² Herman Khan, On Escalation, Rutland Edition, 1965, page 42.

³ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Botim i vitit 1999.

⁴ PfP Framework Document, Article 10.

⁵ Koncepti Strategjik i Aleancës, Lisbonë, Nëntor 2010, faqe 3.

⁶ Për detaje shih DPC 2010 AC/281-N(2010)0014 EWG(R), Kodet e Kapaciteteve dhe Deklarimet.

⁷ CONPLAN janë plane për Situata të Veçanta, ndërsa SDP janë Planet e Gatshme të Aleancës.

⁸ Për detaje të mëtejshme shih AJP-1 (D) 2010, botim i KDS Gusht 2011, Pjesa III.

⁹ SHAPE – Supreme Headquarters Allied Powers Europe. Ky akronim është i barazvlershëm me ACO.

¹⁰ OPCOM është komandimi operacional, ndërsa FULLCOM është komandimi i plotë.

¹¹ ESDP – European Security and Defence Policy (Politika e Sigurisë dhe e Mbrojtjes Europiane).

¹² CONPLAN janë plane për Situata të Veçanta, ndërsa SDP janë Planet e Gatshme të Aleancës.

¹³ NATO Integrated Air Defence System.

Rishikimi i Strategjisë së Mbrojtjes

Kolonel Tonin Marku,
Përfaqësues Ushtarak i RSH-së në ACT, Norfolk, ShBA

Abstrakt. *Ndikimet e Konceptit të Ri Strategjik të NATO-s kanë vlerë edhe për Shqipërinë si anëtarja më e re e Aleancës. Një nga çështjet kryesore, të deklaruara nga nivelet politike dhe ushtarake të vendit tonë në NATO, është Procesi i Rishikimit të Planifikimit të Mbrojtjes.*

Nisur nga kjo, FA të RSH janë në fazën e Rishikimit të Strategjisë së Mbrojtjes e cila fokusohet në rishikimin e dokumenteve të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare (SSK), të Strategjisë Ushtarake, të Planit të Zhvillimit Afatgjatë (LTDP) si dhe në zhvillimin e kapaciteteve operacionale (Capability Targets).

Në kuptimin e përgjithshëm, Strategjia e Mbrojtjes rrjedh nga Strategjia e Sigurisë Kombëtare, e cila është dokumenti themelor në fushën e sigurisë kombëtare që sjell në emërues të përbashkët të gjithë instrumentet e fuqisë kombëtare, ato politike, diplomatike, ekonomike, ushtarake, të informacionit dhe vlerat morale, për të përmbushur me sukses objektivat kombëtarë.

Që të kemi një SSK të qëndrueshme, është i rëndësishëm edhe konsensusi politik, i cili konsiderohet një nga çelësat e suksesit të SSK-së. Si çdo lloj strategjie, edhe strategjia e mbrojtjes dhe rishikimi i saj ndjek të njëjtat faza të hartimit të saj: duke filluar nga inicimi, hartimi, analiza, miratimi, shpallja, zbatimi, rishikimi dhe përmirësimi në proces.

Një moment i veçantë dhe shumë i rëndësishëm është zbatimi i Strategjisë Ushtarake (SU) dhe kthimi i saj në një dokument veprimi. Kjo ndodh nëse procesi bëhet duke përfshirë aktorët e interesuar, duke ndjekur proceset e përcaktuara dhe duke ngritur një strukturë të veçantë për monitorimin e të gjitha fazave të saj.

Hyrje

Në kuptimin e përgjithshëm, strategjitë ushtarake japin shpjegimet e nevojshme për veprimtaritë e ndryshme ushtarake. Ato shpjegojnë arsyet përse ndërmerren këto veprimtari ushtarake ose përse të zhvillojmë e mbajmë në gatishmëri sasi të caktuara forcash ushtarake. Pra, në kuptimin e përgjithshëm, strategjitë sqarojnë dhe shpjegojnë. Por që të kemi një strategji të qartë ushtarake, duhet më parë të jetë e kristalizuar Strategjia e Sigurisë Kombëtare. Strategjia Kombëtare bashkon të gjitha fuqitë që zotëron një vend, si në kohë paqeje ashtu edhe në kohë lufte, me qëllim që të realizojë objektivat kombëtare. Në këtë kuadër, ne kemi një strategji politike, një strategji ekonomike dhe një strategji ushtarake.

Në kuptimin universal, si konceptet ashtu dhe modelet e zbatimit të SSK-së impono-hen nga tërësia e rrethanave, kulturave, mentaliteteve, infrastrukturave të natyrës tradicionale, ose nga dominimi i faktorëve të ashtuquajtur të butë, të cilët po zënë një vend gjithnjë e më të rëndësishëm në botën një polare.

Në vijim të SSK, Strategjia Ushtarake është arti dhe shkenca e përdorimit të forcave të armatosura të një vendi, për garantimin e objektivave të politikës kombëtare, nëpërmjet përdorimit të forcës ose kërcënimit të përdorimit të forcës. “*Strategjia ushtarake është arti dhe shkenca e përdorimit të forcës politike, ekonomike, psikologjike dhe ushtarake të një*

vendi apo grupi vendesh, për të siguruar mbështetjen maksimale për politikën e pranuar, si në kohë paqeje dhe në kohë lufte¹.

Zhvillimet e fundit të shekullit XXI nxorën në pah një situatë ndryshe të sigurisë globale, praninë e shumë kërcënimeve dhe rreziqeve të cilat janë përcaktuar tani si asimetrike, duke filluar me terrorizmin ndërkombëtar, përhapjen e armëve të dëmtimit në masë (WMD-s), trafikimin e armëve, të narkotikeve dhe njerëzve, rreziqet hibride dhe ato kibernetike, rreziqet nukleare dhe piraterinë.

Ekzistenca e këtyre rreziqeve dhe kërcënimeve ka bërë të domosdoshëm ndryshimin e koncepteve strategjike të Aleancës e, për rrjedhojë, ky ndryshim duhet të reflektohet me doemos në dokumentet strategjike të vendit tonë.

Në Nëntor 2011, në Lisbonë, Aleanca miratoi Konceptin e Ri Strategjik të saj. Koncepti i ri evidenton natyrën e re të sigurisë dhe specifikon tre grup-detyrat e reja të saj. Ky koncept përbën një mesazh strategjik për transformimin e Forcave të Armatosura të NATO-s dhe vendeve aleate.

Siç jemi në dijeni, në zbatim të Planit të Veprimit të FA të RSH me dy Komandat Strategjike të NATO-s (ACT dhe ACO), vendi ynë ka vijuar bashkëpunimin e ngushtë, duke reflektuar në hapa konkrete të përpunimit të dokumenteve kryesore strategjike të mbrojtjes, me synim rishikimin e tyre në frymën e ndryshimeve që NATO po bën në rishikimin e planifikimit të mbrojtjes për përbalimin e sfidave aktuale që po përballet ajo aktualisht.

Për realizimin me sukses të këtij procesi të rëndësishëm, puna ka vijuar në të gjitha nivelet e përfaqësimit, duke përmendur kontributin e personelit ushtarak e civil në strukturat e NATO-s, siç janë: në Përfaqësimin Diplomatik në Shtabin e NATO-s në Bruksel (IS), Përfaqësimin Ushtarak në Shtabin e Shtabin e NATO-s në Bruksel (IMS), Përfaqësimin Ushtarak në Komandat kryesore në ACO² dhe në ACT³ (NMR, NLR) që, nëpërmjet takimeve, diskutimeve, seminareve, *workshop-eve*, konferencave të ndryshme si ajo e Transformimit, Integritimit, është synuar në transmetimin e ideve dhe mendimeve më produktive për realitetin e vendit tonë në fokusimin e këtyre ndryshimeve në dokumentet përkatëse. Ky proces i rëndësishëm është pasuar në mënyrë të vijueshme nga nivelet më të larta politike e ushtarake në takimet përkatëse të ministerialeve në NAC⁴ dhe në MC⁵, etj.

Çështjet më kryesore që janë trajtuar në këto takime kanë qenë: përcaktimi i një vizioni të ri strategjik mbi politikën e zhvillimit në tërësi të Forcave tona të Armatosura; ecuria e përgatitjes së dokumenteve të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, Strategjisë Ushtarake, Planit Afatgjatë të Zhvillimit të FA; funksionimi i strukturës së re të integruar MM/SHP; harmonizimi i kërkesave në planifikimin dhe zbatimin e Objektivave të Forcës (OF); unifikimi i politikave dhe kontratave për mirëfunksionimin e burimeve njerëzore dhe progresi në arsimimin dhe trajnimin individual.

Sipas përcaktimit të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, Forcat e Armatosura janë një nga institucionet më të rëndësishme të sigurisë së vendit. Ato do të synojnë përmbushjen e misionëve të tyre kushtetuese nëpërmjet zhvillimit të strategjisë e doktrinës ushtarake. Synimi i FA do të jetë që, krahas misionit themelor kushtetues të mbrojtjes së pavarësisë dhe tërësisë territoriale të vendit, të marrë pjesë aktivisht në një sërë operacionesh brenda vendit si dhe në operacione jashtë vendit, në kuadër të NATO-s. Por që FA të jenë të afta për t'u përbalhur me kërcënimet dhe rreziqet që tashmë janë përcaktuar si "*Global Commons*" duhet që ato të zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme, të reformohen dhe të bëhen sa më operacionale për t'iu përgjigjur standarteve të Aleancës. Nisur nga kjo, reflektimi i FA në drejtim të Rishikimit të Strategjisë së Mbrojtjes është një kërkesë e nevojshme dhe

domosdoshme në drejtim të modernizimit të saj, sipas koncepteve të reja strategjike të NATO-s, tashmë të njohura nga të gjithë ne.

Siç folëm dhe më sipër, nevoja për një koncept të ri strategjik në drejtim të sigurisë kombëtare dhe për rrjedhojë të sigurisë së mbrojtjes erdhi si rezultat pranimit të Shqipërisë në Aleancën më të madhe të sigurisë botërore dhe arsyeja e dytë shumë e rëndësishme është se kjo Aleancë ka vlerësuar nga ana e saj se situata e sigurisë globale e shekullit XXI ka ndryshuar dhe ndryshimet janë shumë të pallogaritshme. Për të qenë të suksesshëm në përballimin e këtyre sfidave u kërkua konceptimi dhe miratimi i një koncepti të ri strategjik që kërkoj angazhimin e të gjithë niveleve politike, ushtarake, specialistëve të fushës së sigurisë dhe mbrojtjes së vendeve anëtare të NATO-s dhe angazhimin e krerëve të vendeve respektive në miratimin e këtij koncepti.

Për këtë, edhe vendi ynë, duke vlerësuar këto ndryshime në konceptet e NATO-s, ka deklaruar si të domosdoshëm rishikimin e dokumenteve kryesore strategjike. Mund të konfirmojmë se puna për rishikimin e këtyre dokumenteve të rëndësishme të sigurisë ka filluar si rezultat i implementimit të strukturës së re MM/SHP, ku janë ngritur drejtori përkatëse të politikave të mbrojtjes, të planifikimit të mbrojtjes, që në bashkëpunim me drejtoritë e tjera kanë bërë punë të konsiderueshme në përgatitjen dhe paraqitjen e projekteve për ndryshim. Kjo është e deklaruar nga nivelet tona politike e ushtarake por njëkohësisht e vërejtur dhe e konfirmuar edhe nga ekipet e NATO-s, gjatë takimeve e bisedimeve të ndryshme, të realizuara deri tani.

Çfarë duhet të rishikojmë e përmirësojmë në Strategjinë e Mbrojtjes?

Duke u nisur nga realiteti aktual i sigurisë globale, nga përballja e NATO-s me këto kërcënime të reja hibride, mendoj se: Strategjia e Mbrojtjes e FARSH duhet të paraqesë *një reflektim të plotë në konceptet që po ndryshon e përmirëson NATO*. Nisur nga kjo, po rendis disa nga çështjet më të rëndësishme si :

1- Kuptimi në të gjitha nivelet i konceptit të “Përfaqesjes Gjithëpërfshirëse”(CA-Comprehensive Approach)?

Nga kjo, del më se e domosdoshme që vendi ynë të veprojë në rishikimin e përmirësimit e dokumenteve kryesore të sigurisë, në unison me logjikën e ndryshimeve të bëra nga NATO. Ajo që është më e rëndësishme të kuptojmë është se: ashtu si NATO ka shprehur se *konfliktet e sotme ushtarake nuk mund të zgjidhen vetëm nga prania ushtarake, por duhet të orientohemi në konceptin e “Comprehensive Approach” (Qasjes Gjithëpërfshirëse)* që, për Forcat tona të Armatosura nënkupton bashkëpunimin dhe koordinimin edhe me institucionet e tjera të vendit si Ministrinë e Brendshme, të Shëndetësisë, etj., për përballjen me rreziqet hibride, brenda e jashtë vendit.

Kjo duhet fokusuar në dokumentet strategjike se si do jetë ky angazhim dhe bashkëpunim real, për të bërë të mundur realizimin e misionit të FA. Pikë kyçe për realizimin e konceptit “Comprehensive Approach” duhet të jetë zhvillimi i seminareve dhe stërvitjeve të përbashkëta komando-shtabi, të drejtuara nga FARSH, duke përfshirë ministrinë e kabinetit qeveritar dhe organizatat qeveritare dhe jo-qeveritare. Vendosja e urave të komunikimit ndërmjet FARSH dhe ministrive të kabinetit qeveritar dhe organizatave të rëndësishme qeveritare dhe jo-qeveritare do të ndikonte pozitivisht jo vetëm në realizimin me më efikasitet të misionit të Forcave të Armatosura por edhe në një integrim më të shpejtë në NATO të strukturave të niveleve të ndryshme.

2- Cili do të jetë konceptimi dhe shprehja e saktë e detyrimeve ndaj Nenit “5”?

Aspekt tjetër shumë i rëndësishëm që duhet të merret në konsideratë, gjatë rishikimit të dokumenteve, është konceptimi i angazhimeve të vendeve anëtare të NATO-s ndaj Nenit “5”, kjo e shprehur ndryshe “*ndarja e barrës*” pra marrja e përgjegjësisë nga të gjithë vendet në angazhimet konkrete në përballjen e rreziqeve. Kjo ka të bëjë më konkretisht me nivelin e ambicieve tona në përmbushjen e detyrimeve përkatëse. Shembulli konkret është operacioni i fundit mbi Libinë, ku jo të gjitha vendet e NATO-s kanë patur angazhim forcash e mjeteve të barabarta. Kjo ka qenë një temë diskutimi edhe brenda aleancës. Për vendin tonë, duhet të rishikohet shumë saktë ky proces. Deklarata e Ministrit të Mbrojtjes, Zotit Imami, në takimin e Ministerialit të NATO-s, në Qershor 2011, ishte shumë e saktë *që Shqipëria nuk ka kapacitete ajrore për ta mbështetur operacionin mbi Libi por ka e do të ketë resurse të tjera për të konkretizuar këtë mbështetje.*

Duhet që të kuptohet saktë nga të gjithë nivelet politiko-ushtarake se, në kuadër të këtij artikulli, kërkohet vetëmbrojtja kolektive dhe kjo do të fokusohet në:

- Kontributet në parandalimin e konflikteve dhe zgjidhjen e tyre;
- Kryerjen e veprimeve pro-aktive dhe rritjen e bashkëpunimit rajonal;
- Mbrojtjen kundër rreziqeve hibride, duke ndërtuar e afruar zgjidhje të reja, dok-trina, strategji, koncepte, taktika dhe kapacitete;
- Punën e përbashkët, zbatimin në praktikë të procesit të gjithëpërfshirjes, duke kombinuar trajnimin midis “të butës” dhe fuqisë ushtarake;
- Dislokimin e kapaciteteve ushtarake në fushën e betejës, mbajtjen e tyre kur kërkohet, adaptimin dhe zhvillimin e këtyre kërkesave me shfaqjen e kërcënimeve të ndryshme.

3- Cilat janë rreziqet më të rëndësishme që i kanosen vendit dhe vështirësitë për sigurinë e mbrojtjes?

Duhet të kuptohet nga të gjithë se sot Shqipëria, si çdo vend tjetër i Aleancës, po përballet dhe do të përballet me sfida e kërcënime të formave nga më të shumtat dhe më të paparashikueshme, siç përmendëm më lart: rreziqet nukleare, rreziqet kibernetike, terrorizmin, trafikun, etj. ose siç është përcaktuar: rreziqe nga toka, ajri, deti dhe hapësira dhe si dimension i pestë hapësira kibernetike që ka hyrë tashmë.

4- Çfarë duhet të jetë prioritet në ditët tona për Strategjinë e Mbrojtjes në natyrën komplekse të sigurisë, parë kjo në kontekstin politiko-ekonomik?

Parë kjo nga pikëpamja ushtarake, prioritetet e Strategjisë së Mbrojtjes duhet të riformulohen, ndryshohen e përshtaten në reflektim të ndryshimeve të mjedisit të sotëm të sigurisë, por duke e parë lidhur ngushtë me zhvillimet politike e ekonomike brenda vendit.

Prioritetet i Strategjisë së Mbrojtjes duhet të jetë reflektimi së bashku i vullnetit politik dhe kërkesave ushtarake, që do të thotë plotësimi i misionit të saj, në kuadrin e NATO-s. Me vëmendje shumë të madhe duhen parë marrëdhëniet ekzistuese me vendet potenciale dhe partnerë që kanë dëshirën të bashkëpunojnë ushtarakisht dhe të ndajnë përgjegjësi së bashku e të ndikojnë në rritjen e ndërveprimeve respektive.

5- Cili do jetë pozicioni i Shqipërisë, në kuadër të NATO-s, në kontributin e saj në sigurinë globale, parë kjo nga pozicioni gjeografik i saj?

Misioni i qëndrueshëm i FASH është mbrojtja dhe siguria e territorit të vendit në kuptimin politik dhe ushtarak por dhe detyrimet që kanë në kuadër të Aleancës, në përfshirjen e operacioneve të ndryshme ndaj rreziqeve që janë dukur dhe parashikohen në të ardhmen.

Aktualisht FASH po tregojnë rritje e profesionalizëm në drejtim të niveleve të angazhimeve, e parë kjo nga pjesëmarrja e trupave tona në operacionet në kuadër të NATO-s, si në Irak, Afganistan, apo në stërvitjet ushtarake të kryera brenda e jashtë vendit sipas standardeve dhe kërkesave operacionale të përcaktuara në manualët përkatëse. Këto kanë ndikuar në realizimin e parimit shumë të rëndësishëm që është garantimi i sigurisë brenda dhe jashtë vendit në kuptimin e parimit themelor të NATO-s ndaj një vendi anëtar, që duhet të prodhojë siguri dhe jo të konsumojë atë ndaj vetes dhe të garantojë atë në rajonin gjeografik.

6- Roli i FA të SH, në kuadër të NATO-s, për mbrojtjen kundër terrorizmit, mbrojtjen raketore, mbrojtjen kibernetike, mbrojtjen nga rreziqet hibride, kundër piraterisë, armë kontrollin e çarmatimit, mbrojtjen nga përhapja e armëve të dëmtimit në masë (WMD), rreziqet bakteriologjike, radioaktive dhe nukleare (CBRN)?

Për këtë është shumë e rëndësishme vijimi i procesit të përfshirjes së vendit tonë në këto iniciativa politiko-ushtarake të armë-kontrollit, të çarmatimit dhe pengimit të shpërndarjes së armëve, në stërvitjet eksperimentuese të NATO-s në fushën detare, si “Operation Active Endeavour” (OAE), apo përfshirja e koncepteve strategjike ndaj mbrojtjes kibernetike si një rrezik real sot ndaj sistemeve të informacionit, duke u shprehur mirëkuptim të gjerë në këtë pjesëmarrje dhe duke shprehur fleksibilitet me ndërkombëtarët në këtë proces. Kjo duhet të ndërtohet në bazë të kapaciteteve ushtarake të vendit tonë duke iu bashkuar qeverive dhe organizatave ndërkombëtare që kanë për mision përcaktimin e objektivave për të goditur këto fenomene. Kjo kërkon një koordinim me institucionet e sigurisë, survejimin dhe kapacitetet e rikonjicionit, bazuar në një bashkëpunim me aktorë të besueshëm, duke vlerësuar bashkëpunimin me partnerët.

7- Përcaktimi i nivelit të ambicieve të FA të RSH (LoA)

Në kuadrin e deklarimeve të vendit tonë në përfshirjen e operacioneve të ndryshme në kuadër të NATO-s, duhet të vlerësojmë përcaktimin e detyrimeve në konceptin e ri strategjik të NATO-s, rëndësinë e nivelit të LoA të vendeve respektive, në situatën e re të sigurisë për Aleancën. Në këtë terminologji, strategjia e re e mbrojtjes duhet të ripërcaktojë këto nivele ambiciesh që FA duhet të realizojnë gjatë këtij procesi të plotë transformimi në NATO. Që të realizohet kjo me sukses dhe të kemi një vlerësim sa më të saktë duhet, në radhë të parë, të realizohet konsensusi politik me kërkesat ushtarake në besueshmërinë e pranimit të ekzistencës së rreziqeve të reja që sot i kanosen NATO-s dhe vendit tonë, si anëtar i saj dhe, në këtë prizëm, politika të bjerë dakord për gjetjen e resurseve më të domosdoshme për mbështetjen e FA për t’u përballur me këto rreziqe, tashmë reale, brenda e jashtë vendit.

Nga ky aspekt NATO kërkon nga vendet e saj anëtare rivlerësimin e nivelit të ambicieve, në mënyrë individuale, për të arritur, në termin e përgjithshëm, nivelet e ambicieve të Aleancës por, për këtë, vendet duhet të përcaktojnë realisht burimet e tyre të mundshme dhe në bazë të tyre të përcaktojnë çfarë është më e domosdoshme për ta vënë në dispozicion të kontributeve ushtarake dhe të argumentojnë pse duhet përdorur ky investim kombëtar për Aleancën. Krahas kësaj, duhet të vlerësojmë se, ashtu si NATO po bën përpjekjet maksimale të përmirësimit të efikasitetit të këtyre buri-meve nëpërmjet adaptimeve të procedurave, reformave në strukturën e saj, edhe strategjia e re e mbrojtjes e FASH duhet të marrë në konsideratë këto, në proceset e rishikimit të saj.

Nisur nga fakti që FARSH janë në rrugën e integritit të plotë në strukturën e NATO-s, kjo e bën të domosdoshëm thellimin e mëtejshëm të reformave nëpërmjet rivlerësimit të strategjisë së mbrojtjes.

Rivlerësimi i strategjisë së mbrojtjes duhet të përfshijë mjedisin e ri të sigurisë, kapacitetet e mundshme ushtarake, strukturën aktuale dhe atë të ardhshme të FA, profesionalizmin e FA, konceptet e përdorimit të forcave të armatosura, objektivat strategjike afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, prioritetet e zhvillimit, me prioritet në njësitë më të rëndësishme që do të ndikojnë në arritjen e objektivave të forcës së deklaruar në NATO (FG). Kjo reformë do të synojë burimet njerëzore, burimet e mbrojtjes, burimet financiare, saktësimin e planit të përhapjes së FA-së, planet e modernizimit, arsimimit dhe stërvitjes, si dhe planet e bashkëpunimit me vendet anëtare dhe ato partnere.

Strategjia e mbrojtjes duhet të mbështetet në konceptin e iniciuar nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s dhe detajuar nga komanda e ACT-se në kuadrin e “*Task Force on Building Capability Through Multinational and Innovative Approaches*”, mbi promovimin e bashkëpunimit shumëkombësh për fusha të ndryshme interesi të Aleancës, në kuadrin e kufizimit të shpenzimeve të vëndeve aleate.

Bibliografia:

- Building the Alliance’s New Strategic Concept, ACT, Reflections, 2010.
- “Essay on Strategy”, US Institute for National Strategic Studies.
- Çështje të Strategjisë Ushtarake.
- Brifingje të ndryshme të mbajtura në Komandën e ACT, Norfolk, 2011.

Referenca

¹ Webster Dictionary, Military Strategy

² ACO - Allied Command Operations

³ ACT – Allied Command Transformation

⁴ NAC – North Atlantic Council

⁵ MC – Military Committee

⁶ Produkt i ACT për detajimin e idesë së Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s për një Përqasje Shumëkombëshe të zhvillimit të kapaciteteve të Aleancës.

RUBRIKA E DYTË

ÇËSHTJE TË ARSIMIMIT DHE TRAJNIMIT TË FASH

Kjo rubrikë, që tashmë është bërë tradicionale, trajton çështje që kanë të bëjnë me arsimimin dhe trajnimin e FASH. Autorët, që janë studiues e pedagogë të fushave përkatëse, sjellin në shkrimet e tyre, mendime dhe përvojën e tyre lidhur me paraqitjen e këtij komponenti përballë sfidave reale të kohës, kryesisht atyre të integritit.

Në to ndihet fryma e re që duhet të karakterizojë arsimimin dhe trajnimin në Forcat tona të Armatosura dhe që ka të bëjë me ndryshimin e mentalitetit për shumë çështje të mësimdhënies, të kulturës, etj. Ndihet gjithashtu fryma kritike për probleme që nuk shkojnë mirë e që kërkojnë përmirësim dhe debate të hapura.

Autorët synojnë të bëjnë të gjitha përpjekjet e mundshme që ta shohin arsimimin ushtarak si pjesë përbërëse të sistemit tonë të arsimit të lartë kombëtar, duke synuar që auditorët e arsimit ushtarak të jenë më shumë të frekuentuara edhe nga qytetarë të tjerë civilë të sektorëve të ndryshëm, gjë që është bërë realitet me hapjen e Programit të Masterit Shkencor për Sigurinë Kombëtare.

Duke pasur parasysh këtë, Revista Ushtarake është e hapur dhe mirëpret shkrimet më të mira të kursantëve të Masterit si dhe të doktorantëve të ardhshëm, në interes të rritjes së cilësisë së arsimimit ushtarak shqiptar, në mënyrë që ai të bëhet sa më tërheqës për shoqërinë shqiptare.

Disa Refleksione mbi Arsimimin në Akademitë e Mbrojtjes Europiane

Gjeneral Major (R) Shpëtim Spahiu

Kol. Kristaq Xharo,

Këshilltar për NATO-n në Kabinetin e Shefit të SHPFA

Abstrakt. *Arsimimi ushtarak ka tërhequr vëmendjen dhe angazhimin e elitave intelektuale dhe politike në perëndim. Dhe kjo, për vetë rëndësinë dhe efektet që ka në çështjet madhore të sigurisë dhe mbrojtjes. Fakti që pavarësisht nga metodat, filozofitë e arsimimit ushtarak në shkollat kryesore të Perëndimit dhe Lindjes përafrohen në nivelin e tyre operacional dhe strategjik, pa dyshim që ka sjellë një tipizim të prirjeve të përbashkëta të tyre. Misioni i arsimimit në përgjithësi, dhe i atij ushtarak në veçanti, ka qenë që krahas reflektimit pas ngjarjeve të mëdha dhe me peshë në historinë e shoqërisë, të mund të paraprijë në mënyrë proporcionale mbi ngjarjet që mund të përjetojnë në historinë e ardhme.*

Qëllimi i këtij shkrimi është që nëpërmjet një analize të tillë, të pasqyrojë prirjet e filozofisë së arsimimit, veçanërisht këto 100 vitet e fundit dhe mbi këtë bazë të shprehë edhe pasqyrimin e tyre në të ardhmen, e më vonë, të japë atë pak kontribut modest në përjasjen e filozofisë sonë me atë bashkëkohore të Aleancës. Dy zhvillime me mjaft interes të cilat sigurisht do të mundësojnë reflektime në të ardhmen mendojmë se do të jenë programi “Military Erasmus” që po zhvillohet në vendet e NATO-s, nën drejtimin e Konsorciumit të akademive ushtarake si filozofi e zhvillimit të vendeve europiane për nivelin e oficerëve të rinj. Nga ana tjetër, ngritja tashmë 100% në nivelin “master” dhe integrimi i plotë i çështjeve të mbrojtjes dhe të sigurisë për studimet në kolegjet në nivel shtabi, janë prirje dhe filozofi që duhet t’i vlerësojmë dhe reflektojmë duke ecur me të njëjtin ritëm dhe standard.

Akademitë e Mbrojtjes në Europë janë tashmë të angazhuara në hapësira arsimimi të cilat janë sfiduese nga pikëpamja institucionale, nxitëse nga pikëpamja intelektuale dhe që potencialisht në mbartje të një substance dhe dinamike të thellë. Këto zhvillime janë pjesërisht efekti i një morie të tërë angazhimesh dhe opsionesh të pashmangshme, që pruri me bollëk fundi i Luftës së Ftohtë. Po ashtu, mundësitë e shtuara për arsimimin profesional ushtarak që ekzistojnë aktualisht në Europë po nxisin zhvillime dhe iniciativa mjaft efektive. Këto ndryshime kanë ndodhur gjatë edhe më vullshëm akoma që nga viti 1989, por që ende vazhdojnë të ndodhin dhe nuk duket se po e përmbyllin ciklin e vet. Për këtë arsye ky shkrim nuk është as më shumë e as më pak veçse një ftesë për debat. Ndoshta që mund të konturohet në një vlerësim për llojshmërinë e zhvillimeve, por edhe tendencave në arsimimin dhe trajnimin ushtarak, kryesisht brenda vendeve të NATO-s, por edhe më gjerë. Në këtë mënyrë, të paktën le të mund të gjejmë veten dhe rrugën, në këtë kohë kaq dinamike dhe komplekse.

Gjatë Luftës së Ftohtë, institucionet e arsimimit dhe trajnimit ushtarak europian ishin kryesisht institucione që zhvillonin aftësitë dhe prirjet për ruajtjen e “statu-quo-s” në nivele strategjike. Arsimi profesional ushtarak, si produkt dhe kërkesë e kësaj kohe, mbështeste dhe ndihmonte në ruajtjen e sistemit të bipolaritetit që bazohej tek ndarja e kontinentit. Kjo është aq e vërtetë, për të dyja anët në Luftën e Ftohtë, por edhe për vendet e tjera, sa që dukej se nuk ishin formalisht të gjendura në të dyja llojet e blloqeve. Vendet e Traktatit të Varshavës kishin më pak hapësirë për t’i mbështetur programet tek prioritetet, perceptimet dhe traditat

kombëtare sesa ato të NATO-s, por tendenca e përgjithshme në strategjinë e arsimit profesional ushtarak evropian ishte, pa diskutim, thellësisht konservatore¹. “Sigurisht, ndërsa historia ushtarake ka qenë një fushë shumë e pasur e investimit intelektual në vende të tilla të të mësuarit, pak kujdeseshin që akademitë dhe kolegjet e shtabeve në Europë të merreshin me mendimin novator dhe të bënin analiza qoftë për çështjet bashkëkohore të sigurisë, qoftë për rrugët e rritjes së profesionalizmit ushtarak”².

Në këto kushte, burimet e origjinalitetit dhe sfidës kishin tendencën të vinin kryesisht nga departamentet e universiteteve, institutet kërkimore, apo edhe nga vetë qeveritë. Qysh nga fillimet e viteve 1980, çështjet e mëdha që lidheshin, për shembull, me guximin për t’ia lënë peng të ardhmen kombëtare dhe atë të aleancës tek kundërpërgjigja bërthamore, me qëndrueshmërinë afatgjatë të ekonomive që po investonin shumë për teknologjitë e mbrojtjes, me përdorimin strategjik të shitjeve të armëve, me përdorimin e vet forcës së armatosur, ishin pjesë e kurseve më të mira dhe asgjë më tepër. Debati aktiv dhe i mirë-informuar i atij lloji që kishte ndikim mbi politikëbërësit, politikëzbatuesit dhe shtabet ushtarake, ndodhte kryesisht jashtë akademive dhe kolegjeve ushtarake. Këtu nuk ka asgjë për t’u çuditur. Po të kemi parasysh stanjacionin strategjik, do të ishte çudi sikur gjërat të kishin qenë ndryshe³.

Por, në Europën e sotme duket që nuk ekziston më një statizëm i tillë. Ky fluiditet i madh po krijon një zhvendosje cilësore të rolit që kanë akademitë dhe kolegjet të cilat janë të angazhuara në arsimimin profesional ushtarak. Meqë vetë profesioni i oficerit bëhet më i larmishëm për rolin e vet, duket që institucionet e arsimit, për këtë profesion, të kthehen në vende natyrale për diskutime rreth çështjeve thelbësore jo vetëm të mbrojtjes, por edhe të sigurisë, me një dinamikë dhe ideim të freskët, por

edhe sigurisht të lidhur me përvojën, veçanërisht atë të pas vitit 1945.⁴

Nga ana tjetër, ashtu si në gjithë fushat e tjera, këto çështje po i tejkalojnë kufijtë nacionalë dhe janë tashmë të zhvendosura në nivele rajonale, kontinentale dhe globale. Sigurisht një korrelacion reflekton ndikimet dhe marrëdhëniet midis mbrojtjes dhe diplomacisë, me mundësi për reflektim profesional edhe brenda vetë komunitetit ushtarak. Ky proces të menduari tashmë ka krijuar një zhvendosje të dallueshme në mënyrën se si akademitë dhe kolegjet po perceptohen nga të tjerët dhe se si ato e perceptojnë veten.

Jena-Foklend-Kosova: Kohë dhe modele epokale

Edhe më qartë, ky proces ndryshimi mund të vihet re duke bërë një vështrim analitik në llojet e ndryshme të Akademive/Kolegjeve (të shtabeve apo edhe të mbrojtjes) që ka krijuar Europa me kalimin e kohës. Sipas Pitër Fut (Peter Foot), këto kolegje mund të grupohen në një spektër me tre modele kryesore, ku secili prej tyre pasqyron kushte dhe tradita të caktuara, por dhe ku asnjë prej tyre nuk mendohet i lindur superior ndaj tjetrit. Të tre modelet përfshijnë një substancë të arsimit, trajnimit dhe kualifikimit por dhe ku çështja qëndron tek ndërvarësia dhe balanca midis këtyre elementëve.

Duke patur parasysh larminë dhe kompleksitetin evropian në këta 200 vitet e fundit, këto modele afrohen më shumë ilustruese sesa definitive. Ajo që përdor P. Fut, në këtë rast, është të lidhësh modelet sipas një konflikti historik të caktuar: “Jena”, “Foklend” dhe “Kosova” pasqyrojnë dhe paraqesin reagimet ndaj zhvillimeve strategjike të kohës dhe njëkohësisht vlerësimet rreth strategjive të arsimit, kualifikimit dhe trajnimit të oficerit.

Modeli “Jena”⁵

Tipi më tradicional i arsimit në Akademitë e Mbrojtjes, për nivel komande dhe shtabi, u zhvillua pas disfatës prusiane në Jena në vitin 1806, një ngjarje që duket se fundosi

përfundimisht ushtrinë e Frederikut dhe kërkoi njëkohësisht rikonstruktimin e korpusit të oficerëve, që nga parimet fillestare. Ndoshta modeli i lindjes së këtij kolegji që zgjati mbi 180 vjet reflektonte moton kryesore “Kurrë më!”. Lufta e paparashikuar nuk duhet të ndodhë; nuk duhet të ketë disfatë; veprimin ushtarak, sipas vendimeve strategjike, e siguron lidershipi dhe planifikimi i duhur; ristrukturimi i institucionit mbështetës; krijo një regjim trajnimi që të mbështetë sistemin e ri; armiqtë do të zbrapsen nga fuqia e forcave të modelit të ri⁶. Ky sistem është i prirur të funksionojë mirë kur konteksti strategjik është relativisht i stabilizuar, kur kultura politike mbizotëruese është aprovuese dhe profesionalizmi i trupës së oficerëve i lartë.

Pavarësisht nga koha, ky tip vjen si modeli më i adoptuar dhe më i ndjekur edhe pas vitit 1945 (Lufta e II). Ky model, me një profesionalizëm të shkëlqyer, shërben si shembull në Kolegjin e Shtabit të Ushtrisë Britanike në Kambërli (Camberley), për francezët në Sen Sir (Saint-Cyr), për gjermanët në *Führungsakademie* dhe për rusët në Akademinë *Frunze*. Ky model mund të quhet gjithashtu opsioni “i brendshëm” (“in Mouse”). Në këtë model, supozimi mbizotërues priret të jetë ai që profesioni i ushtarakut mbështetet në mënyrën më të mirë, nëse oficerët mësohen në institucione të cilat mishërojnë cilësi dhe virtyte profesionale që konsiderohen si më të çmuarat. Në këtë model, profesioni i ushtarakut është analog me profesionet e tjera tradicionale që kërkojnë të përcjellin arsimimin në fushën e tyre. Rrjedhimisht, ekziston një rol i vogël ose nuk ka një rol të përhershëm që luhet prej stafit jo ushtarak. Të jashtëmit, qofshin ata zyrtarë qeveritarë apo akademikë vizitorë, kanë një funksion në të qenit të ftuar, për të marrë pjesë në programe dhe për të dhënë leksione, por pësha e programit është e orientuar tek arsimimi dhe trajnimi institucional dhe në brendësi të profesionit të oficerit.

Cilësia e mendimit të studentëve është për t’u vlerësuar, por kjo, sidomos, kur është në harmoni me “zgjidhjen e Shtabit” dhe një seri “përgjigjesh” të hartuara prej Shtabit Drejtues. Rezultatet më të mira variojnë tek të diplomuarit që, në aspektin personal, janë individë të shkëlqyer por, në aspektin operacional, jo rrallë sfidohen në dinamika dhe standarte që me vështirësi i përgjigjen ndryshimit⁷. Megjithatë, shkalla në të cilën Kolegjet Europiane të Shtabeve ngjasojnë plotësisht, në pjesën më të madhe, ka të bëjë me shkallën në të cilën stafet e mësimdhënies afrojnë sa më me realitet situatat.

Modeli “Folklend”⁸

Lloji i dytë madhor i Kolegjit të Shtabit, modeli “Folklend” (Falklands) reflekton rrethana të cilat, në një farë mënyre, janë të paqëndrueshme në aspektin strategjik. Përdorimi i ngjarjeve që ndodhën në vitin 1989, si pikë referimi, ka qenë i tepërt sidomos kur ato janë paraqitur si një pikë radikale kthese. Është e qartë që rënia e Murit të Berlinit është një ngjarje me domethënie të madhe por disa ndryshime kishin nisur të ndodhnin tashmë para rënies së tij⁹. Sfidat për interesat perëndimore ishin të mundshme, ato ishin globale përse i përket mundësisë dhe jo domosdo-shmërisht me frymëzim sovjetik. Libani, një pjesë e madhe e Afrikës dhe lufta Iran-Irak, të gjitha do të ngjanin shqetësuese për predikuesit e “stabilitetit me çdo kusht”.

Shpërthimi i Luftës së Folklendit, në prill 1982, i konfirmoi këto shqetësime. U pa që modeli i pastër i brendshëm “Jena” i arsimimit profesional ushtarak kishte kufizime dhe me mjaft vështirësi po i përshtatej rrethanave të reja gjeopolitike. Po shihej qartë që profesioni ushtarak detyrimisht do të operonte në një mjedis që nuk duhej shpëputur prej kontekstit të tij social, arsimor, ekonomik dhe politik. Ashtu sikurse Lufta Folklend ndodhi papritur-e papritur edhe si ngjarje edhe si luftë dhe shkoi në një farë mase përtej pritshmërive-po kështu, modeli

“Folklend” fillon e njeh nevojën për të tejkaluar “zonat e pastra” profesionale për korpusin e oficerëve. Rrjedhimisht, kjo na imponon që trupës së oficerëve t’iu jepen mundësi që të shkojnë përtej trajni-meve dhe arsimimit relativisht të brendshëm dhe të ekspozohen ndaj një axhende të gjerë të mendimit për sigurinë. Kjo do të thotë që arsimimi ushtarak të zgjerojë hapësirën e vet jo vetëm në fushën e mbrojtjes por, detyrimisht, edhe në çështjet e sigurisë¹⁰.

Ky model mund të quhet gjithashtu edhe opsioni *bolt-on* (model shtesë që nuk ndryshon modelin ekzistues) dhe mund të përcillet prej dy mënyrave. Sipas të parës, një kurs standart i oficerit bëhet paralel me një diplomë të akredituar universitare (modeli amerikan dhe mjaft vende të tjera perëndimore). Sipas mënyrës së dytë, individë të përzgjedhur dërgohen në universitete ose institute kërkimore dhe ndërkohë trajnohen prej stafit (modeli britanik, etj). Kjo normalisht përfshin një përqindje relativisht të vogël të trupës së oficerit që dërgohet në departamente prestigjioze universitare para se t’iu jepet komanda e nivelit të lartë apo pas emërimeve në shtab. Por nëse i referohemi Pitër Fut përsëri, sukcesi i modelit “Folklend” varet prej rëndësisë që Kolegji i Shtabit i kushton zhvillimit në tërësi të karrierës dhe korrelacionit për pozicione në nivel shtabi.

Avantazhet intelektuale për ata që kanë fatin të përzgjidhen janë të dukshme. Ana tjetër e medaljes ka të bëjë me faktin që ndërsa strukturat e komandës rrudhen për shkak të presioneve buxhetore dhe presioneve të tjera, grupi i oficerëve pasuniversitarë të diplomuar mund të jetë tepër i vogël për të përmbushur nevojat e oficerëve më madhorë. Qysh prej mesit të viteve 1990-të, në disa vende, modeli “Folklend” nuk ka qenë në gjendje të përmbushë nevojat e strukturave sponsorizuese të mbrojtjes dhe forcave të armatosura.

Modeli Kosova

Prirja, në Europën Perëndimore, vlerësohet që favorizon tani atë që mund të quhet modeli “Kosova” për arsimimin e oficerit. Në pamje të parë, mund të duket se ai është thjesht një zgjatim i modelit “Folklend”.

Por ky model ka aspekte të tjera. Sipas tij, merret si aksiomatik fakti që rrethanat në të cilat forcat e armatosura përdoren janë shumë komplekse. Rrethanat në të cilat koncepte si fitorja dhe frenimi nuk kanë ndonjë domethënie të madhe; aftësitë ushtarake mund të kërkojnë domosdoshmërisht edhe njohuri të tjera sociale, politike, gjeopolitike. Përjashtoj këtu fuqinë e komandimit dhe organizmit që nuk duket se mjegullohet; shqetësimet nacionale nuk duket se janë trysnuese; konteksti ligjor, politik dhe social janë shumë kundërtënëse; ndërkohë që çështjet taktike shndërrohen, në pak kohë, në çështje strategjike dhe politikanët shfaqin interes minutë pas minute në angazhimin apo kryerjen e operacioneve¹¹.

Modeli “Kosova” trajnon duke pasur parasysh këtë lloj kompleksiteti operacional dhe arsimon duke pasur parasysh këtë lloj ambiguiteti politik. Ai përfshin përgatitje shtabi të një cilësie të lartë ku roli i stafit akademik integrohet tërësisht me atë profesional ushtarak. Programi i arsimimit ka qëllim të dyfishtë: profesional-institucional dhe të standartit pasuniversitar, ku institucionet janë të akredituara direk nga agjenci akreditimi (CGSC Leavenworth) apo edhe me lidhje të ndërmjetme prej një universiteti civil. Kjo nuk do të thotë që kriteri profesional ushtarak kushtëzohet prej atij akademik. Po të marrim si shembull rastin amerikan, “Kursi i Komandës dhe Shtabit CGSC” në Livënuërth (Leavenworth) është i pavarur, i akredituar dhe me kredite tërësisht të transferueshme në çdonjërin nga universitetet amerikane.

Edhe pse tërësisht i pavarur, Kolegji Britanik i Shtabit dhe, veçanërisht, niveli operacional i kursit është kaq qartë paralel me nivelin pasuniversitar, sa pjesë të mëdha të kursit mund të

akreditohen prej Universitetit të Londrës, duke ndihmuar rrjedhimisht në sigurimin e standarteve pasuniversitare¹². Është e pranuar gjerësisht që kapaciteti intelektual i oficerëve në operacionet bashkëkohore, në mbështetje të paqes, për shembull, kërkon një nivel sofistikimi në konceptualizim, analizë politike dhe vendimmarrje ushtarake që vështirë se e afrojnë as modelet “Jena” dhe Folkland” për arsimimin profesional të oficerëve.

Përvoja e më shumë se 40 shteteve europiane nuk mund të futet lehtë në përmbledhje të thjeshta dhe këto tre modele nuk përbëjnë përjashtim. Çështja e vërtetë është prirja kryesore. Institucionet trajnuese dhe arsimore në Europën Perëndimore po ecin drejt modelit të “Kosovës”, ato në Europën Qendrore dhe Lindore po i largohen modelit të “Jenës”¹³. Në këtë mënyrë, ekziston një pranim i përgjithshëm profesional ushtarak në Europë për nevojën për të inkurajuar kërkime më të mëdha intelektuale brenda Kolegjeve të Shtabit. Programet e akredituara jashtë janë pjesë e etapave të këtij procesi. Prandaj, duke qenë e nënkuptuar dhe e nevojshme, po krijohet një funksion tjetër, disi ndryshe për stafin akademik, brenda institucioneve ose i bashkëshoqëruar me to. Po fillon të krijohet një partneritet i vërtetë ndërmjet ushtara-këve dhe akademikëve, partneritet që do funksionojë më së miri atëherë kur të dy palët do të kenë një respekt reciprok për pritshmëritë profesionale të njëri tjetrit.

Pitër Fut, duke analizuar modelet, vjen në përfundimin që “...ne duhet të prodhojmë oficerë nga Komandantë Toge deri tek Shefa Shtabi të cilët janë të aftë të merren me nivelin gjithnjë e në rritje të kompleksitetit (strategjik dhe operacional)”¹⁴. Ata nevojitet të jenë të aftë ta vështrojnë këtë kaos nga shumë këndvështrime të ndryshme që nuk janë shqyrtuar më parë, në mënyrë që të gjejnë rrugë nëpërmjet tyre dhe, më pas, t’i komunikojnë dhe shpjegojnë këto rrugë në urdhra, direktiva apo në dokumente të linjave të veprimit. Ky aspekt i jetës moderne ushtarake ndodh jo vetëm në fushëbetejë por, gjithashtu, dhe në fushën e formulimit të politikave, pasjes dhe menaxhimit të biznesit. Asgjë nuk vazhdon të jetë më e drejtpërdrejtë. Partneriteti i nënkuptuar ndërmjet akademikëve civilë dhe shtabit drejtues është i qartë. Është një pasqyrim i asaj çka argumenton përvoja perëndimore si mjegullimi i vijës ndarëse ndërmjet angazhimeve operacionale moderne në botën post-moderne. Nga pikëpamja e arsimit profesional ushtarak, modeli i variantit të Kolegjit të Shtabit “Kosova” e përfaqëson këtë në miniaturë.

Të ndash ngarkesën, të ndash përgjegjësinë, të minimizosh rrezikun-këto janë piketa në modelin europian “Kosova”. Kolegjet më të mira të shtabit apo të mbrojtjes ushtrojnë procedura të cilat i përkasin një panorame intelektuale koherente.

“Military Erasmuss”, Karta e Bolonjës dhe Konsorciumi i Akademive Ushtarake

Sigurisht, për ta çuar më tej këtë pikëpamje, meqë modeli siguron bazën e qëllimit të funksionimit, apo aspiratën, Akademitë/Kolegjet Europiane, të cilat dukshëm reflektojnë modelin “Kosova”, shfaqin lëvizjen e përgjithshme drejt integritimit Europian duke e pasqyruar këtë prirje në arenën e strategjive të arsimit dhe trajnimit ushtarak. Në këto kushte, përmirësimi aktual apo i menduar i standarteve ka prodhuar një shkallë homogjenizimi në arsimim dhe trajnim, tashmë në të gjithë ambientin europian, duke mos bërë dallim midis perëndimit dhe lindjes. Deri tani, ky ka qenë një proces kompleks por që rezultantja e tij është lëvizja në një kah, në atë të integritimit.

Në mënyrë institucionale, Parlamenti Europian, në rezolutën e vet 136, datë 3.06.2009, iu ka kërkuar vendeve anëtare të rishikojnë përmbajtjen e programeve, jo vetëm të akademive ushtarake (që përgatisin oficerët e rinj) por edhe të kolegjeve të mbrojtjes që arsimojnë dhe kualifikojnë nivelet më të larta të trupës së oficerëve. Më saktë, Parlamenti Europian kërkon mundësinë e pranimit të kompromiseve për kurrikula të përbashkëta në këto çështje. Të gjitha

këto shfaqen në Programin “Military Erasmuss” i cili është projekti më i madh që po tenton Europa¹⁵. Pikërisht, këtë projekt ai e vlerëson tërësisht të mundshëm nëpërmjet “Kartës së Bolonjës” ose ndryshe rezoluta 10-307 e Parlamentit Europian që është motori drejt standarteve të arsimit ku tashmë fuqishëm përfshihet arsimimi ushtarak.

“Military Erasmus”

Rezoluta 136 e Parlamentit Europian konsiderohet si një nga zhvillimet më të rëndësishme për arsimimin profesional ushtarak në vendet europiane. Nuk mund ta shpjegoj pse ky eveniment që do të ishte ndoshta një nga piketat orientuese edhe për arsimimin tonë ushtarak, është lënë në hije, nuk është referuar dhe, për më tepër, edhe keqngatërruar. Aq e vërtetë është kjo sa, jo pak, kur i referohen këtij emri të këtij projekti (Military Erasmuss) dallojnë vetëm pjesën e dytë, ku plaku i mençur Erasmuss iu kujton vetëm një prift hollandez por që vështirë se mund të afrojnë një ide kur bashkohet me “military”. Ndoshta kjo është e njëjtë me pak vite më parë, Bolonja iu kujtonte vetëm një qytet të bukur europian, ndërsa procesi i Bolonjës, jo më shumë se një opsion. Iu desh qeverisë që, me ligj, sanksionoi dhe standardizoi gjithë arsimin e lartë (përfshirë edhe atë ushtarak) vetëm sipas këtij procesi, si standart për rrugën ku jemi nisur, integrimin europian.

Procesi i Bolonjës u vu në lëvizje në vitin 1999, për të organizuar arsimin e lartë në bazë të një sistemi me tre cikle (Bachelor/Master/Doktoraturë) dhe futjen e sistemit të krediteve (European Credit Transfer System-ECTS), për të lehtësuar shkëmbimet universitare dhe njohjen reciproke të studimit dhe të kualifikimeve. Megjithatë, duke u angazhuar për të pasur një shkrim më të plotë për këtë subjekt, në të ardhmen, le të trajtojmë disa momente të projektit “Military Erasmuss”, me atë çka u përpoqem të trajtonim që në fillim të këtij shkrimi.

Programi “Military Erasmuss”, i konsideruar si një ide brilante nga vetë Komisioni Europian¹⁶, përfshin një skemë të mirëmodeluar. Ashtu si Procesi i Bolonjës edhe Erasmuss janë të menaxhuara nga Komisioni Europian, prej një agjencie të centralizuar në Bruksel, e cila ka për detyrë monitorimin dhe inkurajimin e pjesëmarrjes së vendeve europiane në këtë program. Në pikën “9” të rezolutës 136 të PE, përmendet fakti që “Shumica e kolegjeve dhe akademive ushtarake janë tashmë pjesë e procesit të Bolonjës dhe e programit “Military Erasmuss”¹⁷. Më të suksesshëm në këtë drejtim janë: *Ecole Militaire Royale* në Belgjikë, *Saint-Cyr Coetquidan* në Francë, Universiteti i Hamburgut për Forcat e Armatosura Federale në Gjermani, Akademia Ushtarake Portugeze, Akademitë dhe Kolegjet Ushtarake të vendeve të Balltikut (Lituanisë, Estonisë, Letonisë) por edhe ato të Rumanisë, Çekisë, Polonisë. Gjithsej, sot në këtë program, janë të përfshira 25 vende dhe më shumë se 43 institucione.¹⁸ Në referencë me rezolutën 12 843, të datës 9 shtator 2008 (po të PE), ky program i referohet të dy cikleve të arsimit profesional të oficerëve (Bachelor dhe Master).

Kjo lehtësohet sepse, po sipas kësaj rezolute, (f. 13), 80% e vendeve anëtare të BE zbatojnë Procesin e Bolonjës në arsimimin e tyre ushtarak dhe, në këtë kuadër, janë pjesë e zbatimit të *Erasmuss* ushtarak. Po sipas një studimi të Komisionit Europian, 70% prej tyre pranojnë se përvoja e fituar nga një program i tillë shkëmbimi shton vlerën në aspektin e njohurive profesionale por edhe karrierës së një oficeri. Fakti që shumica e vendeve e kanë nënshkruar Kartën *Erasmuss*, iu lejon kolegjeve që të organizojnë shkëmbime akademike, jo vetëm në programe por edhe në studentë. “Këshilli ka rënë dakord për të miratuar skemën e re europiane të bashkëpunimit ushtarak, modeluar mbi programin *Erasmuss*.”

Skema synon të forcojë elementë të ndërveprimit të forcave të armatosura dhe për të promovuar një arsimim dhe kulturë të sigurisë e mbrojtjes europiane. Më tej, ai inkurajon

akademitë/kolegjet për të rritur lëvizshmërinë e studentëve dhe personelit mësimdhënës ushtarak mes vendeve europiane dhe i nxit ata për të njohur arsimimin dhe trajnimin që oficerët e tyre kanë marrë në institucionet e tjera, në vendet e BE. Ndërsa në pikën 64 të rezolutës së PE, për programin “Military Erasmuss”, kërkohej që të shfrytëzohej Traktati i Lisbonës për të kaluar në programe në nivelin Master dhe Doktoraturë, për çështje të përbashkëta të sigurisë dhe të mbrojtjes, në nivel evropian¹⁹.

Është interesante që t’i referohemi edhe paragrafit 69 të po kësaj rezolute ku kërkohet që kjo skemë (projekti *Erasmuss*) të jetë e rëndësishme edhe më efektive, duke u zgjatur përtej rajonit të BE²⁰. Tashmë ky është një realitet për faktin se Kolegji Evropian, në kuadrin e ESDP, tashmë është i pranishëm edhe në vende të tjera. Edhe në vendin tonë, nën kujdesin e Austrisë, BE organizoi kurrikula për çështje të sigurisë dhe të mbrojtjes, në vitin 2007-2008. Pra siç shihet, ky program është shumë më tepër se një plan për stërvitje të përbashkët. Sot, dukshëm, ekziston konvergjenca në sistemet europiane të arsimit dhe, në këtë kuadër, “Military Erasmuss” nxit, së bashku me Procesin e Bolonjës, për të sjellë edhe në arsimimin ushtarak, ndjenjën e identitetit evropian. Nuk ka dyshim se “Military Erasmuss” kontribuon në një lidhje të fortë të qytetarisë europiane, duke synuar vullnetin dhe dëshirën për të jetuar së bashku, si dhe për të qenë të gatshëm për të mbrojtur njëri-tjetrin²¹.

Referenca

¹ The Training of Officers: From Military Professionalism to Irrelevance, New York: 1990, pp.103-

² John Allen Williams and David R Segal (eds.), The Postmodern Military: Armed Forces after the Cold War, Oxford: Oxford University Press, 2000, f. 14-31.

³ Michael D Stephens (ed.), The Educating of Armies, London: Macmillan, 1989, pp. 1-12.

⁴ Brian Burrige RAF, ‘Adopting Military Training and Education Systems to the New Strategic and Operational Environment’. Publication forthcoming, IISS, 2001.

⁵ Beteja e Jenës e vitit 1806, ku Prusia u mund nga Franca e Napoleonit, me ç’rast Prusia kapitulloi dhe ra nën tutelën e Francës. (shënim i autorit)

⁶ John Keegan, War and Our World, London: BBC Publications, 1998

⁷ Po aty

⁸ Në orët e para të mëngjesit të 21 majit 1882, kur flota pushtuese britanike nisi zbarkimin e ushtarëve të saj të parë në ishujt Falkland, tashmë ishte më se e qartë se Anglia ishte e vendosur të rimerrte kontrollin në ishujt Falkland, të cilat ata i pretendonin qysh nga viti i largët 1833.(shënim i autorit)

⁹ John Allen Williams and David R Segal (eds), The Postmodern Military: Armed Forces after the Cold War, Oxford: Oxford University Press, 2000,

¹⁰ François Heisbourg, “European Security: The Impact of the European Union’s Security and Defence Policy”, Plenary Address, 4th International Security Forum, Geneva, 15-17 November 2000.

¹¹ Valeri Ratchev, ‘Changing the Strategic Culture through Modernisation of Military Education -The Case of Bulgaria’, Connections Bulletin, Number 3.

¹² The Political Education of Soldiers, Beverly Hills and London: Sage Publications, 1983, pp. 175-207.

¹³ J Kazocins, ‘Military Training’ in Defence Diplomacy in Central and Eastern Europe: Challenges to Comparative Public Policy, ESRC Future Governance Paper, February 2001,

¹⁴ Peter Foot “Trends of European military education”. London 2010.

¹⁵ Rezoluta 136 e PE, paragrafi 3.

¹⁶ Rezoluta 136, 2009, Bruksel.

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Shih Rezoluta 136 e PE, paragrafi 64.

²⁰ Po aty, artikulli 69 i rezolutës.

²¹ Rezoluta 136, paragrafi 70.

Arsimi ushtarak shqiptar përballë sfidave të integrimit

Dr. Simon Gega,

Pedagog në Akademinë e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”

Abstrakt. *Arsimimi ushtarak shqiptar, në veçanti arsimimi i oficerëve të rinj, ka qenë një ndër çështjet më të debatueshme të periudhës së zhvillimeve demokratike. Në këtë kuadër, duke e vlerësuar arsimimin ushtarak larg kopjimeve dhe shablloneve të gatshme, e kam konsideruar atë si aspektin më të rëndësishëm të identitetit kombëtar. Kjo më ka bërë që ta shoh, si atëherë dhe sot, arsimimin ushtarak si pjesë të sistemit tonë të arsimimit kombëtar dhe, në asnjë moment, si kopje të dikujt.*

Në të njëjtën kohë, duke vënë re se, ndërsa flasim për zgjidhje si produkt të një mendimi gjithëpërfshirës dhe të bazuar në përvoja sa më produktive, dominon “zgjidhja befasuese” sipas konceptit, “këtë e di tjetër kush”, emri i të cilit nuk bëhet i ditur asnjëherë. Nisur nga dëshira për të qenë në të njëjtin nivel me partnerët përpiqemi të aplikojmë modele të gatshme të cilat, për hir të ndryshimit të kushteve sociale dhe nivelit të zhvillimit ekonomik e shoqëror, janë të destinuara të dështojnë.

Unë personalisht e vlerësoj shumë mendimin e mirë për të gjetur një model të tillë, mirëpo gabimi qëndron se ne i bëjmë llogaritë e modeleve tek kostoja e tyre. Në këtë kuptim, jemi të destinuar që shpesh të themi, “nuk mundemi, kostoja është e lartë, ne nuk kemi nevojë për kaq e aq oficerë”, e tjerë e të tjerë, duke u mbyllur gjithnjë në të njëjtin cikël.

Para rreth dy vjetësh, KDS zhvilloi për këtë çështje një diskutim të gjerë shkencor në Vlorë¹. Atje u hodhën idetë nga më të mirat për përfshirjen e sistemit të arsimimit ushtarak në sistemin e arsimimit të lartë të vendit. Atje u theksua rëndësia e zhvillimit të një koncepti gjithëpërfshirës për FA, për të zhvilluar sistemin më atraktiv për shoqërinë tonë. U hodhën ide deri në nivelin e arsimimit të nënoficerëve, në të cilin të përfshiheshin edhe civilët dhe jo vetëm ata të FA.

Nën këtë vizion, u hodhën hapat për akreditimin e këtij sistemi arsimimi, programet e arsimimit u ndërtnuan në module dhe me objektiva plotësisht të qarta, duke e vënë të gjithë sistemin në një linjë logjike, u hapën programe studimi në të cilat morën pjesë shumë personalitete civile e ushtarake të niveleve nga më të ndryshmet, duke synuar që shumë shpejt, auditorët e arsimimit ushtarak të ishin shumë të frekuentuara edhe nga qytetarë të tjerë civilë të sektorëve të ndryshëm.

Koncepti shqiptar për profesionin e oficerit dhe realiteti


Arsimimi i oficerëve është përballur me shumë alternativa që nga krijimi i shkollës së parë e deri në ditët e sotme. Për hir të së vërtetës, ai në asnjë rast nuk është shndërruar në një arsimim i cili të jetë trajtuar si një profesion i barasvlershëm, në koncept, me profesionet e tjera civile, duke qëndruar gjithnjë në kornizën e një profesioni politik të preferuar në atë kohë vetëm për atë shtresë të popullsisë që kërkonte të lartësonte dinjitetin e saj. Kështu që auditorët e institucioneve ushtarake ishin të frekuentuara vetëm nga shtresat e varfra dhe kryesisht fshatare.

Ky lloj trajtimi vihej re, në atë sistem, për faktin se fëmijët e udhëheqësve të lartë politikë, në ndryshim nga vendet e ndryshme të botës së qytetëruar, nuk ishin në asnjë rast pjesë e trupës

së oficerëve. Edhe ata pak kandidatë që e ndiqnin, ishin vetëm nën veladonin e shembullit politik se sa sipas dëshirës për të patur një profesion të tillë.

Nëse do të analizojmë disa periudha historike në të cilat arsimimi ushtarak² është spikatur si i vlerësuar në kuadrin e pjesës tjetër të arsimit shtetëror, periudha historike e pasqyrimin të vendit, ishte një periudhë intensive e cila u shoqërua me përpjekje për të ndërtuar një sistem të konsoliduar si të barabartë me të gjithë ata të cilët u renditën në krahun e fituesit të luftës së dytë botërore.

Në këtë kuadër, marrëveshjet e bashkëpunimit, sidomos me Rusinë, ishin shumë intensive. Shumë kadro të ndryshëm si edhe kadetë u dërguan pranë institucioneve të arsimit ushtarak në këtë vend duke marrë një arsimim mjaft të konsoliduar për kohën. Pothuajse të gjithë kuadrot e lartë ushtarakë u arsimuan dhe u kualifikuan në vendet e Traktatit të Varshavës, gjë e cila ndikoi shumë pozitivisht për krijimin e një baze të qëndrueshme për zhvillimin e arsimit brenda vendit.



Kështu që jo rrallë, për ta bërë të kërkuar atë, ndiqej rruga e mbështetjes shoqërore të familjes së ushtarakut. Dhënia e disa privilegjeve për familjet e oficerëve dukeshin si favore, duke e lartësuar disi këtë shtresë shoqërore në sytë e opinionit publik. Mirëpo kjo bëhej vetëm për kohën në të cilën oficeri ishte në shërbimin aktiv dhe nëse ai mbante një qëndrim të duhur politik.

Në thelb, oficeri, në momentin që ndërpriste karrierën, nuk kishte alternativë për rehabilitimin e vetvetes veçse të shndërrohej në roje konvikti, roje operative në institucione, apo në punët më të rëndomta. Këtë tregoi reforma e vitit 1967 dhe të gjitha reformat që erdhën më pas deri në ditët e sotme.

Brezi im, por edhe i disa më të rinjve, e di mirë se cilat ishin përpjekjet për ta “integruar” arsimimin ushtarak me forcë në ligjin e arsimit të lartë. Reforma arsimore e 1974 mund të konsiderohet pika kulmore e saj, e cila e vendosi arsimin e oficerëve në të njëjtin standard formal me arsimin e lartë në vend.

Në këtë kontekst shkolla e oficerëve, Shkolla e Bashkuar, Akademia e Forcave Ajrore dhe Detare si dhe Shkolla e Ministrisë Brendshme u shndërruan në shkolla të larta. Akademia e Mbrojtjes mori statusin e institucionit të arsimit pasuniversitar. U vendosën kritere për trupën pedagogjike dhe studentore me të njëjtin standard me ato të shkollave të tjera të larta. Për hir të së vërtetës, Akademia e Mbrojtjes, në atë kohë e Shtabit të Përgjithshëm, konsiderohej shkollë pasuniversitare dhe si e tillë ofronte studime në fushën ushtarake sipas kërkesave e standarteve të ligjit për promovimin e gradave shkencore e titujt akademikë.

Zhvillimet demokratike në vend nuk mund të linin jashtë kontekstit të tij këtë lloj arsimimi i cili e ndjeu ndryshimin i pari dhe kjo ngaqë përmbajtja që ishte ofruar në programet e tij ishte normale. Reforma në FA ishte e thellë dhe shumë dimensionale. Shumë nga oficerët me grada e tituj shkencorë u zhvlerësuan duke u angazhuar në pozicione të ndryshme pune për të mbajtur familjen e tyre, ndërkohë që kolegët e tjerë civilë ishin të nderuar dhe të respektuar në të gjithë institucionet, pavarësisht nga pozicioni i tyre politik. Ky lloj trajtimi e vuri në dyshim këtë sistem, i cili ka rreth njëzet vjet që po lundron në mes dallgëve të mendimeve e praktikave, pa e gjetur akoma vetveten në identitetin e tij kombëtar.

Arsimimi i oficerëve të rinj mori një goditje të rëndë. Natyrisht ndryshimet demokratike kërkonin një përmbysje totale të programeve mësimore dhe objektivave të tyre. Entuziazmi për të kapur kohën e humbur e futi këtë arsimim në kolaps të plotë, duke kaluar nga ekstremi në ekstrem. U mbyllën shkolla dhe u bashkuan të tjera, u kopjuan modele dhe përvoja duke krijuar një opinion publik dhe psikologjik se arsimimi ushtarak shqiptar nuk vlen dhe përvoja jonë 100 vjeçare u konsiderua e pavlefshme.

Në këtë zhvillim, Akademia e Mbrojtjes e ruajti ekuilibrin, kjo për faktin se, ndërsa për 5-10 vjet Forcat e Armatosura nuk paraqisnin ndonjë vështirësi për oficerë të rinj, një brez i vjetër oficerësh, duke menduar si pragmatistë për të gjetur vetveten sa më gjatë në ushtri dhe duke shfrytëzuar lidhjet direkt me politikën, hodhën idenë se aq sa i duhen ushtrisë sonë mund të përgatiten jashtë vendit, ndërsa akademia duhet të funksionojë me programe të reja.

Kështu, në valën e entuziazmit që të rrëmben, paralelisht me hartimin e programeve u dërguan shumë oficerë për kualifikime afatshkurtra dhe afatgjata në vendet e NATO-s, por edhe në vende të tjera dhe kjo do të mjaftonte vetëm që të ofrohej ndihma. Kjo u bë pa një plan dhe perspektivë të qartë e duke arritur deri atje sa të mbyllej përkohësisht arsimimi i oficerëve të rinj në vend për ta futur, në këtë mënyrë, arsimimin e oficerëve në një mjegullnajë të plotë. Zhvillimet e mëvonshme politike e sociale arritën kulmin me ngjarjet e 1997 të cilat do të ndërprisnin edhe atë pak entuziazëm për reformimin e plotë të sistemit arsimor ushtarak, sipas përvojës së perëndimit, me rimobilizimin e ish oficerëve të liruar nga reforma e 1992.

Nuk do të kishte aspak vlerë nëse sot kjo mjegullnajë nuk do të ishte e pranishme në zhvillimet tona arsimore dhe nëse nuk do të më kujtohej një përcaktim me vlerë i një docenti të Akademisë së Drejtimit, Hamburg, ekspert për didaktikën, i cili pohoi se “ndërprerja në më shumë se një vit e procesit mësimor do t’i kushtojë vendit rreth 20 vjet për të gjetur vetveten.”³

Në fakt, kanë kaluar pak më shumë se 10 vjet nga ajo ditë dhe arsimimi i oficerëve të rinj nuk ka marrë rrugën e identitetit dhe të normalitetit. Janë aplikuar shumë forma e përvoja si dhe

janë bërë edhe eksperimente, prej të cilëve vetëm njeri ka rezistuar dhe ka të ngjarë të mbijetojë, përvoja pasuniversitare, përvore e cila për mendimin tim është me e dobta.

Në ligjin e arsimit të lartë, por ka gjasa që kjo tashmë është testuar si normë në kuadrin e Kartës së Bolonjës, një profesion nuk mund të trajtohet si i tillë nëse nuk ka ndjekur një proces të mirëfilltë arsimimi, jo më pak se 120 kredite që i bie dy vite akademike.⁴

Duke i qëndruar logjikës për arsimin ushtarak, do të mjaftonte, se deri më sot nuk ka asnjë përojë që ofron një arsimim bazë ushtarak për të shndërruar një shtetas, në një ushtarak të thjeshtë në më pak se 10 muaj kohë të programuar. Në fakt kështu e kemi edhe ne në programet tona. Për ushtarin profesionist I dhe për ushtarin profesionist II do të duhen dy e më shumë vite shërbime e arsimimi në institucionet e arsimit dhe njësitë e repartet ushtarake. Secili mund të analizojë fazat përkatëse të arsimit dhe trajnimit.

Ushtarit të thjeshtë do t'i duhet të bëjë të tijen: veprimet individuale, pajisjet dhe mjetet, armën dhe mënyrën e përdorimit, rregullat, normat e parimet e jetës në ushtri, ligjin dhe gjithçka lidhet me pozicionin e tij si ushtar. Të gjitha këto synojnë ta bëjnë atë të vetëdijshëm për ndryshimin e pozicionit shoqëror dhe detyrimet që ai ka në kuadrin e një marrëveshjeje individuale.

Për ta shndërruar atë në një profesionist të vërtetë, të aftë të zotërojë e njohë përgjegjësitë individuale, por edhe të dijë dhe të respektojë rregullat e shtetit e të shoqërisë si dhe të kuptojë veçoritë e ngarkesës në pozicionin që mban, atij i duhet një konsumim kohe jo më pak se dy vite. Shkurt, vetëm për të orientuar e drejtuar vetveten në një pozicion krejt të veçantë për të, me gjithë vullnetin e tij, bile edhe me arsimimin përkatës, i cili sot po tenton drejt 18% me arsim të lartë, ushtarit profesionist i duhet një kohë e programuar për 120 kredite. Ndërsa nënoficerit, i cili do të jetë ekspert i veprimeve në grup, mjeshër i përdorimit të armëve të grupit, i duhet jo vetëm arsimimi si ushtar, por edhe një arsimim plus si nënoficer.

Kjo është normale, ai duhet të marrë elementet e njohurisë për të vepruar me rreth 30 njerëz, për të njohur karakteret e veçoritë e punës me to, për t'u bërë në një farë mënyre i besuari i tyre dhe ndihmësi i parë i nëntogerit, do t'i duhet vetëm arsimim, kursi fillestar, kursi bazë në të dy pjesët dhe kursi i avancuar po në të dy pjesët i cili zgjat jo më pak se 1.5 vite akademike si dhe një përvojë pune jo më pak se 9 vjet. Të mos harrojmë se sot janë mbi 22% e nënoficerëve me shkollë të lartë.

Po oficerit çfarë arsimimi duhet t'i ofrojmë?

Është krejt normale përgjigja: një arsimim i cili është dinjitoz për të drejtuar trupën e ushtarëve dhe nënoficerëve. Hollandezët kanë një shprehje shumë domethënëse në këtë drejtim. Gjymtyrët, janë trupat, shtylla kurrizore që i mban të lidhur është nënoficeri, ndërsa ai që i drejton dhe i komandon është oficeri. Unë nuk dua të replikoj me askënd, por oficeri duhet të jetë i gatshëm për të drejtuar 33 njerëz që ditën e parë të karrierës së tij dhe si i tillë duhet të njohë në perfeksion përgjegjësitë e secilit, si ushtarë e nënoficerë. Ai duhet të dijë dhe të jetë i vetëdijshëm, i bindur dhe i ndërgjegjshëm për vlerën e jetës dhe veprimtarisë së vartësve të tij. Ky në fakt përbën objektin e qëllimit të programit dhe në të njëjtën kohë përmbajtjen e arsimit të tij. Për këtë nuk ka nevojë për argumente shtesë, mjafton të ulësh dhe të llogarisësh kohën për ta shndërruar këtë në vlerë konkrete, të matshme dhe të vlerësueshme.

Për analizë mora një grup të njësuar me strukturën më të vogël në FA dhe drejtuesin e saj me gradën nëntoger.

Më këtë desha të formatoj përpara lexuesit një koncept të rëndësishëm të lidhjes logjike ndërmjet ekzekutorit të veprimit-ushtarit, administratorit të burimeve materiale e njerëzore që lindin në bazë të një qëllimi-nënoficerit, drejtuesit të njerëzve, përfshirjen e interesave të secilit në një objektiv si bazë e motivimit për veprim-oficeri. Ky koncept është kudo, në të gjithë qelizat e jetës, në ndërtim, në mjekësi, etj. Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm por edhe të bindur se kjo nuk realizohet me programin e “pasuniversitarëve”.

Prandaj, në këndvështrimin tim, implementimi i logjikës së Ligjit të Arsimit të Lartë është varianti më i sigurt dhe më largpamës për arsimimin e oficerëve dhe jo vetëm të atyre në karrierë. Përfshirja në këtë ligj nuk mund të jetë e pjesshme dhe me cikle siç është aktualisht. Arsimitimi i ngjan një zinxhiri, i cili nuk mund të luajë rolin e vet nëse i modifikohet qoftë edhe një hallkë e tij. Në këtë kuptim ruajtja e formës i mban të lidhur objektivat duke i shërbyer njeri tjetrit, ndërsa përmbajtja i jep kuptim qëllimit.

Nëse nuk ruhet ky unitet, në veçanti në procesin e arsimimit ushtarak, është shumë vështirë të rikuperosh mangësinë në kohën që kërkohet. Objektivat nuk janë gjë tjetër veçse fushat e ekspertizës sipas niveleve përkatëse të drejtimit dhe shërbimeve në FA. Kështu ka ngjarë me shumë specialitete në FA. E dimë të gjithë se një pedagog do njëzet vjet për t’u përgatitur. Kjo do të thotë se nëse sot të mungon edhe fusha përkatëse e arsimimit, si p.sh. topografia, ndërlidhja, xhenio, kimia, artileria e të tjerë, do të duhen minimalisht 20 vjet për të rivendosur gjendjen në kufijtë e normalitetit të një arsimimi vijues. Prandaj sot i jap të drejtë N/Kol. Vidërskit (Widerski) për konkluzionin e dhënë në 1998.

Në FA ka modele “ kostumesh” oficerësh nga më të ndryshmet. Në këtë mënyrë është krijuar, krahas të tjerash, një hendek i madh sa botëkuptimor dhe profesional brezash ndërmjet atyre që kishin marrë një arsimim të plotë brenda vendit, të cilët ishin një brez relativisht i vjetër, me një brez të ri që nuk ishte as” mish e as peshk,” pasi arsimimi që kanë marrë brenda vendit nuk u orientua asnjëherë drejt, si dhe me një brez tjetër të arsimuar jashtë por që edhe ai ka një diversitet arsimor ndër vete, për shkak të koncepteve të ndryshme të arsimimit, duke i dhënë një përmbajtje aspak të këndshme identitetit të profesionalizmit ushtarak shqiptar.

Ky në fakt është një realitet i arsimimit ushtarak të oficerit të ri në FA. Ky realitet kërkon një vlerësim duke marrë për bazë vlerat e ndryshuara kombëtare dhe jo eksperimente. Kryerja e eksperimenteve dhe reformave arsimore kërkon një “...marrëveshje ndërmjet kombit dhe qeverisë...”⁵ që do të thotë një përjashtim absolut i njëanshmërisë së vendimmarrjes. Kombi, për ne, është në radhë të parë brezi i ri i oficerëve, janë të gjithë oficerët. Dhe janë auditorët e arsimimit të cilët duhet t’i japin tonin dhe konsulencën çdo strukture vendimmarrëse pa të cilën nuk mund të ketë kuptim vetë vendimi. Ky është parimi bazë i procesit të vendimmarrjes, Arbitrariteti i vendimmarrjes dhe aq më tepër për procesin e arsimimit, nxit anarkinë e zbatimit dhe për rrjedhojë të kulturës⁶. Procesi i arsimimit është i shenjtë për faktin se këtu ngjizet identiteti i çdo profesioni, këtu merr trajtën e vetë gjuha e “komu-nikimit” dhe e veprimit të përbashkët. Nëse ky proces nëpërkëmbët, atëherë nëpër-këmbët e ardhmja.

Shanset që krijohen dhe profesioni i oficerit në Ligjin e Arsimit të Lartë

Ligji i Arsimit të Lartë ka krijuar, si asnjëherë tjetër, një shans historik për konceptin e profesionit të oficerit. Duke trajtuar sistemin e arsimit ushtarak në të njëjtin standard me sistemin e arsimit të lartë, ligji e vendos juridikisht fushën e sigurisë e të mbrojtjes në të njëjtin kuadër vlerësimi me të gjithë profesionet e tjerë të arsimit të lartë në vend. Kjo do të thotë se ligjërisht arsimimi për fushën e sigurisë e të mbrojtjes duhet të jetë i hapur dhe me

mundësi frekuentimi nga të gjithë shtetasit shqiptarë dhe jo vetëm nga institucionet e mirëfillta ushtarake.

Akademitë ofrojnë arsimim të lartë profesional dhe veprimtari krijuese në fusha specifike të artit, sportit, sigurisë dhe mbrojtjes e fusha të tjera profesionale. Ato mund të ofrojnë programe të studimeve për të tre ciklet... Akademitë ofrojnë edhe kërkim shkencor në fushat përkatëse, në varësi të ciklit të studimit, në përputhje me statutet e tyre.⁷

Në këtë kuptim, ka shumë rëndësi konsolidimi i koncepteve bazë që i bën të integrueshme dhe bashkëpunues sistemet dhe institucionet, qofshin ato civile dhe ushtarake. Një ndër to është trajtimi i institucionit dhe i arsimimit ushtarak si një vlerë kombëtare shoqërore. Kjo për faktin se ai nuk ofron thjesht një profesion vetëm për oficerin e strukturave të FA, por sepse ofron një specialist dhe ekspert për çështjet e sigurisë e të mbrojtjes, në shërbim të shumë institucioneve të shtetit e shoqërisë.

Në këtë profesion minimalisht do të përfshihen ekspertët e menaxhimit të krizave, ekspertët e trajtimit të elementëve të sigurisë e mbrojtjes publike, të rendit e shërbimit informativ, të marrëdhënieve ndërkombëtare, etj dhe natyrisht oficerë. Ky është një hap i guximshëm për të vendosur në nivelin *bachelor* të gjithë këtë sistem profesionale që sot janë jashtë mundësisë integruese e transferuese dhe aq më keq nuk trajtohen si të nivelit universitar.

Logjika e do që institucionet që kanë nevojë për ekspertë e specialistë për marrëdhëniet ndërkombëtare, shërbimin informativ shtetëror, policinë, kufirin, doganat etj., natyrisht mund e duhet të ofrojnë arsimimin përkatës të fushës profesionale, të nivelit Master Profesional, për kandidatët që zotërojnë diplomën *bachelor* në fushën e sigurisë e të mbrojtjes. Kjo do të thotë se riorganizimi i institucioneve të tjerë të arsimimit për ciklin e dytë dhe të tretë për fushat e tyre do të jetë një dritare e hapur dhe e orientuar nga hapi ynë.

Vullneti politik për t'i trajtuar këto profesione me të njëjtin standart është një arritje shumë cilësore për të gjithë institucionet që kanë nevojë për ekspertët e sigurisë. Në këtë kontekst, institucionet e arsimit ushtarak të FA kanë një avantazh publik sepse janë shumë afër procesit të akreditimit, pasi cikli dytë dhe i tretë janë tashmë të certifikuar. Do të mjaftonte vetëm një vullnet administrativ për të vazhduar procesin e konsolidimit të plotë të tij, në bazë të ligjit, duke i dhënë për herë të parë fizionominë e plotë këtij sistemi.

Aktualisht, është i pakuptimtë hezitimi, në një kohë kur një grup pune ka vendosur se si duhet të operohet. Nuk është aspak praktikë e mirë drejtuese kryerja e disa veprimeve të cilat bien ndesh me një mendim të përgjithshëm. Në të tilla raste, shprehjet, si në rastet kur merret si argument përvoja e të tjerëve apo në rastet kur anashkalohet, janë të gjetjes së një forme asgjësuese: “mos u merr me to”. Ne mendojmë se mbi të gjitha duhet të vendosim logjikën dhe drejtësinë e mendimit tonë, të bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe vizionin e së ardhmes dhe kjo sepse:

E para, shpesh herë flitet për koston që ka ky apo ai variant i arsimimit ushtarak. Për mendimin tim dhe, për këtë jam i sigurt se nuk është vetëm mendimi im, përfaqësuesit e këtij “argumenti”, nuk e kanë shqetësimin tek ky fakt por tek merakun që nuk e gjejnë vetveten në frymën e tij dhe për këtë përpiqen të spekulojnë me koston, pa bërë asnjë llogari. Këta përfaqësues e zvarrisin aq shumë koncentrimin e mendimit të tyre deri në atë pikë sa e vërteta faktike zbehet për t'ia lëshuar vendin “të vërtetës” publike tek e cila duket sikur mbrohen. Për këtë arsye, duke u orvatur të sjellin e të shpikin variante, nëpërmjet përvojave imagjinare, por nuk kanë as mundësinë dhe as shansin të ndryshojnë gjërat shpejt sepse nuk janë vetë të sigurtë për atë që shprehin.

Prandaj gjithmonë ato duhet të merren me rezerva, për të mos thënë që duhen më-

njanuar. Kjo sepse kur diskutimet mbyllen rreth një cikli, i cili i shmanget ekspertizës dhe koncepteve bazë të debatit, produkti që del sipas koncepteve të punës në grup, është gjithmonë i destinuar të shuhet ose më e keqja të gjejë një zbatim duke përkeqësuar më shumë situatën.

Për të shmangur debatin filozofik për këtë problem po sjell referencën austriake, vend i cili është më i zhvilluar se ne, ka një popullsi relativisht të vogël, një ushtri të konsoliduar, përvoja e së cilës është përjetuar në vendin tonë dhe në të njëjtën kohë kemi shumë oficerë që kanë studiuar dhe janë arsimuar në këtë vend. Ajo ka një sistem të konsoliduar të arsimit ushtarak por dhe shumë të integruar dhe të tra-nsferueshëm në kredite në të gjithë sistemin shtetëror. Institucionet e arsimit ofrojnë 29 profesione civile bazë dhe arsimimi i oficerëve të rinj ka bazën në 180 kreditet e ciklit të parë, plotësisht të integrueshëm në të gjithë ciklet e studimit në Austri.⁸

Në pamje të parë duket sikur ky variant ka kosto të lartë dhe nuk ka pse sillet si argument tek ne. Për fat të keq ne rendim pas fitimit dhe perceptimit të shpejtë të efektit kosto. Të tjerët e presin atë ngadalë dhe të sigurtë por në mënyrë të vazhdueshme dhe gjithnjë në një kah. Varianti austriak është i njëjtë me atë gjerman, me atë hollandez, me atë italian, por edhe me atë turk, por secili ka veçoritë e veta në përputhje me kapacitetet e secilit vend, duke ruajtur në thelb vlerën integruese e rehabilituese të profesionit të oficerit në të gjithë fushat e jetës civile.

Si vende më të zhvilluara se ne dhe si të konsoliduara në të gjitha drejtimet, duke e kuptuar drejt konceptin mbi arsimimin në tërësi, janë përpjekur dhe përpiqen të zhvillojnë ato koncepte që i lidhin profesionet njeri me tjetrin, në mënyrë të tillë që askush të mos ngelë skllav i specifikës dhe veçorisë së një profesioni i cili sa vjen e “tkurret”, siç është profesioni ushtarak, duke zhvilluar koncepte larg mendimit dhe trysnisë së koston.

“Ne duhet të ndajmë përfundimisht fushën e arsimit me elementet e tjerë të jetës publike dhe politike, me qëllim që të zbatohet vetëm në kuadër të saj një koncept autoriteti dhe një qëndrim ndaj një të kaluarë që i përshtatet brezit të ri, por që nuk ka më vlerë të përgjithshme dhe që nuk mund të pretendohet në përgjithësi prej botës së brezave të rritur”⁹

Ky është koncepti që i jep mundësi atyre të operojnë dhe të kooperojnë, duke qenë larg paragjyqimeve dhe mentaliteteve për vendosjen e një diktati mbi vlerat e perspektivës së arsimit. Parimet dhe konceptet bazë në sistemin e arsimit nuk mund t’i paragjykojë kostoja dhe aq më keq trysnia e tutelës administrative të reformave. Mirëpo nëse ndalemi vërtetë në koston e “propaganduar”, modeli gjerman të cilin e zgjodhëm më 1995, nuk kishte atë kosto që pati modeli që sapo mbyllëm dhe nuk ka atë kosto për të cilën mendojmë se funksionon modeli “pasuniversitar”. Kostoja e kësaj përgatitjeje është më e madhe se dy të parat. Kjo sepse atij detyrimisht do t’i duhet të qëndrojë, as më pak e as më shumë, por mbi 5 vjet që të përmbushë ato cilësi që i duhen një nëntogeri, në një kohë kur ai do të jetë kapiten.

Së dyti përpjekjet për të trajtuar arsimimin ushtarak si atribut vetëm të linjës së komandimit e të drejtimit ushtarak e kanë futur sistemin e arsimit në kornizën e një procesi drejtimi operacional. Në fakt kushtetuta e R.Sh. i jep një liri të plotë akademike institucionit. E keqja është se ne e përkufizojmë lirinë akademike sipas pikëpamjes dhe konceptit të njërit apo tjetrit. Por nëse do ta shohim në funksion të qëllimit të institucionit, me liri akademike do të kuptohet autonomi e plotë që, brenda kornizës ligjore, brenda kuadrit të mbështetjes së shtetit dhe mundësisë financiare të tij, brenda të gjithë rregullave e normave të cilat nuk bien ndesh me kushtetutën dhe liritë e të drejtat e njeriut, institucioni ka të drejtën ekskluzive për

hartimin e programeve dhe zhvillimin e mësimi, për emërimin e personelit mësimdhënës, për zhvillimin e kualifikimit të personelit akademik, etj.

Kjo do të thotë se diktati ndaj institucionit të arsimit është tutelë ndaj procesit të arsimit dhe, për rrjedhojë, rrënim i procesit të arsimit. Në bazë të kësaj logjike, profesioni i oficerit është një aspekt i veçantë i profesionit të specialistit apo ekspertit të sigurisë e të mbrojtjes. Arsimit ushtarak, në këtë mënyrë, hedh një hap shumë të rëndësishëm, ai del jashtë “kornizës” së të qenurit i mbyllur dhe i preferuar vetëm për Forcat e Armatosura.

Së treti, ligji krijon shanse dhe mundësi që profesioni i oficerit, duke përbushur standartet e përcaktuara në ligj, të jetë i integrueshëm në kredite me të gjithë diplomat e tjera të universiteteve të vendit apo me universitete të tjera ndërkombëtare. Me këtë, si oficeri ashtu edhe kushdo tjetër që zotëron një diplomë të ciklit të parë, të dytë apo të tretë të studimeve, mund të marrë një diplomë të dytë të atij niveli duke transferuar kreditet e barazvlefshme nga një profesion në tjetrin. Kjo është një arritje shumë cilësore të cilën duhet ta zhvillojmë.

Në këtë mënyrë, oficeri ka të gjitha mundësitë që t’i drejtohet auditorëve të universiteteve të vendit për të marrë një diplomë të dytë të çfarëdo cikli, duke transferuar kreditet që ka fituar pranë akademisë ushtarake. Në këtë kuptim, profesioni i oficerit është një profesion i integrueshëm në të dy kahet, d.m.th nëse një civil i cili zotëron një diplomë të ciklit të parë në një profesion të akreditueshëm, mund të marrë një diplomë të këtij cikli, duke transferuar kreditet pranë Akademisë Ushtarake, për të marrë profesionin në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë dhe ky nuk është kusht vetëm për oficerët.¹⁰

Së katërti, profesioni i oficerit duhet të ketë dinjitetin e vet publik. Duke e vlerësuar hapësirën e krijuar si një mundësi reale, nuk ka dyshim se ligjvënësi e ka dhënë verdiktin e vet publikisht dhe juridikisht. Për këtë arsye është e domosdoshme që arsimit i oficerëve të rinj të trajtohet si arsimim i nivelit universitar, me të gjitha standardet që përcakton ligji. Ky është një trend zhvillimi gjithëpërfshirës i procesit të arsimit në kuadrin e Kartës së Bolonjës por edhe disa nismave europiane për arsimimin ushtarak. Prandaj hartimi i një programi arsimor për këtë cikël studimi e vendos arsimimin ushtarak në një kornizë ligjore por edhe logjike, si pjesë përbërëse e koncepteve themelore të arsimit të të gjithë shoqërisë. Me këtë, profesioni i oficerit trajtohet i barasvlershëm me të gjitha profesionet e tjera dhe ky nuk është slogan, por realitet.

Nëse do të kishte ndonjë version i cili siguron përgatitjen e oficerëve për nevojat e FA duke u nisur vetëm nga aspekti i kostos aktuale, do të thotë se akoma vazhdon të qëndrojë në zhvillimet moderne rendja pas përfitimit të shpejtë, duke deformuar perspektivën e së ardhmes. Në të njëjtën kohë, nëse do t’i shtohet edhe “përrulësia” përpara përvojës së të tjerëve, sistemi i arsimit të oficerëve do të jetë gjithnjë në krizë.

Investimi në procesin e arsimit nuk mund të lidhet me koston aktuale, por me perspektivën e saj. Kjo tashmë konsiderohet si një aksiomë për të cilën janë shprehur shumë sociologë. Aq më tepër kur investimi i aktualitetit e jep rendimentin vetëm pas 20 apo 30 vjetësh. Është me vend të sjell një thënie të lashtë të cituar nga shumë politologë, sipas të cilëve “kush ndalet gjatë me koston reale të arsimit, konsumon koston e të ardhmes”.

Mos vallë kjo ka ndonjë nuancë aktualiteti apo njerëzit nuk lexojnë?

Gjithashtu po zë vend një tendencë e çuditshme për të mohuar ose nënvlerësuar në skaje ekstreme arsimimin brenda vendit. Do të mjaftojë një arsimim i çfarëdo lloji, në vende të tilla si SHBA, Gjermania, Italia, Anglia e gjetkë, për të ezauruar të gjitha nivelet e arsimit brenda vendit. Në këtë mënyrë, mbivlerësojmë një kurs të kryer jashtë vendit, vetëm nga

emri i vendit, pavarësisht nga vlera e kualifikimit që përfaqëson ai arsimim në atë vend, duke e nënvlerësuar jashtëzakonisht shumë arsimimin në institucionet tona dhe bashkë me të dinjitetin e tyre.

Me këtë sjellje, nga njëra anë tregojmë se nuk njohim vlerën e sistemit dhe institucionit të arsimit, duke nëpërkëmbur identitetin kombëtar të vlerave tona dhe, nga ana tjetër, fyejmë vetë sistemin e arsimit të vendit ku jemi arsimuar pasi edhe ata habiten me qëndrimin tonë¹¹. Sinqerisht më kujtohet një bisedë e një pedagogu në Gjermani i cili, nëpërmjet shakasë, iu drejtua një të huaji nga vendet e Afrikës duke i thënë “besoj se ti me këtë arsimim në Gjermani do të bëhesh Shefi i Shtabit të Përgjithshëm në vendin tënd apo Ministër”. Kursanti iu përgjigj me seriozitet: “shoku im bëri grusht shteti dhe është President”.

Në të njëjtin përfundim do të arrihej edhe për sistemin tonë të arsimit. Nëse dikush ka marrë arsimimin e kapitenit dhe e vlerëson me arsimimin e gjeneralit në vendin e tij, kjo nuk është vlerë as për ne dhe as për atë me të cilin bashkëpunojmë. “Më thuaj me kë rri, të them se kush je” ka efekte psikologjike universale në marrëdhënie dhe kjo, jo vetëm tek ne, prandaj edhe korniza formale e tyre ruhet dhe kontrollohet fizikisht dhe juridikisht.

Sistemi legjislativ shqiptar e ka përcaktuar saktë procedurën për raste të tilla, por edhe institucionet përkatëse me rregullat e statutet e tyre që duhen respektuar. Kjo është e rëndësishme si për dinjitetin e profesionit dhe karrierës së oficerit ashtu edhe për autoritetin e institucionit dhe vlerat kombëtare të arsimit.

Unë jam i sigurt se procesi nuk mund të ndalet, ai mund të pengohet nëse nuk ekziston vullneti por profesioni i oficerit do të jetë një profesion që do të përzgjidhet nga pjesa më intelektuale e shoqërisë. Ai do të jetë një profesion me bazë ligjore dhe arsimore shumëdimensionale, i integrueshëm por edhe i transferueshëm. Unë jam i sigurt për këtë pasi ka bazë reale, është i kërkuar dhe po zë një vëmendje të veçantë në kuadrin e rehabilitimit profesional. Çdo oficeri, në të ardhmen, mund t’i krijohen mundësi, 2-3 vjet përpara se të lerë profesionin e oficerit, qe te pajiset me një diplomë të dytë duke krijuar hapsira punesimi dhe integrimi.

Në këtë kuptim, rruga e vetme për të qenë pjesë e trajtuar në Ligjin e Arsimit të Lartë, është respektimi i kriterëve që përcakton ky ligj. Personalisht, nuk shoh ndonjë alternativë më të përshtatshme dhe më dinjitoze.

Përfundime

Logjikisht, duke u ndalur në analizën e të gjithë faktorëve, arsimimi i shtetasve, për problemet e mbrojtjes dhe sigurisë, duhet të përfshijë edhe oficerët. Kështu që, duam apo nuk duam, do të jemi pjesë e këtij ligji, vetëm në këtë këndvështrim.

Nëse ka ide, mendime apo vizione skeptike në lidhje me mundësitë dhe kapacitetet, le të ulen institucionet e arsimit edhe njëherë, në respekt të këtyre ideve dhe mendimeve, për të vendosur. Kjo është rrugë e gjetjes së të gjithë interesave në një qëllim, si pjesë e motivit të tyre për të patur një profesion të vlerësuar dhe me identitet kombëtar përfaqësimi.

Argumentet që sillen në mbështetje të ndërtimit të sistemit të arsimit, në bazë të ligjit, janë bërë tashmë pjesë e vetëdijes së të gjithë atyre qe zotërojnë ligjin e arsimit të lartë dhe logjikën që shoqëron implementimi i tij.

Prandaj, duke shmangur tendencën për të mbajtur “nën kontroll” arsimimin, të krijojmë dhe një frymëmarrje më të gjerë për vetë institucionin dhe vetë sistemin e arsimit, për të dhënë verdiktin e vet mbi zhvillimin e personalitetit të drejtuesit të institucionit të sigurisë dhe jo

vetëm të atij ushtarak. Forcat e Armatosura, në këtë drejtim, duhet të japin një shembull origjinal në lidhje me dimensionin e ri që ato kanë dhe rolin që luajnë edhe në procesin e arsimit. Ato duhet të jenë vetë të interesuara për të bërë lidhjen dhe integrimin me të gjithë sistemin tjetër shtetëror dhe shoqëror. Ushtarakët e dinë se “ Mbijetesa e kombit varet nga masa se sa qytetarët me talent e karakter e bëjnë ushtrinë profesion të vetin si dhe nga masa se sa aftësi dhe përvojë kanë FA në kohë paqeje¹²”, por nuk kanë as më të voglën mundësi t’i imponohen asaj. Për këtë arsye, një hapje e tillë, siç po ndodh tani, vetëm veprimtari e dëmshme nuk mund të jetë.

Institucionet e arsimit kanë nevojë për lirshmëri në debate akademike dhe jo biseda zyrahe të mbyllura. Mirëpo kjo nuk vjen nga roli i saj, por nga ata të cilët e mbështesin, nga ata që e duan dhe e vlerësojnë arsimimin si proces të domosdoshëm zhvillimi, nga roli i atyre që sigurojnë hapësirën frymëmarrëse. Kjo hapësirë krijohet vetëm me vullnet, brenda të gjitha normave të legjislativitetit por, në asnjë rast, nëpërmjet diktatit “për të ndërtuar shtëpinë tënde siç dua unë meqenëse të jap paratë”. Prandaj edhe sistemi legjislativ por edhe kushtetuta e quan të shenjtë autonominë dhe po aq të shenjtë investimin.

Trajtimi i kësaj çështjeje nuk synon dhënien e zgjidhjes dhe as marrjen e stafetës. Ai është thjeshtë një shpalosje mendimi si një studiues akademik i kësaj fushe. E vlerësova personalisht si detyrim personal për të dhënë mendimin tim, në respekt të të gjithë atyre që udhëhoqa në procesin e diskutimit të këtij problemi madhor.

Referenca

¹ Nga Konferenca e Vlorës: “Vizioni i Arsimit ushtarak shqiptar”, 14.5.2009.

² Shih paraqitjen grafike për të kuptuar rrugën e zhvillimit të arsimit ushtarak.

³N/Kol. P. Widerski, nga biseda, në maj 1998, në departamentin e DM në AM i cili ka dhënë një kontribut të çmuar për institucionalizimin e formave didaktike të mësimdhënies në këtë akademi.

⁴ Neni 26, pika 4 e Ligjit të Arsimit të Lartë.

⁵ B.Obama:”Guxo për të shpresuar”, fq.196.

⁶ Nga materialet mësimore në AM, “Punë në Grup, Puna në shtab, Procesi i Vendimmarrjes”.

⁷ Ligji për Arsimin e Lartë në RSh, neni 6, pika 1.

⁸ Studiengang Militärische Führung www.bundesheer.at

⁹ Hannah Arendt: “ Tetë esetë e mendimit politik”, fq. 163.

¹⁰ Ligji për Arsimin e Lartë, Neni 36 dhe 37.

¹¹ Ata shprehën thjesht “ky është jo vlerësim i palës shqiptare dhe jo i yni”. Nga biseda e këtyre ditëve me përfaqësuesit e disa vendeve në të cilat janë arsimuar oficerët tanë: konkretisht Gjermani, Turqi dhe Greqi, kjo për shkak të presionit për ekuivalentimin e arsimit të kryer.

¹² S. Hantington: “Ushtaraku dhe Shteti”, fq. 214.

Stërvitja dhe kaloritë në krijimin e trupit

MSc. Valbona Zeka,
Pedagoge në AU “Skënderbej”

Abstrakt. *Niveli fizik i një ushtari ka një ndikim të drejtpërdrejtë në gatishmërinë e luftimit. Studimet kërkimore mjekësore rreth efekteve që marrin pjesë rregullisht në programet fizike të ruajtjes dhe zhvillimit të aftësive fizike, kanë dalë në përfundimin se një program fizik i shëndetshëm rrit cilësinë e jetës së një personi.*

Komandantët dhe drejtuesit mund ta përdorin këtë informacion duke paraqitur një zhvillim inteligjent, programet e ruajtjes, të zhvillimit të aftësive fizike dhe të ushqyerjes së repartit apo njësisë. Oficerët drejtues të stërvitjes, pedagogët si dhe instruktorët (ndihmës instruktorët) e përgatitjes fizike duhet të sigurojnë që të gjithë ushtarakët (nënoficerët, oficerët dhe ushtarët profesionistë) të mbajnë një nivel të lartë fizik, sipas këtyre udhëzimeve, politikave dhe procedurave për një program të ri të ruajtjes dhe zhvillimit të aftësive fizike të personelit të FA.

Hyrje

Krijimi i trupit, që nënkupton sasinë relative të yndyrnave, organeve, kockave dhe muskujve, është një nga pesë komponentët e shëndetit dhe aftësisë fizike. Përgatitja e një trupi të përkryer mund të arrihet përmes një diete të përcaktuar me kujdes dhe ushtrimeve fizike. Shembuj të krijimit jo të mirë të trupit janë njerëzit me muskuj të pazhvilluar apo njerëzit e shëndoshë. Ata që janë të shëndoshë (mbi peshë) janë raste që ndodhin më shpesh.

Ushtarakët (oficerë, nënoficerë, studentë apo ushtarë profesionistë), me një krijim jo të mirë të trupit, janë problem për Forcat e Armatosura pasi ata nuk janë në gjendje të veprojnë si shokët e tyre me krijim të mirë të trupit.

Kur një ushtarak shëndoshet, aftësitë e tij fizike bien dhe shtohen mundësitë për të marrë sëmundje të ndryshme. Sipas statistikave të nxjerra, rezulton se individët me nivel të lartë yndyre në trup nuk janë të aftë sa ata me nivel të ulët të yndyrës në trup.

Përgatitja e dobët e trupit ka një efekt negativ në paraqitje ndaj besimit në vetvete dhe, gjithashtu, ndikon negativisht në sjelljen dhe moralin e ushtarakëve. Sasia e yndyrës në trup, kur i referohemi sasisë së saj si % e peshës totale të trupit, quhet përqindje e yndyrës së trupit. Maksimumi i lejuar i kësaj përqindje, për meshkuj dhe për femra, tregohet në tabelën e mëposhtme.

Krijimi i trupit ndikohet nga mosha, dietat, niveli i gjendjes fizike dhe faktorët gjenetikë (seksi dhe formimi i trupit). Një person i cili peshon më shumë se standarti i vendosur, nuk është e thënë se është i shëndoshë me doemos. P.sh. disa atletë muskulozë kanë një peshë trupore që kalon vlerat e përcaktuara për moshën, seksin dhe gjatësinë që ata kanë.

Ushtarakët që nuk përmbushin standartet e përcaktuara për moshën, gjatësinë apo kur pamja e jashtme e të cilëve tregon deformime (janë tepër të shëndoshë, etj.) duhet të vlerësohen nëpërmjet metodës së matjes së perimetrit të trupit, e treguar kjo në Manualin e Përgatitjes Fizike të FA¹.

Standartet e yndyrës trupore

Mosha (vjeç)	17-20	21-27	28-39	40+
Meshkuj	20%	22%	24%	26%
Femra	30%	32%	34%	36%

Një mënyrë më e saktë për të përcaktuar përgatitjen e trupit është duke bërë matjen nën ujë. Sidoqoftë, kjo është një metodë që kërkon më shumë kohë dhe shpenzime dhe zakonisht kryhet në spitale dhe universitete.

Ushtraket që nuk përmbushin standartet (që janë të shëndoshë, etj), i nënshtrohen një programi të posaçëm stërvitor edhe mjekësor në përzgjedhjen e dietave të duhura, për të bërë të mundur kthimin e tyre në gjendjen e kërkuar.

Dietat dhe ushtrimet fizike

Një kombinim i duhur i dietave me ushtrimet fizike është mënyra më e mirë për të reduktuar peshën e tepërt trupore. Të humbasësh një ose dy kilogramë në javë është një synim mjaft ambicioz por që mund të arrihet duke ulur nivelin e kalorive, të cilat merren duke rritur ngarkesën fizike.

Ushtraket, vazhdimisht, duhet të konsumojnë një numër të vogël kalorish, me anë të ushqimeve të ndryshme, të shpërndara këto në të gjitha vaktet që merren gjatë ditës. Kjo bën të mundur një konsumim të rregullt të vitaminave dhe kalorive të nevojitura. Një individ që nuk është nën vëzhgim mjekësor, duhet të konsumojë një numër kalorish që arrijnë në 1500, ndërsa gratë të paktën 1200 kalori. Dietat që çenojnë këtë numër kalorish nuk është mirë të përdoren.

Të përpiqesh të humbësh peshë me dieta dhe me pajisje të ndryshme, apo duke ulur vaktet, nuk funksionon për humbje peshe afatgjata, duke qenë se pesha e humbur me këto praktika është vetëm ujë dhe inde muskujsh dhe jo yndyrna (dhjamë, etj.).

Të humbasësh peshë, në një mënyrë të shëndetshme, kërkon kohë dhe durim pasi nuk ekziston ndonjë mënyrë e shpejtë dhe e lehtë për të përmirësuar ndërtimin e trupit. Një individ që i nënshtrohet shpesh vetëm dietave dhe jo stërvitjes, humbet inde muskulore të cilat ndikojnë negativisht në aftësinë fizike.

Stërvitja, jo vetëm djeg kalori, por ndihmon trupin të ruajë masën muskulore dhe mban lart nivelin metabolik gjatë dietës. Pështja mund të ulet me anë të ushtrimeve vetëm nëse përdoret oksigjeni. Ushtrimet aerobike që kërkojnë një sasi të madhe oksigjeni janë aktivitetet më të mira për të ulur peshën e trupit.

Ushtrimet jo aerobike, si vrapimet e shpejta apo ngritja e peshave nuk janë rezultative në këtë drejtim. Të ushtruarit vetëm, pa dietë, nuk është një mënyrë e mirë pasi një njeri i zakonshëm, për një milje vrap, konsumon vetëm 100 kalori dhe për 3500 kaloritë që ka një kilogram i bie të vrapojë 35 milje. Në fakt, edhe gjatë ushtrimeve aerobike, nuk konsumohet vetëm dhjamë por edhe karbohidrate. Kështu që për të tretur një kilogram dhjamë i bie të vrapojmë rreth 50 milje².

Një kombinim i mirë i dietës me stërvitjen është provuar të jetë mënyra më e mirë për të humbur sasi të konsiderueshme të peshës trupore. Specialistët e përgatitjes fizike mund të përcaktojnë ushtrimet më të efektshme të cilat, së bashku me dietat e caktuara nga specialistët, bëjnë të mundur humbjen e dhjamt dhe ruajtjen e aftësive fizike.

Kaloritë dhe stërvitja

Përveç të stërviturit, kaloritë, e marra me anë të ushqimit, luajnë një rol të rëndësishëm në arritjen dhe ruajtjen e një shëndeti fizik. Përdorimi i dietave të studiuara mirë jep mundësinë për të dhënë maksimumin e mundshëm. Sidoqoftë, një dietë e pashoqëruar me stërvitje, nuk mund të jetë rezultative për të arritur një nivel të kënaqshëm të përgatitjes fizike. Ushtarakët duhet të njihen me këto udhëzime në mënyrë që të shmangët mundësia e rritjes në peshë, por edhe të merren kaloritë e nevojitura për të përballuar si duhet ngarkesën fizike, për një shëndet të mirë dhe një gatishmëri mendore.

Udhëzime për një ushqim të shëndetshëm

Të hash një shumëllojshmëri ushqimesh dhe të mbash një balancim të energjive është parimi kryesor i një diete të shëndetshme. Për të marrë kaloritë e duhura, ushtarët duhet të konsumojnë ushqime të shumëllojshme.

Një dietë e përcaktuar mirë duhet të përmbajë vitaminat e duhura për të ruajtur shëndetin trupor. Të rriturit që gëzojnë një shëndet të mirë dhe që zbatojnë dietat e lartpërmendura nuk nevojitet të marrin vitamina apo zëvendësues të këtij lloji në mënyrë artificiale.

Deri tani, nuk është vërejtur ndonjë gjë pozitive nga të konsumuarit e tepërt të një lloji të caktuar vitaminash, ndërsa ekziston mundësia e efekteve negative nga ky veprim. Në mënyrë që një individ të marrë energjitë e duhura për të përballuar stërvitjen, duhet të konsumojë ushqime të shumëllojshme për të arritur balancën e duhur. Pra, atij i duhet të konsumojë tre vakte në ditë. Edhe vaktet e shkurtra mes vakteve kryesore mund të kontribuojnë në mënyrë pozitive në rritjen e kalorive, po qe se ushqimi i konsumuar është cilësor.

Udhëzime për mbajtjen e dietës:

- Konsumo ushqime të shumëllojshme;
- Ruaj një peshë trupore të shëndetshme për grupmoshën;
- Zgjidh një dietë me nivele të ulëta të yndyrave dhe kolesterolit;
- Zgjidh një dietë me shumë fruta, perime dhe drithëra;
- Përdor sheqer në mënyrë të zbutur (jo të drejtpërdrejtë);
- Përdor kripë dhe sodë në mënyrë të zbutur;
- Mos abuzo me pijet alkoolike.

Udhëzime për ushqimin ditor

Përdor ushqime të shumëllojshme. Sasia varet nga përmasat trupore dhe ngarkesa fizike.³

Lloji i ushqimit	Numri i rekomanduar i shërbimeve/njësi	Sasia e rekomanduar për një shërbim/njësi
Perime	3-5	Një pjatë me perime të freskëta ose një gjysmë pjate me perime të gatuar
Fruta	2-4	Një frut mesatar ose një gjysmë gote me fruta të grira ose $\frac{3}{4}$ e një gote me lëng frutash
Bukë, brumëra të ndryshme	6-11	1 fetë bukë
Qumësht, kos, djathë Mishra të ndryshme	2-3	1 gotë qumësht apo kos, 50g djathë 100g mish

Me balancë kuptojmë barazinë mes kalorive të marra dhe atyre të shkarkuara. Rregulli më i saktë, për të matur sasinë e kalorive të marra, është duke i matur ushqimet përpara se t'i konsumojmë. Të mbash një program ditor ku të shënosh ushqimin e konsumuar dhe aktivitetin fizik të kryer është një formë e mirë për të kontrolluar atë që thamë më lart. Tabela e mëposhtme tregon numrin e kalorive të shpenzuara gjatë kryerjes së ushtrimeve të ndryshme. P.sh. gjatë aktivitetit të hedhjes së shtizës, një njeri harxhon 0.034 kalori për paund në minutë. Kjo do të thotë që një njeri që peshon 150 paund do të djegë 5.1 kalori në minutë ose rreth 306 kalori në orë. Për të matur, në mënyrë të përafërt, numrin e kalorive që shpenzojmë gjatë aktivitetit ditor, shumëzojmë peshën e trupit me 13, po qe se jemi pak aktivë, me 14, po qe se jemi aktivë dhe me 15, po qe se jemi më se aktivë. Numri që del është përafërsisht numri i kalorive që duhet të marrim për të mbajtur atë peshë aktuale që kemi⁴.

Tabela e pasqyrimin të kalorive të shpenzuara

Hedhje shtize	0.034	305	Xhudo, karate	0.87	785
Badminton			Drejtim varke me motor	0.016	
E lehtë	0.039	350	145		
E vështirë	0.065	585	Alpinizëm	0.086	775
Basketboll			Kanotazh	0.118	1000
I lehtë	0.047	420	Vrapime		
I fortë	0.066	595	6mph	0.079	710
Bejsboll			10mph	0.1	900
Brenda/jashtë fushe	0.031	280	12mph	0.13	1170
Hedhje topi	0.039	350	Lundrim	0.02	180
Çiklizëm			Patinazh		
I ngadalë (5mph)	0.025	225	I lehtë	0.036	325
I mesëm (10mph)	0.050	450	I fortë	0.064	575
I shpejtë (13mph)	0.072	650	Ski		
Bouling	0.045	255	Në kodrina	0.059	530
Vallëzimet			I vështirë	0.078	700
Ngadalë	0.029	260	Futboll	0.060	570
Mesatar	0.045	405	Not		
I shpejtë	0.064	575	20 jardë/min	0.032	290
Fencing			45jardë/min	0.058	520
I lehtë	0.033	300	50jardë /min	0.071	640
I fortë	0.057	515	Tenis (tavoline)		
Peshkimi	0.016	145	I lehtë	0.026	235
Futb.amerik.	0.040	360	I fortë	0.060	540
Punë në kopësht	0.024	220	Tenis		
Heqje barërash	0.039	260	I lehtë	0.046	415
Golf	0.029	260	I fortë	0.04	540
Gjymnastikë			Volejbol		
E lehtë	0.022	200	I lehtë	0.036	325
E rëndë	0.056	505	I fortë	0.065	585
Hendboll	0.063	570	Ecjet		
Ngjitje në male	0.063	570	3km/orë	0.022	200
Hipizëm			5km/orë	0.03	270
Ecje	0.019	175	6.5km/orë	0.039	350
Vrap i lehtë	0.046	415	8km/orë	0.064	575
Galop	0.067	600	Ski në ujë	0.053	480
Kros 4.5mph	0.063	565	Wrestling	0.091	820

Mënjanimi i marrjes së yndyrave është një mënyrë tjetër që ndihmon në rezultatet e dietave. Marrja në nivele të larta e yndyrave, sidomos kolesterolit, shkakton një rritje të kolesterolit në gjak.

Kolesteroli në gjak mund të ulet, duke u ushtruar fizikisht dhe duke ulur nivelin e kolesterolit në ushqimet që marrim. Duke ulur nivelin e kolesterolit në gjak, ulim mundësinë e zhvillimit të sëmundjeve koronare të arterieve dhe të ndonjë ataku të mundshëm të zemrës.

Disa probleme përsa i përket një aktiviteti fizik optimal

Principet e kalorive	Veprimet mbështetëse
<ul style="list-style-type: none"> • Konsumo ushqime të shumëllojshme; • Asnjë ushqim i vetëm nuk krijon të gjitha kaloritë e nevojshme; • Ruaj një peshë të kënaqshme trupore; • Një peshë e madhe trupore pengon aktivizimin normal në stërvitje (humbja e peshës arrihet nëpërmes konsumimit të ushqimeve të kontrolluara dhe ushtrimeve fizike); • Shmang konsumimin e dietave me shumë yndyrna; • Këto ushqime krijojnë probleme me peshën trupore dhe mund të çojnë deri në atak zemre; • Shmang konsumimin e tepërt të sheqerit; • Ëmbëlsirat nuk kanë kalori dhe mund të çojnë në probleme dentare. • Shmang sodiumin e tepërt; • Ngrënia e ushqimeve me shumë kripë mund të rezultojë në marrjen në sasi të madhe të sodiunit, çka mund të shkaktojë nivel të lartë të tensionit në gjak; • Shmang konsumimin e pijeve alkoolike. 	<p>Në mensë garanto:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ushqime nga 4 grupet kryesore të ushqimeve: fruta, perime, mishra dhe brumëra; • Nëse është e mundur, bëj vendosjen e ushqimeve në këtë radhë: sallatë, frutë, supë, gjellë e ngrohtë, bukë dhe pije. <p>Në mensë garanto:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Menu me nivel të ulët kalorish; • Racione të vogla; • Pije pa kalori; • Listë të kalorive të artikujve në menu përpara se të merren nga banaku. <p>Në mensë garanto:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vezë, gjalpë dhe margarinë si alternativë; • Qumësht në sasi të vogla; • Shmang yndyrat shtazore dhe vajrat e ndryshme. <p>Në mensë garanto:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fruta si alternativë të ëmbëlsirave; • Lëngje jo të ëmbla; • Reçel me pak sheqer; • Uj kripën në 25%; • Shmang përdorimin e alkoolit (është domethënës në ruajtjen e peshës dhe aftësive fizike).

Karbohidratet, në formën e sheqernave, janë ushqimi kryesor i muskujve gjatë aktiviteteve të shkurtra me intensitet të lartë. Stërvitja intensive, në mënyrë të vijueshme, harxhon këto sasi karbohidratesh.

Trupi përdor yndyrën trupore (dhjamin) për t'u rezistuar aktiviteteve të tejzgjatura siç është vrapimi për një orë. Fillimisht trupi harxhon karbohidratet por, në varësi të gjatësisë dhe ngarkesës së ushtrimit, fillon edhe harxhimi ose konsumimi i dhjavit.

Ngrënia e ushqimeve të pasura me karbohidrate ndikon në krijimin e rezervave të aminoacideve, të rëndësishme këto në formimin e proteinave. Të paktën 50% e kalorive në

dietë duhet të vijë nga karbohidratet. Kërkesat për kalori ndryshojnë në bazë të madhësisë trupore, seksit, moshës dhe mënyrës ose intensitetit të stërvitjes⁵.

Duke qenë se ushqimet e konsumuara, 1-3 ditë përpara aktivitetit, japin energjinë e duhur për këtë aktivitet, është e rëndësishme që të konsumojmë çdo ditë ushqime të pasura në tërësi me karbohidrate. Është e rëndësishme të evitojmë ngrënien e çokollatave, deri në 60 min. përpara stërvitjes, pasi ato mund të rezultojnë në nivele të ulëta të sheqerit në gjak gjatë stërvitjes. Shumë dështime vijnë në stërvitje si rezultat i mungesës së përdorimit të ujit.

Uji është domethënës në kapacitetin fizik. Gjatë stërvitjes, ne djersijmë dhe me anë të kësaj djerse bëhet e mundur edhe ulja e temperaturës së trupit. Mirëpo ky ujë i shpenzuar, duhet zëvendësuar pasi, në të kundërt, nuk do të jemi në gjendje të japim maksimumin në stërvitje. Uji duhet konsumuar, si përpara, gjatë dhe në fund të stërvitjes. Pijet sportive, të cilat janë zakonisht karbohidrate të thjeshta dhe elektrolite të shkruara në ujë, janë të dobishme në disa rrethana.

Është provuar që përzierjet që mbajnë deri në 10% karbohidrate, janë në gjendje të hyjnë në trup dhe të japin glukozë shtesë tek muskujt që janë nën ngarkesë. Tejkalmi i kësaj përqindjeje mund të shkaktojë deri dhe diarre. Shumë njerëz mendojnë se atyre që ushtrohen në *body building* iu nevojiten sasi të mëdha proteinash për të përmirësuar rritjen e muskujve të tyre. Funkcionet parësore të proteinave janë rritja dhe riparimi i indeve dhe formimi i enzimave. Proteinat, është provuar të kontribuojnë pak, për të mos thënë fare, në energjinë që kërkojnë ushtrimet me rezistencë të madhe.

Peshëngritësit, të cilët kanë përmasa të mëdha trupore, mund të përvetësojnë lehtësisht kërkesat për proteina me një dietë të balancuar mirë, e cila ka 15-20% të kalorive të saj të mundësuar nga proteinat.

Kaloritë në stërvitjet në terren

Ushtarët, në stërvitjet në terren, duhet të hanë mjaft ushqim, në mënyrë që të marrin energjitë që iu duhen. Ata, shpesh, duhet të konsumojnë mjaft ujë dhe pije jo alkoolike. Ushqimet e gatshme duhet të kenë karbohidratet, proteinat, yndyrat dhe vitaminat e kërkuara. Duke qenë se ushqimet e ndryshme kanë vlera ushqyese të ndryshme, atëherë, është e nevojshme që të mos anashkalojmë asnjërin prej tyre. Pra, një ushtar duhet të konsumojë të gjithë ushqimin e përcaktuar në dietë si rregull që të marrë të gjitha kaloritë e llogaritura. Ushtarët, të cilët janë nën programe të reduktimit të peshës, duhet të konsumojnë atë sasi ushqimi, të përcaktuar nga dietologët specialistë të njësisë.

Stërvitja, siç dihet, është treguesi kryesor për të vlerësuar aftësitë luftarake dhe operacionale të trupave. Niveli fizik i një ushtari ka një ndikim të drejtpërdrejtë në gatishmërinë e luftimit. Studimet kërkimore mjekësore, të drejuara nga ekspertë mjekësorë rreth efekteve që marrin pjesë rregullisht në programet fizike të ruajtjes dhe zhvillimit të aftësive fizike, kanë dalë në përfundim se një program fizik i shëndetshëm rrit cilësinë e jetës së një personi, rrit rendimentin dhe sjell ndryshime fizike dhe mendore në një mënyrë të tillë që një person duket, jeton dhe është i shëndetshëm për detyrën e tij.

Bibliografia:

- Physical Task Training (PTT)
- Training Packet (U.S.A)
- www.physicalreadinesstraining.com

— Përgatitja fizike në FA

Referenca

¹ Manuali “Përgatitja Fizike në FA”, fq.105, 2009.

² Po aty fq.106, 2009.

³ Po aty, fq.1007/107

⁴ Training Packet (U.S.A)

⁵ Po aty, fq.110, 2009.

Komunikimi strategjik dhe rëndësia e tij

Docent Jaup Zenuni,
Shef i Seksionit të Përkthimit të Dokumenteve të Shkruara në QGjH,
Akademia e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”

Abstrakt. *Komunikimi strategjik është një aspekt me rëndësi i shkencës së komunikimit që çdo ditë e më tepër po merr përparësi. Teorikisht ai është trajtuar dhe zhvilluar relativisht vonë, në gjysmën e dytë të shekullit të 20-të, pikërisht në hartimin e Planit Marshall për t’iu kundërvënë komunizmit në Europën e pas Luftës së Dytë Botërore, por praktikave të tij njihen qysh në shoqëritë tribale dhe paramoderne. Termi komunikim strategjik në origjinë është një term ushtarak, por me kalimin e kohës ai zgjerohet në vet duke u bërë çati edhe për terma të tillë si operacione informimi, propagandë, çështje publike, diplomaci publike apo operacione mediatike.*

Sot ai njihet si një komponent mjaft i rëndësishëm i pushtetit të butë. NATO, SHBA-të dhe fuqitë e mëdha kanë vite që i kushtojnë rëndësi këtij komponenti, por veçanërisht pas sulmeve të 11 Shtatorit ai ka marrë përparësi të madhe jo vetëm në trajtimet akademike, por sidomos në hartimin e strategjive, planeve, politikave dhe ngritjen e institucioneve që merren me komunikimin strategjik. Si vend anëtar i NATO-s edhe tek ne ky koncept duhet njohur më shumë teorikisht dhe duhen ndërmarrë hapa konkrete për përvetësimin e parimeve dhe praktikave të tij.

Fjalët çelës: *komunikim strategjik, operacione informimi, diplomaci publike, propagandë, çështje publike, pushtet i butë, pushtet i zgjuar.*

1. Hyrje

Komunikimi strategjik është një koncept relativisht i ri. Ai konsiderohet si një element i rëndësishëm i “pushtetit të butë” ose të atij që kohët e fundit po quhet “pushtet i zgjuar”. Duke qenë se si vend anëtar i NATO-s, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë angazhuar dhe po angazhohen intensivisht në misionet e Aleancës në rajonet ku ka krizë si në Afganistan, Irak, Çad e gjetkë, është e nevojshme që të gjitha kontingjentet të kenë të qartë konceptin dhe praktikave të komunikimit strategjik me qëllim që të orientohen drejt në “teatrin” e përmbushjes së misionit. Kjo shtron nevojën që të njihet mirë strategjia e komunikimit të NATO-s, sidomos nga nivelet e ndryshme të komandimit.

Qëllimi i këtij punimi është që të ndihmojë në mënyrë modeste në këtë drejtim duke

synuar që të zbërthejë konceptin “komunikim strategjik”, të hedh dritë mbi origjinën e komunikimit strategjik, të bëjë dallimin midis komunikimit strategjik, propagandës, operacioneve të informimit dhe diplomacisë publike. Në nivel strategjik, operacional dhe taktik përvoja botërore tregon se ka shembuj pozitivë dhe negativë në përdorimin e komunikimit strategjik. Duke qenë një ushtri e një vendi të vogël, të mbyllur për pesëdhjetë vjet, pa u angazhuar në operacione apo veprimtari jashtë kufijve, ushtria jonë nuk pati trashëgimi në këtë fushë. Procesi i anëtarësimit në NATO, përfshirja e trupave të Forcave të Armatosura shqiptare në misione dhe operacione të Aleancës shtron nevojën jo vetëm të njohjes së konceptit dhe praktikave të komunikimit strategjik, por më kryesorja të zbatimit të tyre në veprimtarinë praktike në terren. Nuk mund të arrihet sukses në luftën “për të fituar mendjet dhe zemrat” pa njohur dhe zbatuar konceptin dhe praktikave të komunikimit strategjik.


Mendimet se “janë vendet e mëdha të Aleancës që duhet të mendojnë për këtë çështje” nuk janë me dobi sepse, duke qenë pjesë e misioneve dhe operacioneve të NATO-s, trupat tona në terren dhe në kontakt me audiencat e vendeve ku kryejnë misionet do të kenë nevojë qoftë për njohuritë teorike, qoftë për parimet dhe praktikën e komunikimit strategjik për dy arsye madhore: së pari, për të garantuar suksesin e Aleancës në atë zonë përgjegjësie që mbulon dhe së dyti, për të përfaqësuar në mënyrë dinjitoze vendin tonë në popullsinë vendase të teatrit të operacionit.

2. Komunikimi strategjik-si ta kuptojmë?

Komunikimi strategjik në literaturën studimore konsiderohet si element i rëndësishëm i fuqisë apo pushtetit të një shteti dhe hyn tek elementët përbërës të “pushtetit të butë” i cili, i kombinuar me element të “pushtetit të fortë”, përbën atë që sot po quhet “pushteti i zgjuar”. Komunikimi strategjik ka marrë përparësi sidomos mbas sulmeve të 11 Shtatorit.

Ekzistojnë disa përkufizime për komunikimin strategjik të cilat përfshijnë në këtë koncept si elementë kryesorë *“operacionet ushtarake të informimit, diplomacinë publike dhe çështjet publike. Në një vështrim, ne mund t’i nxjerrim këta elementë nga elementët përbërës të fuqisë kombëtare, të cilët janë elementë të pushtetit diplomatik, informues, ushtarak dhe ekonomik. Aplikimi koherent i elementëve kombëtarë (dhe të aleatëve) të fuqisë, duke përdorur procese që bazohen tek efektet që japin për realizimin e objektivave strategjike, përcakton strategjinë e mbështetur tek efektet.”*¹

Tabelë Nr. 1: Përmbledhje e kapaciteteve të fuqisë së një shteti



Komunikim strategjik do të thotë komunikim i një koncepti, i një procesi apo i të dhënave që përbushin një objektiv afatgjatë të një organizate, duke lehtësuar planifikimin paraprak apo komunikimin në distanca të largëta, zakonisht duke përdorur telekomunikacionin ndërkombëtar ose asetet e rrjeteve globale, me qëllim që të koordinohen veprimet dhe aktivitetet e njëjësive vartëse me rëndësi operacionale në fushën tregtare, jo tregtare, ushtarake apo luftarake dhe logjistike. Ai nënkupton gjithashtu funksionet që lidhen me lidhjet midis organizatave dhe që mbulojnë proceset e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm. Ky këndvështrim është pak a shumë teknik.

Në raportin me titull “Kuadri Kombëtar për Komunikimin Strategjik”, dërguar presidentit të Senatit Amerikan dhe kryetares së Dhomës së Përfaqësuesve në Kongresin Amerikan,

Presidenti i SHBA-ve Barack Obama, komunikimin strategjik e përkufizon në këtë mënyrë: *“Me komunikim strategjik ne iu referohemi: a) sinkronizimit të fjalëve dhe veprave dhe se si ato do të perceptohen nga audiencat e zgjedhura, si dhe b) programeve dhe veprimtarive që qëllimisht synojnë komunikimin dhe angazhimin me audiencat e synuara, përfshirë këtu ato që zbatohen nga subjektet publike, diplomacia publike dhe operacionet e kryera nga ekspertët e informimit.”*² Ky përkufizim është më gjithëpërfshirës dhe rrok të gjithë elementët e komunikimit strategjik.

Ideja themelore, e shprehur në përkufizimin e mësipërm, zhvillohet më tej në simpoziumin me temë: *“Trajtimi i rrezikut të sotëm asimetrik ndaj SHBA-ve dhe sigurisë globale: përdorimi i pushtetit të zgjuar”*, ku hidhen piketat se si duhet operuar për një komunikim strategjik efektiv. Në këtë simpozium u shtrua kërkesa që: *“Një strategji afatgjatë për zhvillimin e mirëkuptimit dhe zbutjen graduale të perceptimeve do të kërkojë një qasje më strategjike ndaj komunikimit. Kjo do të thotë ndërtim i ekspertizës për të zbatuar një plan të menduar mirë për fushatën strategjike për informimin e një audience të gjerë si brenda ashtu edhe jashtë vendit, mbi natyrën e rrezikut dhe për ndërtimin e rastit për veprim.”*³

2.1. Vështrim historik mbi komunikimin strategjik

Komunikimi strategjik si praktikë është përdorur qysh në lashtësi me përpjekjet e para për transmetimin e njohurive nëpërmjet shkrimit, ose tek brezat pasues, ose në zona të largëta. Përpjekjet më të hershme duket se janë zhvilluar nga përdorimi i mjeteve të ndryshme për t’iu drejtuar botëve shpirtërore apo të pandërgjegjshme, proces i cili, me kalimin e mjaft shekujve, solli fenë e organizuar nën një hierarki politiko-ushtarake dhe fetare. *“Ky proces mund të vërtetohet arkeologjikisht nga pikturat e mëdha të shpellave në Francë, Spanjë, Australi, Afrikën e Jugut dhe në Jug të Shteteve të Bashkuara, apo nga figurinat “Venus” të gjetura gjithandej në Europën qendrore dhe lindore, nga vendet e shenjta të ceremonialeve magjepsëse si Gobekli Tepi në Turqi dhe në tempujt dhe dhomat e varrimit të shoqërive gjysmë nomade apo më të ngjuara të gjahtarëve të mëvonshëm dhe kultivuesve të hershëm, të paktën në periudhën Mesolitike dhe Neolitike që janë ende duke u zbuluar në Europë, Azi dhe Lindjen e Mesme. Këto përpjekje të mëdha fillestare për një komunikim të organizuar ndryshe nga komunikimi spontan dhe personal, siç mund të shihet, janë ritualistike ose protoreligjioze. Ato duket se preokupohen më pak për jetën e përditshme dhe më shumë për shpresat dhe frikën që lidhen me forcat që i mbështesin ato.”*⁴

Në kohët para moderne, vetëm shtetet para moderne kishin nevoja dhe aftësi për komunikim voluminoz. Për ato, ashtu si një për një korporatë, organizatë jo qeveritare apo qeveri moderne, komunikimi preokupohej për kontrollin, formulimin, menaxhimin dhe transmetimin e ideve, ndjenjave dhe të të dhënave, format dhe funksionet e të cilave kishin potenciale për të ndikuar mbi popullsitë e mëdha, të ndryshme nga njëra-tjera dhe me shtrirje të gjerë gjeografike.

Periudha kohore e fuqizimit të Egjiptit rreth fundit të mijëvjeçarit të katërt dhe fillimit të mijëvjeçarit të tretë para erës sonë, e perandorive të hershme Mesopotame, e sunduesve të parë në Kinë, e qytet shteteve greke, e perandorisë romake dhe e shoqërive me origjinë tribale që e zëvendësuan atë në shekullin e pestë të erës sonë, perandoria e Andeve e Inkasve dhe shoqëritë mesoamerikane të Mayave dhe Aztekve është një periudhë e gjatë, por sidoqoftë ajo spikat për strategjinë e komunikimit. *“Qasjet ndaj komunikimit pavarësisht nga epoka, perandoria apo vendndodhja, tregojnë se shoqëritë paramoderne të ndara nga koha, hapësira dhe besimet, kishin kuptim të ngjashëm për komunikimin sepse ato kishin nevoja, pengesa dhe zgjidhje të ngjashme.”*

Tradita e lashtë greko-romake ishte ajo që hodhi themelet e vërteta të komunikimit strategjik. Këshillat dhe analizat e teoricienëve të komunikimit si Aristoteli dhe Ciceroni janë aq bindëse sa vazhdojnë të studiohen edhe sot. Aristoteli, filozofi i shquar grek, teorizonte se tre elementët që nevojiten për të ndikuar mbi audiencën janë *logos* (logjika), *pathos* (apeli emocional) dhe *ethos* (kredibiliteti i folësit). Ciceroni, duke zhvilluar idetë e Aristotelit, mendonte se: “*folësi duhet të zotëronte edhe zgjuarsinë, edhe elokuencën për të qenë bindës*”⁵.

Nevoja për të rritur distancën e transmetimit mund të ketë qenë njëri prej faktorëve që qëndronte pas filozofisë së ‘zbutjes së kalit’ e cila mbeti si modeli kryesor i komunikimit derisa u shfaqën mjete të tjera komunikimi si telegrafia dhe telefonia. Në këtë mënyrë, shtetet dhe shoqëritë filluan të përshtatnin strategjitë e komunikimit për projektimin e imazhit të tyre në përputhje me mediat e reja që kishin në dispozicion.

Në fushën ushtarake të dhënat e para për përdorimin e strategjisë së komunikimit i kemi nga Aleksandri i Maqedonisë. Ai njihet si shpikësi i operacioneve psikologjike me përdorimin e helmetave dhe parzmoreve shumë të mëdha të cilat luftëtarët e tij i linin në fushën e betejës pasi largoheshin prej saj për të krijuar tek kundërshtari imazhin se po luftonte me gjigantët. Udhëheqës të tjerë ushtarakë si Sun Xu (Sun Tsu) dhe Xhengis Kan (Genghis Khan) njihen për metodat e tyre të operacioneve psikologjike ndaj kundërshtarëve.

Uinfilld Skot (Winfield Scott)⁶ ishte nga ata komandantë ushtarakë, që kuptoi rëndësinë e komunikimit strategjik në teatrin e luftës, në Verakruz (Veracruz), në vitin 1847. Duke kuptuar ndikimin e Kishës Katolike në shoqërinë meksikane, Skoti merrte pjesë në meshat e organizuara në Katedralen e Verakruzit bashkë me shtabin e tij për të treguar respektin e forcave të SHBA-ve. Ai gjithashtu urdhëroi ushtarët amerikanë të përshëndesnin priftërinjtë meksikanë në rrugë. Secila prej këtyre masave ishte “*pjesë e fushatës së menduar mirë për të fituar miqësinë e meksikanëve*.”⁷

Historia e mëvonshme e komunikimit strategjik kombëtar në SHBA na tregon përpjekje të organizuara për të portretizuar SHBA-të në mënyrë pozitive me qëllim që të ushtrohej ndikim mbi popujt dhe të bindeshin ata për këtë portret. Komiteti për Informimin Publik (CPI) i ngritur në vitin 1917, i njohur gjithashtu si Komiteti Krill (sipas emrit të shefit të tij Xhorxh Krill-George Creel), kërkoi që të shtrëngonte radhët e publikut amerikan rreth administratës Uillson (Wilson) gjatë Luftës së Parë Botërore. Fokusi i tij ishte audiencia e brendshme dhe ai përdori folësit publikë, reklamat, pamfletet, shtypin periodik dhe industrinë amerikane të figurës së lëvizshme që ishte duke lulëzuar. Përpjekjet e Komitetit për Informimin Publik brenda vendit gjatë Luftës së Parë Botërore patën shumë sukses. Operacionet e tij në kryeqytetet e huaja i dhanë mundësinë Presidentit Uillson që t’i lidhte idealet dhe qëllimet për luftën me audiencën botërore.

Lufta e Dytë Botërore ishte periudha kur u themelua Zyra e Informacionit për Luftën që fokusohet jo vetëm tek audiencia brenda vendit por edhe tek audiencia përtej oqeanëve, me transmetimet në gjermanisht që drejtoheshin për publikun e Gjermanisë Naziste. Radioja “Zëri i Amerikës” filloi transmetimin e saj me deklaratën: “*Këtu po ju flet një zë nga Amerika. Çdo ditë në këtë orë ne do t’ju sjellim lajmet e luftës. Lajmet mund të jenë të mira. Lajmet mund të jenë të këqija. Ne do t’ju tregojmë të vërtetën*”.⁸

3. Parimet e komunikimit strategjik

Në dokumentin “Parimet e Komunikimit Strategjik” të Departamentit të Mbrojtjes së SHBA-ve ⁹ shkruhet se: “*Komunikimi strategjik është përshkruar si orkestrim dhe/ose sinkronizim i*

veprimeve, imazheve dhe fjalëve për të arritur efektin e dëshiruar.” Në dokument theksohet se përmes përpjekjesh bashkëpunuese të Departamentit të Mbrojtjes, të Departamentit të Shtetit, edukatorëve të sektorit civil dhe profesionistëve në fushën e komunikimit strategjik janë konsoliduar dhe përpunuar ato gjëra themelore të përbashkëta të cilat janë shndërruar në nëntë parimet e komunikimit strategjik që i gjejmë të përmbledhura në tabelën që vijon:

Tabelë Nr. 2: Parimet e Komunikimit Strategjik

I drejtuar nga udhëheqësit	
Udhëheqësit duhet të drejtojnë procesin e komunikimit	
i besueshëm	Të kuptuarit
Perceptim i vërtetësisë dhe respektit	Kuptim i thellë i të tjerëve
Dialog	Përçues
Shkëmbim idesh në shumë plane	Çdo veprim dërgon një mesazh
Unitet i përpjekjeve	i bazuar në rezultate
Të integruara dhe të koordinuara	i lidhur me synimet e dëshiruara
Reagues	i vazhdueshëm
Audiençë, mesazh, kohë dhe vend i duhur	Analizë, Planifikim, Zbatim, Vlerësim

Le të ndalemi më në detaje për secilin parim duke iu referuar dokumentit të cituar më sipër:

I drejtuar nga udhëheqësia (lidërshipi) Drejtuesit duhet të angazhohen me vendo-smëri dhe ta udhëheqin procesin e Komunikimit Strategjik.

Për të garantuar integrimin e përpjekjeve për komunikim, drejtuesit duhet ta vënë atë në bazën e çdo gjëje që bëjnë. Komunikimi strategjik i suksesshëm, veprimet, fjalët dhe imazhet e integruara, fillojnë me synime dhe parime të qarta drejtuese të udhëheqësisë. Objektivat dhe rezultatet e dëshiruara më pas lidhen ngushtë me linjat kryesore të operacionit të përvijuar në planin e fushatës së organizatës, komandës apo planin e tyre të përbashkët. Rezultatet janë veprimet dhe fjalët të lidhura në plan. Drejtuesit duhet që gjithashtu të garantojnë burimet e duhura për komunikimin strategjik me prioritet të krahasueshëm me aspektet e tjera të rëndësishme si logjistika dhe zbulimi.

I besueshëm. Perceptim i vërtetësisë dhe respektit midis të gjitha palëve.

Kredibiliteti dhe qëndrueshmëria janë themelet e komunikimit të efektshëm; ato ndërtohen dhe mbështeten në perceptimet e saktësisë, vërtetësisë dhe respektit. Veprimet, imazhet dhe fjalët duhet të integrohen dhe koordinohen brenda dhe jashtë, pa vënë re kontradikta midis fjalëve dhe veprave, apo midis politikës dhe veprave. Komunikimi strategjik kërkon gjithashtu një forcë profesioniste komunikuesish të trajnuar, arsimuar si duhet dhe të vëmendshëm. Kredibiliteti shpesh kërkon komunikim me të tjerët që mund të konsiderohen si më të besueshëm.

Të kuptuarit. Kuptimi i thellë i qëndrimeve, kulturave, identiteteve, historisë, perspektivave dhe sistemeve shoqërore.

Ajo që ne themi, bëjmë apo tregojmë mund të mos jetë ajo që të tjerët dëgjojnë apo shohin. Përvoja, kultura dhe njohuritë e një individi përbëjnë kontekstin që formëson perceptimet dhe, për rrjedhojë, gjykimin e tij për veprimet. Duhet ta kuptojmë se konceptet për vlerat morale nuk janë absolute, por relative dhe të lidhura me mjedisin social dhe kulturor të individit. Audiencat e përcaktojnë kuptimin duke interpretuar komunikimin tonë me to; për këtë arsye ajo çfarë themi, bëjmë apo tregojmë ne, mund të mos jetë çfarë dëgjojnë apo shohin ato. Të vepruarit pa kuptuar audiencat mund të çojë në keqkuptime të rrezikshme me pasoja serioze.

Kuptimi i impakteve subjektive të kulturës, gjuhës, historisë, fesë, mjedisit dhe faktorëve të tjerë është me rëndësi kur hartohet strategjia e komunikimit për një po-pullatë të caktuar. Ndërtimi i marrëdhënieve dhe bashkëpunimit me komunitetet brenda agjencive, bizneseve, koalicioneve, me shtetet pritëse, me komunitetet aka-demike apo ato të organizatave jo qeveritare mund të lehtësojë më tepër kuptimin e audiencave.

Dialog. Shkëmbim shumëplanësh të ideve për të nxitur mirëkuptimin dhe për të ndërtuar marrëdhënie.

Komunikimi efektiv kërkon një dialog shumëplanësh midis palëve. Ai përfshin dëgjimin aktiv, angazhimin dhe arritjen e kuptimit reciprok i cili shpie tek besimi. Suksesi varet nga ndërtimi dhe forcimi i marrëdhënieve. Drejtuesit duhet t'i shfrytëzojnë këto marrëdhënie për t'i vendosur politikat dhe veprimet e vendit në kontekst para operacioneve apo evenimenteve. Zhvillimi dhe zbatimi i suksesshëm i strategjisë së komunikimit rrallë mund të ndodhë për një periudhë të shkurtër; marrëdhëniet duan kohë që të zhvillohen dhe kërkojnë dëgjim, respekt për kulturën dhe ndërtim të besimit.

Përçues. Çdo veprim, imazh apo fjalë dërgon një mesazh.

Komunikimi nuk ka më kufij në kohë dhe hapësirë. Me dashje apo pa dashje të gjithë lojtarët janë komunikues. Çdo gjë që Forca e Bashkuar thotë, bën po nuk arrin ta bëjë dhe ta shprehë, ka pasoja të qëllimshme dhe të paqëllimshme. Çdo veprim, çdo fjalë jep një mesazh dhe çdo pjesëtar i ekipit, nga ai ushtari 18 vjeçar deri tek komandanti, po ashtu jep një mesazh. I gjithë komunikimi mund të ketë impakt strategjik dhe audiencat e pasyruara janë të pashmangshme në mjedisin global të informacionit, prandaj drejtuesit duhet të mendojnë për rezultatet e shumëfishta të mundshme që mund të kenë veprimet e tyre në komunikim.

Unitet i përpjekjeve. Të integruara dhe koordinuara, vertikalisht dhe horizontalisht.

Komunikimi strategjik është një proces konsistent dhe bashkëpunues që duhet integruar vertikalisht nëpërmjet niveleve taktike dhe horizontalisht nëpërmjet të gjithë aktorëve kryesorë. Drejtuesit koordinojnë dhe sinkronizojnë kapacitetet dhe instrumentet e fuqisë brenda zonës së tyre të përgjegjësisë, zonave të influencës dhe zonave të interesave për të arritur rezultatet e dëshiruara. Duhet të kihet parasysh fakti se agjencia/organizata juaj nuk do të veprojë vetëm. Në kushte ideale, të gjithë ata që mund të kenë një impakt të caktuar, duhet të jenë pjesë e integritetit të komunikimit.

I bazuar në rezultate. Veprime për të arritur rezultate specifike në përputhje me një synim të artikuluar mirë.

Komunikimi strategjik duhet të fokusohet në arritjen e rezultateve specifike të dëshiruara, në përputhje me synimet e përcaktuara mirë. Proceset, temat, objektivat dhe mënyrat e angazhimit në komunikim rrjedhin nga politika, vizioni strategjik, planifikimi i fushatës dhe nga qëllimet operationale. Komunikimi strategjik nuk është thjesht “një mjet tjetër në rutinë

e veglave të drejtuesit”, ai duhet të udhëheqë gjithçka që një organizatë bën dhe thotë, duke përfshirë dhe duke u harmonizuar me funksione të tjera për të arritur rezultatet e dëshiruara.

Reagues. Audiencia e duhur, mesazhi i duhur, koha e duhur dhe vendi i duhur.

Komunikimi strategjik duhet të fokusohet në synime afatgjata ose rezultate të dëshiruara. Reagimi i shpejtë dhe në kohë, ndaj kushteve që ndryshojnë dhe ndaj krizave, është i rëndësishëm, meqë këto mund të kenë efekte strategjike. Strategjia e komunikimit duhet të prekë audiencat e synuara nëpërmjet një mesazhi të përqasur, i cili është ai që duhet për ato audiencia. Komunikimi strategjik përfshin një diskutim më të gjerë për bashkërendimin e veprimeve, imazheve dhe fjalëve për të mbështetur politikën, objektivat mjaft të rëndësishme strategjike dhe perspektivën më të gjerë dhe në afat kohor më të gjatë. Duke vepruar brenda cikleve të vendimeve të kundërshtarëve, është gjithashtu me mjaft rëndësi sepse ritmi dhe përshtatshmëria kanë rëndësinë e tyre. Shpesh mund të kemi një hapësirë të kufizuar mundësisish për mesazhet specifike që të arrijnë një rezultat të dëshiruar.

Një organizatë e caktuar duhet të mbetet mjaft fleksibël për të atakuar çështje specifike me audiencia specifike, shpesh në momente specifike kohore, duke komunikuar që të arrijë efektin më të madh. I gjithë komunikimi mbart një rrezik të brendshëm dhe kërkon që të pranohet një nivel rreziku brenda organizatës. Drejtuesit duhet të zhvillojnë dhe kultivojnë një kulturë që shpërblen iniciativën, por jo reagimet e tepruara ndaj dështimeve dhe mosrealizimeve. Me rrezikun duhet merremi duke reflektuar në planifikim. Ai nuk duhet të frenojë lirinë e veprimit të drejtuesve, me kusht që të jetë marrë në konsideratë ashtu siç duhet.

I vazhdueshëm. Punë kërkimore e vazhdueshme dhe me zell, analiza, planifikim, zbatim dhe vlerësim që ushqen planifikimin dhe veprimin.

Komunikimi strategjik është një proces i vazhdueshëm për punë kërkimore dhe analiza, planifikim, zbatim dhe vlerësim. Suksesi në këtë proces kërkon analiza të vazhdueshme dhe me zell dhe vlerësim të mendimeve e sugjerimeve në planifikim dhe veprime. Komunikimi strategjik mbështet objektivat e organizatës duke u për-

shtatur ashtu siç nevojitet dhe me ndryshimin e planit.

4. Komunikimi strategjik, operacionet e informimit, çështjet publike, propaganda dhe diplomacia publike

Duke qenë se si diplomacia publike, si komunikimi strategjik janë koncepte të trajtuara vonë në literaturën akademike, shpesh ka një farë konfuzioni. Herë herë ka mbivendosje të roleve të tyre, herë herë diplomacia publike konsiderohet si pjesë e komunikimit strategjik dhe herë herë ka përpjekje për të përcaktuar kufijtë e ‘domeneve’ të secilit prej termave. Diplomacia publike shpesh dallohet nga komunikimi strategjik, çështjet publike, propaganda dhe operacionet psikologjike apo krahasohet me to. Këto koncepte mund të strukturohen në nënkategoritë analitike të mëposhtme:

Tabelë Nr. 3: Nënkategoritë e komunikimit strategjik

Komunikimi strategjik		
Çështjet publike	Diplomacia publike	Operacionet e informimit
Manipulimi		
	Propaganda	Operacionet psikologjike
	E bardhë, gri, e zezë	
	Reklama, Marrëdhëniet me publikun.	

Komunikimi strategjik në origjinë është termi alternativ ushtarak për diplomacinë publike por, në vitet e fundit, është kthyer në parimin koordinues për diplomacinë publike, çështjet e publikut dhe operacionet e informimit. Ai mori këto tipare dhe u shndërrua në fokusin kryesor për transformimin e Departamentit të Mbrojtjes së SHBA-ve, si rezultat i një studimi të kryer nga Bordi Shkencor i Mbrojtjes. Sipas studimit, komunikimi strategjik i referohet:

“Një morie instrumentesh të përdorura nga qeveritë për brezat, me qëllim që ata të kuptojnë qëndrimet dhe kulturat globale, të angazhohen në një dialog idesh midis njerëzve dhe institucioneve, të këshillojnë politikëbërësit, diplomatët dhe drejtuesit ushtarakë mbi pasojat e pjesëmarrjes së opinionit publik në zgjedhjen e alternativave politike dhe të ndikojnë mbi qëndrimet dhe sjelljen nëpërmjet strategjive të komunikimit.”¹⁰

Sipas studimit, qëllimi i komunikimit strategjik është *“...të ndihmojë në formimin e kontekstit dhe ndërtimin e marrëdhënieve që nxitin arritjen e objektivave politike, ekonomike dhe ushtarake”*. Departamenti Amerikan i Shtetit formalisht bën dallimin midis *diplomacisë publike* dhe *çështjeve publike* në saj në Aktin e Shkëmbimit të Informacionit dhe Edukimit të SHBA-ve, të vitit 1948 (Ligji Publik 402), që më shumë është i njohur si Akti Smith-Mundt. *Çështjet publike* i referohen *“garantimit të informacionit për publikun, shtypin dhe institucionet e tjera në lidhje me objektivat, politikat dhe veprimtaritë e qeverisë së SHBA-ve.”¹¹* Pra, në rastin e *çështjeve me publikun*, audiencia është brenda vendit, pra e brendshme, kurse audiencia e diplomacisë publike është e huaj, në shtete të huaja. *“Qëllimi i ndarjes formale midis çështjeve me publikun dhe diplomacisë publike ishte që të krijoheshin barriera ndaj kontrollit të informacionit në nivel kombëtar ose, shprehur me një formulim më të thjeshtë, të ndalonte qeverinë që t’i bënte propagandë publikut amerikan.”¹²*

Operacione informimi është një term i përdorur nga Departamenti i Mbrojtjes i SHBA-ve i cili përfshin operacionet psikologjike, operacionet me rrjetet kompjuterike, luftën elektronike, sigurinë operationale dhe mashtrimin ushtarak. Operacioni psikologjik, në disa raste, i ngjan diplomacisë publike: ai iu referohet *“...veprimtarive ushtarake që përdorin informacion dhe indikatorë të përzgjedhur për të ndikuar mbi qëndrimet dhe sjelljen e qeverive, organizatave, grupeve dhe individëve të huaj për të mbështetur objektivat ushtarake dhe të sigurisë kombëtare”¹³*.

Manipulimi, në disa raste, përdoret në të gjitha llojet e komunikimit strategjik dhe *“është një strategji e koordinuar për të minimizuar efektin e informacionit negativ dhe për të paraqitur në dritë favorizuese një histori që sjell dëme”¹⁴*. Rregulla të ndryshme zbatohen për përdorimin e manipulimit në diplomacinë publike dhe operacionet psikologjike, sepse diplomacia publike operon brenda kornizash kohore më afatgjata dhe, duke qenë kështu, ka nevojë të ndërtojë kredibilitet.

Është i njohur fakti që manipulimi realizohet nëpërmjet *propagandës*. Rregullat e mësipërme zbatohen për përdorimin e strategjive respektive në përdorimin e propagandës. Propaganda mund të përkufizohet si: *“përpyetje sistematike e qëllimshme për të formuar perceptime, manipuluar shkallën e njohjes dhe për të orientuar sjelljen, me qëllim që të arrihet një reagim i cili ndihmon synimin e dëshiruar të propagandistit.”*¹⁵

Studiuesit e njohur në fushën e propagandës Xhouvet dhe O’ Donëll (Jowett dhe O’Donnell) e ndajnë konceptin e propagandës në nënkategori: propagandë e bardhë, propagandë gri dhe propagandë e zezë. *Propaganda e bardhë* zakonisht komunikon informacion të saktë dhe burimi përcaktohet me korrektësi. Ajo përpiqet të *“ndërtojë kredibilitet në audiencë sepse ky kredibilitet mund të përdoret në momente të caktuara në të ardhmen”*. *Propaganda e zezë* përhap gënjeshtër, fabrikime dhe mashtrime dhe i vishet një burimi të rremë. *Propaganda gri* qëndron diku midis propagandës së bardhë dhe propagandës së zezë. *“Burimi mund ose mund të mos identifikohet me korrektësi dhe saktësia e informacionit është e pasigurtë”*.

*“Në disa raste argumentohet se diplomacia publike mund të jetë propagandë e bardhë dhe gri, por kurrë propagandë e zezë”*¹⁶. Megjithatë kjo varet nga përkufizimi i diplomacisë publike dhe qëllimi i saj. Propaganda e zezë njihet si propagandë minuese, kur bëhet fjalë për terma kohorë më të gjatë, por shoqëritë e ndjeshme ndaj propagandës ka raste që reagojnë negativisht edhe ndaj propagandës së bardhë dhe gri. Lidhja me propagandën konsiderohet si një problem për diplomacinë publike në përgjithësi, për arsye të konotacionit që lidhet me kontrollin mbi mendjen, mashtrimin dhe imperializmin kulturor.

Komunikimi strategjik, çështjet me publikun, operacionet për informimin, operacionet psikologjike, manipulimi dhe propaganda përbëjnë pjesën e jashtme, sipas së cilës shpesh përkufizohet diplomacia publike, por në literaturën akademike bashkëkohore komunikimi strategjik trajtohet si termi ombrellë për konceptin e diplomacisë publike, operacioneve të informimit (përfshirë këtu edhe operacionet psikologjike), çështjeve publike dhe propagandën. Të gjitha këto së bashku si element përbëjnë korpusin e atij që quhet “pushtet i butë”.

5. Rëndësia e njohjes dhe zbatimit të komunikimit strategjik

Direktiva e Komandës së Aleatëve për Operacionet (KAO), shtator 2008, mbi komunikimin strategjik të NATO-s thekson se: a) *“KAO-ja po operon në një epokë ku roli global i informacionit dhe mediave është mjaft i rëndësishëm për të qenë të suksesshëm. Aleanca duhet të justifikojë veten ndaj anëtarëve dhe partnerëve të vet në kushtet kur është më shumë se kurrë nën presion operacional. b) Mjedisi global i informacionit ka paralajmëruar ndryshime të paprecedenta, përfshirë edhe ofrimin e mundësive për kundërshtarët tanë dhe institucionet tradicionale do të luftojnë t’i menaxhojnë këto sfida të reja vetëm nëse kanë guximin të reformojnë strukturat e tyre, mënyrën e të menduarit dhe metodën e punës. Kaq e madhe është rëndësia e informacionit në suksesin e misionit saqë, në disa raste madje, edhe politikat dhe veprimet do të kenë nevojë të përshtaten për t’iu përgjigjur nevojave të ngutshme të komunikimit strategjik.”*¹⁷

Duke iu referuar sfidave me të cilat përballet sot NATO, direktiva e KAO-s nënvizon se: *“Të gjitha sfidat themelore me të cilat përballet NATO kanë një komponent mjaft të rëndësishëm informacioni, qoftë ai i përballet me përdorimin e informacionit në fushatat asimetrike nga oponentët tanë, qoftë puna për ruajtjen e mbështetjes nga ana e publikut dhe opinionbërësit tanë, duke u siguruar se ata kuptojnë plotësisht se çfarë po bëhet në emër të tyre.”*

Në këtë dokument të rëndësishëm nxirret në pah roli i komunikimit strategjik në veprimtarinë e Aleancës, duke u shprehur në mënyrë të qartë se: *“Komunikimi strategjik ka një rol qendror qoftë për të ndihmuar operacionet, qoftë në menaxhimin e perceptimeve të publikut dhe qëndron në thelb të drejtimit dhe menaxhimit të reagimeve tona ndaj sfidave të epokës së informacionit.”*

Këto kërkesa mjaft të rëndësishme lipset të studiohen, zërthehen dhe kuptohen mirë nga çdo ushtarak, sidomos nga nivelet e ndryshme të komandimit dhe nga forcat që përgatiten e dërgohen në misione në kuadrin e Aleancës. Kjo është e domosdoshme për dy arsye kryesore: së pari, për të garantimin e suksesit të Aleancës në atë zonë përgjegjësie që mbulojnë dhe së dyti, për një përfaqësim sa më dinjitoz të vendit tonë në audiencën e vendit ku operojnë. Për këtë arsye do të sugjerohet disa hapa që mendojmë se do të jenë të dobishme:

1. Të rishikohen programet e të gjitha niveleve të kurseve në Akademinë e Mbrojtjes “Spiro Moisiu” për të përfshirë më shumë njohuri teorike dhe praktike për komunikimin strategjik;
2. Puna studimore e Akademisë së Mbrojtjes të bëjë më shumë objekt të saj çështjet e komunikimit strategjik në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë;
3. Të organizohen seminare apo simpoziume me objekt komunikimin strategjik ku të ftohen lektorë vendas dhe të huaj;
4. Në kurset OMLT të trajtohen çështje teorike dhe praktike të komunikimit strategjik të nivelit operacional dhe taktik;
5. Në të ardhmen, të nxiten më shumë artikuj e botime rreth komunikimit strategjik në shtypin ushtarak.

Pavarësisht se jemi një ndër anëtarët më të vegjël dhe më të rinj në gjirin e Aleancës, trupat tona po luajnë një rol të rëndësishëm në misionet e ndryshme që NATO ka ndërmarrë dhe po kryen me sukses. Kjo kërkon që qoftë në nivel strategjik, operacional apo taktik, ushtarakët tanë kanë nevojë të kenë më shumë njohuri teorike dhe praktike mbi komunikimin strategjik me qëllim që të harmonizohen më mirë me aleatët me të cilët operojnë në misionet e Aleancës. *“Një çështje me mjaft rëndësi është ajo që lidhet me nevojën për të harmonizuar sa më shumë të jetë e mundur, temat dhe mesazhet me të gjitha vendet anëtare dhe partnerët për të njëjtat operacione.”*¹⁸

6. Përfundime

Komunikimi strategjik është një koncept teorik i trajtuar relativisht vonë në shkencën e komunikimit. Ai është pjesë shumë e rëndësishme e “pushtetit të butë” i cili, në kohët moderne, i kombinuar me element të “pushtetit të fortë”, po quhet “pushteti i zgjuar”. Sot ai është kthyer në termin ‘ombrellë’ për diplomacinë publike, propagandën, operacionet e informimit (përfshirë këtu edhe operacionet psikologjike), operacionet mediatike dhe çështjet publike. Pavarësisht se është një koncept teorik relativisht i ri, praktika të komunikimit strategjik i gjejmë qysh në fillimet e shoqërive para moderne.

Sot, në kuadrin e strategjive dhe taktikave për të përballuar rreziqet asimetrike, komunikimi strategjik po merr gjithnjë e më tepër përparësi sepse, sot, çdo lëvizje ushtarake dhe jo vetëm, mbart në vetvete një element informacioni. Komunikimi strategjik merr rëndësi të veçantë në kuadrin e “pushtetit të butë” në luftën “për të fituar mendjet dhe zemrat”.

Nëse ai njihet si koncept relativisht i ri në literaturën akademike botërore mbi komunikimin, tek ne ai ka hyrë vetëm në këto pesë-gjashtë vitet e fundit. Kjo do të thotë se është studiuar pak, njihet pak dhe nga një rreth i ngushtë studiuesish. Këtë rrjedh nevoja që strukturat ushtarake, sidomos nivelet e komandimit, forcat që dërgohen me misione jashtë vendit në kuadrin e NATO-s duhet të kenë të qartë jo vetëm teorikisht se çfarë është komunikimi strategjik, por duhet të orientohen se si të përdorin në praktikë parimet dhe praktikat e këtij komunikimi. Për rrjedhojë, gjithë piramida e arsimimit dhe trajnimit duhet të përfshijë në programet e veta sipas niveleve, njohuri teorike dhe praktike mbi komunikimin strategjik.

Bibliografia:

- ACO Directive Number 95-2, “ACO Strategic Communications”, Supreme Headquarters Allied Powers Europe, B-7010, SHAPE, Belgium, September 2008.
- CACI International and the U.S. Naval Institute (USNI), “Dealing with Today’s Asymmetric Threat to U.S. and Global Security: Employing Smart Power”, CACI International Inc., March 2009.
- Defense Science Board. 2004. *Report of the Defense Science Board Task Force on Strategic Communication*. US Department of Defense, Office of the Under Secretary of Defense For Acquisition, Technology, and Logistics. Washington, D.C.
- Hastings, T. R., Principal Deputy Assistant Secretary of Defense for Public Affairs, Department of Defense “Principles of Strategic Communication”, 15 August, 2008.
- Jansen, S. C. 2005. Foreign Policy, Public Diplomacy, and Public Relations: Selling America to the World. Artz, L. & Kamalipour, Y.R. (eds) *Bring ‘Em On: Media and Politics in the Iraq War*, 51-65. Rowman & Littlefields Publishers, Inc., Lanham, MA.
- Joster, J. R, “Strategic Communication: Key Enabler for Elements of National Power”, Joint Information Operations Centre, summer 2006.
- Jowett, G. & O’Donnell, V. 1999. *Propaganda and Persuasion*. 3rd ed. Sage, London.
- Kapusta, S, “Why Communication Matters”, www.occ.pitt.edu
- Mihăilă, V., “NATO’s Strategic Communication in Combating Terrorism”, University of Bucharest, Panduri 90 Str., Bucharest, ftp.rta.nato.int/public
- Moore, S, “The Origins of Strategic Communication: Precedents and Parallels in Ancient States”, *Atlantic Journal of Communication*, 18, 2010.
- Murphy, M. D, “Strategic Communication: Wielding the information element of power”, *The U.S Army College Guide to National Security Issues*, Vol. 1, “Theory of War and Strategy”, 2011.
- Obama, B., “National Framework for Strategic Communication”, Report on my Administration’s comprehensive interagency strategy for public diplomacy and strategic communication of the Federal Government, 2009.
- Romarheim, A. 2005. *Crossfire of Fear: Propaganda in the US War on Terrorism*. Master’s thesis. Department of Political Science, University of Oslo.
- Sletland, A. “The Geopolitics of ‘Hearts and Minds’: American Public Democracy in the War on Terrorism”, Norwegian Institute of International Affairs, Besøksadresse: C.J. Hambrosplass 2d, Postboks 8159 Dep. 0033 Oslo, 2008.

Referenca

- ¹ Joster, J. R., “Strategic Communication: Key Enabler for Elements of National Power”, Joint Information Operations Center, summer 2006, p.16.
- ² Obama, B, “National Framework for Strategic Communication”, Report on my Administration’s comprehensive interagency strategy for public diplomacy and strategic communication of the Federal Government, 2009, p. 2.
- ³ CACI International and the U.S. Naval Institute (USNI), “Dealing with Today’s Asymmetric Threat to U.S. and Global Security: Employing Smart Power”, CACI International Inc, March 2009.
- ⁴ Moore, S, “The Origins of Strategic Communication: Precedents and Parallels in Ancient States”, *Atlantic Journal of Communication*, 18, 2010, p. 228.
- ⁵ Kapusta, S, “Why Communication Matters”, www.occ.pitt.edu

⁶ Winfield Scott (13 Qershor 1786-29 Maj 1866)-një gjeneral i Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara dhe kandidat për president i Partisë Whig në vitin 1852. Thirrej ndryshe si “babai i ushtrisë”. Shërbeu në shërbimin aktiv të Ushtrisë Amerikane më gjatë se çdokush tjetër në historinë amerikane dhe shumë historianë e konsiderojnë atë komandantin amerikan më të zotin për kohën e tij. Gjatë karrierës së tij 47 vjeçare ai komandoi forcat amerikane në Luftën e 1812, Luftën Meksikano-Amerikane, Luftën ‘Skifteri i Zi’, Luftën e Seminolës së Dytë dhe për një periudhë të shkurtër në Luftën Civile Amerikane. Pas Luftës Meksikano-Amerikane u shpall hero kombëtar dhe shërbeu si guvernator ushtarak në qytetin e Meksikos.

⁷ Murphy, M. D., “Strategic Communication: Wielding the information element of power”, The U.S Army College Guide to National Security Issues, Vol. 1, “Theory of War and Strategy”, 2011, p.158.

⁸ Murphy, M. D., “Strategic Communication: Wielding the information element of power”, The U.S Army College Guide to National Security Issues, Vol. 1, “Theory of War and Strategy”, 2011, p.159.

⁹ Hastings, T. R, Principal Deputy Assistant Secretary of Defense for Public Affairs, Department of Defense “Principles of Strategic Communication”, 15 August, 2008.

¹⁰ Defense Science Board. 2004. *Report of the Defense Science Board Task Force on Strategic Communication*. US Department of Defense, Office of the Under Secretary of Defense For Acquisition, Technology, and Logistics. Washington, D.C.

¹¹ Jansen, S. C. 2005. Foreign Policy, Public Diplomacy, and Public Relations: Selling America to the World. Artz, L. & Kamalipour, Y.R. (eds) *Bring ‘Em On: Media and Politics in the Iraq War*, 51-65. Rowman & Littlefields Publishers, Inc., Lanham, MA.

¹² Sletland, A. “The Geopolitics of ‘Hearts and Minds’: American Public Democracy in the War on Terrorism”, Norwegian Institute of International Affairs, Besøksadresse: C.J. Hambrosplass 2d, Postboks 8159 Dep. 0033 Oslo, 2008

¹³ Defense Science Board. 2004. *Report of the Defense Science Board Task Force on Strategic Communication*. US Department of Defense, Office of the Under Secretary of Defense For Acquisition, Technology, and Logistics. Washington, D.C.

¹⁴ Jowett, G. & O’Donnell, V. 1999. Propaganda and Persuasion. 3rd ed. Sage, London, p.3.

¹⁵ Jowett, G. & O’Donnell, V. 1999. Propaganda and Persuasion. 3rd ed. Sage, London, p.6.

¹⁶ Romarheim, A. 2005. *Crossfire of Fear: Propaganda in the US War on Terrorism*. Master’s thesis. Department of Political Science, University of Oslo.

¹⁷ ACO Directive Number 95-2, “ACO Strategic Communications”, Supreme Headquarters Allied Powers Europe, B-7010, SHAPE, Belgium, September 2008.

¹⁸ Mihăilă, V., “NATO’s Strategic Communication in Combating Terrorism”, University of Bucharest, Panduri 90 Str., Bucharest, <ftp.rta.nato.int/public>

RUBRIKA E TRETË

ANALIZA, SINTEZA DHE VLERËSIME TË SIGURISË

Kjo rubrikë e tretë është bërë tashmë një rubrikë e përhershme e Revistës Ushtarake dhe ka zakonisht prurjet më të mëdha në shkrime. Ne vlerësojmë dhe falënderojmë të gjithë autorët që sjellin analiza dhe studime të tyre për botim në Revistën Ushtarake dhe njëkohësisht iu kërkojmë ndjesë nëse nuk është e mundur që shkrimet e tyre të pasqyrohen menjëherë. Revista do të pasqyrojë shkrimet e ardhura në numrat e ardhshëm të saj.

Autorët e shkrimeve të kësaj rubrike japin mendimet e tyre të bazuara në studime dhe ekspertiza për çështje specifike në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, që kanë të bëjnë me doktrinën ushtarake, lidershipin, emigracionin, etj. të sjella këto në mjedisin e ndryshuar të sigurisë dhe mbrojtjes.

Me synimin që të kultivojë zhvillimin e analizave, parashikimeve dhe vlerësimeve strategjike, kjo rubrikë do të vazhdojë të mbetet një nga rubrikat kryesore të Revistës, duke mirëpritur punimet kërkimore nga autorë dhe ekspertë, brenda dhe jashtë Forcave të Armatosura.

Bordi i Revistës gjen rastin të ftojë dhe njëherë studentët e Programit Master si dhe doktorantët e ardhshëm të sjellin analiza dhe studime të tyre, të bazuara në ekspertiza të mirëfillta si dhe në përvojën e tyre profesionale, me rekomandime konkrete në të mirë të zhvillimit të Forcave tona të Armatosura dhe të shoqërisë shqiptare.

Zhvillimi i doktrinës ushtarake në mjedisin e ndryshuar të sigurisë e të mbrojtjes

Kolonel Ahmet Leka,
Shef i Qendrës së Doktrinës dhe Manualeve

Abstrakt. *Zhvillimi i Doktrinës së Përbashkët të Forcave të Armatosura të RSH bëhet duke u bazuar në konceptet e Strategjisë Ushtarake dhe në veprimtarinë e FA gjatë përgatitjes e zhvillimit të operacioneve. Koncepti strategjik ushtarak përbën bazën e Doktrinës së Përbashkët. Doktrina e Përbashkët e Forcave të Armatosura duhet të jetë një dokument i standartizuar për përdorim brenda këtyre forcave dhe, mbi bazën e tij dhe të nevojës strukturore për dokumente doktrinarë, është e nevojshme hartimi dhe miratimi i tërë hierarkisë doktrinare.*

Rreziqet e kërcënimit e reja për sigurinë dhe mbrojtjen dhe ndryshimi i formave të konfliktit si: karakteri, përmasat dhe efektet e tyre, kërcënimet dhe rreziqet me natyrë jo konvencionale, apo terrorizmi, siguria energjetike, kërcënimi kibernetik dhe ndryshimet klimaterike, sfidat dhe kërcënimet hibride, përhapja në rritje e luftës asimetrike, krahas me armët e taktikat konvencionale e jokonvencionale në fushëbetejë, kërkojnë gjithnjë e më shumë një angazhim në rritje të Forcave tona të Armatosura dhe një trajtim gjithëpërfshirës ndaj operacioneve për përballimin e kërcënimeve e rreziqeve të reja si dhe reflektim e ndikim në përmirësimin e doktrinës ushtarake.

Zhvillimi i doktrinës në përgjigje të sfidave e kërcënimeve të reja për sigurinë e mbrojtjen

Mjedisi strategjik në ndryshim ka sjellë një dinamikë të re të operacioneve të sotme dhe të ardhshme, një fushë më të gjerë, nga operacionet klasike luftarake deri tek ato paqeruajtëse e humanitare. Nëse hedhim një vështrim në dekadën e fundit shohim se ka pasur ndryshime gjeostrategjike që janë të lidhura me arritjet teknologjike dhe një zbatim konceptualisht të ri të forcës ushtarake. Aktualisht, ndryshimet e mjedisit të sigurisë dhe ndryshimi në doktrinën dhe teknologjinë që shkon së bashku me të, kërkojnë përshtatjen e mekanizmave të kontrollit të armëve për kushtet e sotme.

Aftësitë ushtarake që kërkohen sot për misione të tilla janë komplekse dhe duhet të pasqyrohen në doktrinë, sepse Forcat e Armatosura janë dhe mbeten një mjet efektiv i politikës së sigurisë. Të vogla, mobile, me njësi të specializuara, me rreze të gjatë veprimi, me kapacitete të transportit ajror, këto janë vetëm disa elemente që tashmë tregojnë se duhet bërë një dallim midis cilësisë dhe sasisë ushtarake, në përgjigje të sloganit të ditëve të sotme: “ më shumë cilësi, më pak sasi!” Kjo do të thotë se aftësitë duhet të përshtaten për një fushë më të gjerë dhe më të dendur për një sërë operacionesh.

Në Lisbonë, NATO dha një sinjal të qartë në këtë drejtim, duke vendosur administrimin ndërkombëtar të krizave dhe bashkëpunimin në fushën e sigurisë, së bashku me një angazhim kolektiv të mbrojtjes, si aktivitetin kryesor të saj¹. Ky qëndrim do të forcohet edhe nga krijimi i një aftësie të qëndrueshme civilo-ushtarake.

Mundësia e lartë e kërcënimeve asimetrike dhe e përdorimit të taktikave asimetrike në sferën ushtarake kërkon masat e duhura për t’iu përgjigjur këtyre kërcënimeve. Për më tepër, këto hapa duhet të merren, jo vetëm në nivel kombëtar por edhe në nivel të bashkëpunimit ndër-

shtetëror, duke përfshirë dhe sferën ushtarake. Vetëm në këtë mënyrë mund të flasim për krijimin e parakushteve për kundërvënien efektive ndaj kërcënimeve dhe sfidave të sotme.

Në përgjigje të ndryshimit të kushteve në mjedisin strategjik politiko-ushtarak, në zbatim të direktivave të reja politike të Aleancës, të mësimave praktike të nxjerra ose të futjes së teknologjive të reja duhet të përpilohen edhe politika të reja. Këto politika janë kryesisht të natyrës orientuese. Midis faktorëve të tjerë, doktrina evoluon kryesisht në përgjigje të ndryshimit të politikave, të kapaciteteve moderne luftarake dhe të rregullave të përdorimit të forcës ushtarake. Në këtë mënyrë, është pranuar dhe rënë dakord, prej secilit vend anëtar, që politikat e aleancës do të luajnë një rol drejtues dhe orientues në zhvillimin e doktrinaeve.

Parashikimi që jep Doktrina AJP-1(D) bazohet në një mjedis strategjik në ndryshim si dhe në një mjedis operacional kompleks. Planet e tashme dhe të ardhshme ushtarake do të ndikohen ndjeshëm nga pjesëmarrja e aktorëve të rinj jo ushtarakë, shtetërorë e jo shtetërorë dhe shumëkombësh, që kanë synime të njëjta me forcat ushtarake, por që përdorin mjete dhe kapacitete të ndryshme. E veçanta e kësaj doktrine, nga doktrina e kaluar, është vetë rëndësia themelore që i vihet “*trajtimin gjithëpërfshirës*” të operacioneve të sotme dhe të ardhshme².

Kjo do të thotë që FA mund të përdoren për të ushtruar presion ushtarak ose të kryejnë veprime ndaj kërcënimeve ushtarake që tashmë kanë ndryshuar. Krahas mjeteve e taktikave tradicionale ushtarake, do të përdorin edhe të ashtuquajturat taktika asimetrike, duke përfshirë edhe komunikimin global, objekte dhe teknologji të rrjetit të informacionit, për të zgjidhur problemet politiko-ushtarake.

Në konceptin doktrinor gjerman, në kuadrin politik, doktrina konsiderohet si një udhëzues i qeverisë.³ Doktrina ushtarake pasqyron të gjithë dinamikën dhe komple-ksitetin e operacioneve të tashme e të ardhshme të NATO-s dhe të vendeve aleate. Ajo jep lidhjen politiko-ushtarake të luftës dhe të operacioneve dhe vlerëson evoluimin e natyrës së luftërave, në shekullin e ri. Doktrina thekson se Forcat e Armatosura duhet të përgatiten që, krahas operacioneve tradicionale, të zhvillojnë gjithmonë e më shumë edhe operacione jo tradicionale në gjithë fushën e veprimit të misioneve.

Misioni kryesor i Forcave të Armatosura është siguri i një gatishmërie të lartë të tyre për të neutralizuar rreziqet ekzistuese dhe të ardhshme me karakter ushtarak për sigurinë të vendit. Detyra kryesore, në kohë paqeje, është që të ruajnë potencialin e tyre ushtarak dhe gatishmërinë luftarake, në një nivel të lartë për të siguruar lokalizimin dhe parandalimin e konflikteve me intensitet të ulët ushtarak dhe çdo veprim të armatosur që është i paligjshëm në kufirin shtetëror ose brenda kufijve territorialë të vendit.

Në parashikimin e skenarëve për zhvillimin e situatës politiko-ushtarake, në pjesë të ndryshme të botës, është thelbësore që të vlerësohen faktorë të tillë: si konkurrenca për burime energjetike, rritja e terrorizmit, rritja e separatizmit dhe luftës etnike, ekstremizmi nacional ose fetar dhe përhapja e teknologjive për prodhimin e armëve “cutting-edge”, duke përfshirë edhe armët e kompjuterizuara dhe armët e shkatërrimit në masë, që kanë një ndikim vendimtar në atë se, si do evoluojnë situatat dhe si do të jetë vazhdimësia në të ardhmen. FA mbeten një mjet efektiv dhe i fuqishëm për bllokimin kërcënimeve dhe sfidave të tilla si terrorizmi ndërkombëtar, trafiku i drogës, krimi i organizuar, pirateria, migrimi i pakontrolluar, etj. Doktrina Ushtarake është dokumenti bazë i përdorimit dhe mbështetjes së forcave në kryerjen e një operacioni, çfarëdolloj emri që mund të ketë.

Doktrina përkufizon “*parimet themelore. nëpërmjet të cilave forcat ushtarake drejtojnë veprimet e tyre për arritjen e objektivave të përcaktuara. Ajo është autoritare, por kërkon gjykim në zbatimin e saj*”. Qëllimi themelor i doktrinës është të garantojë që Forcat e

Armatosura të Aleancës të kenë një kuadër drejtues për zhvillimin e operacioneve të tyre. Ajo trajton mënyrat se si këto operacione duhet të organizohen, drejtohen, komandohen, koordinohen, mbështeten dhe si do të vijohet pas mbarimit të tyre. Ajo, përveç se mbart përvojën më të mirë të operacioneve të kaluara, pasqyron edhe mendimin bashkëkohor për zbatimin e këtyre parimeve në realitetin aktual dhe në perspektivën e afërt. Duke pasur tipare dinamike, doktrina rishikohet në vijimësi për të pasqyruar sa më mirë aktualitetin e mendimit doktrinar. Ajo përshkruan mënyrën se si vepronjë Forcat e Armatosura të Aleancës, por nuk trajton se përse ato e bëjnë një gjë të tillë, pasi ajo është një detyrë e politikës.

Zhvillimet teknologjike dhe doktrina

Ndryshimet themelore, në zhvillimet teknike të dy dekadave të fundit, çuan në përshtatjen e doktrinës ushtarake. Sot, përdorimi i Forcave të Armatosura nuk ka më si karakteristikë përballjen me një armik të njohur, apo linjat e ngurta të konfliktit dhe të standartizuara me procedura. Në fakt, është e nevojshme që së pari, të njësohen dhe të përshkruhen forcat e armikut, të vendosen së bashku potencialet aleancës dhe pastaj të arrihet përdorimi i Forcave të Armatosura shumëkombëshe, në mënyrë vrullshme e të koordinuar, për realizimin e operacioneve.

Ndryshimi teknologjik, i cili vazhdimisht revolucionarizon teknologjinë e informacionit, në veçanti, siguron një influencë të konsiderueshme për veprimin sikurse parashikohet edhe nga doktrina. Një veprim i tillë, në rrjet kryesisht, e bën përdorimin e hapësirës virtuale të informacionit, në të cilin të gjithë aktorët dëshirohen të bashkëpunimit marrin pjesë, të rëndësishëm. Përdorimi i hapësirës virtuale të informacionit tonë të çon në epërsi komandimi dhe luftimi.

Krijimi i mjeteve më të përparuara të luftës së armatosur, bazuar në teknologjinë “cutting-edge”, në mënyrë të paevitueshme çon në një kthim ose në një ndryshim në natyrën e konfliktit të armatosur, dhe në format, dhe në metodat e njohura të tij⁴.

Kërcënimet asimetrike për sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare, tashmë, janë duke u bërë më të shpeshta.

Në sferën ushtarake, ato janë shfaqur në një përdorim më të gjerë të formave të tërthorta të metodave të luftës siç janë: lufta e informacionit, dezinformimi i opinionit publik si në vende të veçanta dhe të komunitetit ndërkombëtar në tërësi, kundërshtimi i sistemeve qeverisëse dhe pjesëmarrja në konflikte të ushtrive të parregullta.

“Lufta në Network” ka filluar të shfaqet si rezultat i shfaqjes së kërcënimeve asimetrike në botën e sotme. Karakteristikat e saj kryesore janë: mungesa e një linje dhe kufijve të qartë në mes të palëve kundërshtarë, me objektiv transformimin e ndërgje-gjësimit të publikut ku informacioni dhe dimensionet psikologjike iu është shtuar traditave të mëparshme.

Domosdoshmëri, sot, është një trajtim gjithëpërfshirës në sigurimin e përdorimit të një “rrjeti të sigurt”, mbi bazën e udhëzimeve të qarta doktrinare, në mënyrë që të sigurohet efikasiteti i veprimit në këto situata komplekse të kërcënimeve⁵. Në këtë drejtim, Forcat e Armatosura, në sajë të aftësive dhe pajisjes së tyre, përbëjnë një instrument thelbësor të shtetit; ato do të ndërveprojnë, së bashku me instrumente të tjera të politikës, të ekonomisë, qofshin qeveritare e jo qeveritare. Në këtë mënyrë, veprimet tona ushtarake dhe efektet e veprimit do të jenë të koordinuara me veprimet e aktorëve jo ushtarakë, duke siguruar një efektshmëri të lartë, nëpërmjet një shkëmbimi të plotë të informacionit midis ushtrisë dhe të gjitha fushave të tjera, duke mundësuar dhe krijimin e një rrjeti centrik të operacioneve.

Sot, ne po shohim zbatimin e suksesshëm të koncepteve të “luftës në rrjet” kundër vendeve të veçanta dhe në zgjidhjen e shumë çështjeve politike. Kjo përbën një mjet efektiv për terrorizmin ndërkombëtar dhe krimin ndërkufitar. Strukturat terroriste e aplikojnë këtë, në mënyrë efektive, në pjesë të ndryshme të botës, duke e përdorur jo vetëm për mbështetjen morale, por edhe për garantimin dhe mbështetjen financiare.

Po trajtojmë edhe një faktor tjetër. E thënë thjeshtë, do të flasim për përpjekjet ndërkombëtare për të ndaluar përdorimin e armëve dhe teknologjive të caktuara dhe për të reduktuar në minimum viktimat civile (dhe madje edhe viktimat ushtarake) të cilat sot kanë një ndikim në rritje. Sot mund të flasim për një armatim me precizion të saktë. Ai u “shpik” për kërkesat dhe nevojat ushtarake: rritjen e efikasitetit të sulmit, duke lejuar një numër të vogël të efektivave për t’u angazhuar në një numër të madh të objektivave, me një sasi të vogël armatimi, në të gjitha kushtet e motit. Por, në ditët e sotme, për arsye politike, armët e sakta janë duke u bërë pothuajse të detyrueshme edhe kur nuk ka kuptim nga ana ushtarake përdorimi i tyre në vend të armëve konvencionale. Ne mund ta shohim këtë ndodhi, kohët e fundit, edhe në Libi. Dhe për të njëjtat arsye, armët gjithnjë e më të vogla e më të sakta janë të nevojshme. Mendoni sulmet ajrore në Afganistan e Pakistan.

Natyrisht, ky evolucion është i mirëpritur nga ana e industrisë së mbrojtjes, pasi armët e sakta janë më të shtrenjta se ato konvencionale, ndërsa paraqesin një “alternativë të pranueshme ligjërish” për armatimin, ndërkohë që ato janë shumë më të përparura dhe të kushtueshme edhe sesa armët e ndaluara. Kjo është një pikë e rëndësishme ... nëse kërkesat ushtarake për përdorimin e armëve të ndaluara do të mënjanohej. Kërkesa për to do të plotësohet duke përdorur teknologji dhe sisteme të ndryshme⁶.

“Cyberwarfare” është pak më ndryshe, pasi në fakt është një lloj i ri i luftës e cila nuk ka të bëjë fare me korrektësinë politike dhe që nuk është domosdoshmërisht armë “vdekjeprurëse”, nëse e mendojmë të tillë. Në të vërtetë, shpresat për të kufizuar “cyberwarfare” janë bërë më të pakta dhe kjo po bëhet edhe më e vështirë, sepse ajo mund të zhvillohet si në paqe, si në kohë lufte dhe, jo domosdoshmërisht, nga organizata në një territor të caktuar. Çfarë ndodhi në fushën e internetit shumë të kufizuar me këtë çështje? Wikileaks na jep shumë mësim për të ardhmen.

Lufta në IT, duke përfshirë atë kibernetike është shumë më e lirë se sa një luftë konvencionale. Ne kemi folur vetëm për armët me objekt “jo vdekjeprurës”, ose më pak se “vdekjeprurës”. Por, ato ende mund të konsiderohen armë. Nëse mund të përmendim fjalët mburojë (duke përfshirë edhe atë anti-raketë) ose një “përkrenare”, ato janë ... armë, megjithëse një armë jo vdekjeprurëse. Por një armë jo vdekjeprurëse mund të bëhet vdekjeprurëse, në varësi se si përdoret dhe kundër kujt përdoret.

Nuk mund të ketë asgjë më pak të shenjtë sesa fitorja e një lufte pa të vrarë. Por të menduarit se do ketë një luftë pa viktima nuk mund të jetë ëndërr. Gjithashtu, e ardhmja teknologjike do të sjellë një diferencim të dukshëm ndërmjet vendeve të zhvilluar dhe të varfra. Ne pajtohemi se përparimet teknologjike, me të vërtetë, po ndryshojnë operacionet ushtarake, me mënyrën si do të zhvillohen si dhe me mënyrën se si Forcat e Armatosura do të organizohen (shërbimet tradicionale do të veprojnë gjithnjë e më shumë në forma të tjera). Kjo, përfundimisht, është tregues bazë se ***përparimet teknologjike diktojnë ndryshime të mëdha në doktrinat ushtarake dhe në mënyrën e trajnimit dhe përgatitjes së personelit për një detyrë e cila duhet të ndryshojë***⁷.

Ne do të shohim gjithnjë e më shpesh se si makinat do të zëvendësojnë njerëzit në fushëbetejë. Tashmë kjo po ndodh në ajër, ku UAVs (Unmanned Air Vehicle), me krahë fikse

dhe rrotullues numërohen me mijëra, ndërsa UCAVs (Unmanned Combat Air Vehicle) janë gjithashtu një realitet dhe sisteme të reja të aeroplanëve pa pilot janë konceptuar si zhvillime të reja. Kjo nuk do të thotë se pilotët i kanë ditët e numëruara, por “piloti”, në të ardhmen, do të vendoset në mënyrë rutine para një tastiere në terren, në vend që të jetë në një kabinë avioni. Hapësira tashmë është një domen i “makinës”.

Automatizimi i detit ka pakësuar ndjeshëm ekuipazhet e anijeve dhe USVs (Unmanned Surface Vehicle) (mjetet pa pilot të sipërfaqes), tashmë, janë duke u vendosur. Në të ardhmen do ta trajtojmë më shumë këtë realitet. Dimensioni UUV nënujor (Unmanned Underwater Vehicle) është duke u bërë një fenomen i zakonshëm dhe ai do të marrë role dhe misione të reja si një teknologji që evoluon pandërprerë. Po kështu, kemi UGVs (Unmanned Ground Vehicle), të cilat kanë filluar të dalin në fushëbeteja, por ne jemi shumë larg për të parë një këmbësori robotike. Ajo që është në vend të parë është përpjekja për të përmirësuar efikasitetin fizik të ushtarit efektiv.

Ne duhet të kuptojmë që makinat janë aq të zgjuara aq sa ne i ndërtojmë ato. Dhe në fund të fundit, kjo është pozitive. Sepse kur do të ketë vetëm makina për të luftuar në luftë, atëherë ne do të shohim më shumë konflikte se luftërat e shpërthyera deri tani në botë. Për arsye se qeveritë do të jenë të shqetësuara vetëm për kostot financiare të një lufte dhe jo për kufizimet të cilat i bashkëngjiten vendimit për dërgimin njerëzve (qytetarëve që votojnë) në vijën e zjarrit.

Integrimi në NATO dhe zhvillimi i doktrinës

Në kushtet e ndryshuara të mjedisit të sigurisë, mendojmë që vëmendja jonë të përqendrohet në dy aspekte: së pari, në faktin që tashmë jemi vend anëtar i NATO-s dhe çdo zhvillim i Forcave tona të Armatosura, pra edhe zhvillimi i doktrinës, nuk mund të konceptohet dhe nuk mund të ndërmerret jashtë këtij konteksti; së dyti, tek sfidat dhe kërcënimet ndaj sigurisë e mbrojtjes së vendit tonë dhe të Aleancës ku bëjmë pjesë, tek pjesëmarrja e Forcave tona të Armatosura në operacione jashtë vendit, në përbashkëtimin e emergjencave civile, në operacione në ndihmë të popullsisë, etj. që kërkojnë një rikonceptim thelbësor të doktrinës.

Fakti që tashmë ne jemi anëtarë të NATO-s, nga këndvështrimi i zhvillimit të doktrinës, shtron para nesh disa detyrime dhe më konkretisht: vazhdimin e punës për ratifikimin dhe aplikimin e publikimeve doktrinale të Aleancës dhe, në të njëjtën kohë, hartimin e planeve të veprimit për njohjen e gjerë të tyre nëpërmjet tërë procesit arsimor e stërvitor të personelit të Forcave tona të Armatosura, pasi vetëm kështu do të jemi në gjendje që, në operacionet e përbashkëta shumëkombëshe ku marrim pjesë, të jemi të ndërveprueshëm dhe të efektshëm.

Duke qenë në kufirin kohor të rishikimit të Doktrinës së Përbashkët, para nesh shtrihet detyra që parimet dhe konceptet e doktrinës sonë kombëtare si dhe terminologjia e përdorur në të, të jenë në pajtim të plotë me konceptet dhe terminologjinë e doktrinës së NATO-s. Nëse, edhe për një farë kohe (për arsye ekonomike), nuk mund të arrijmë plotësisht ndërveprueshmërinë dhe pajtueshmërinë (interoperability & compatibility) me forcat e vendeve të tjera të NATO-s, të përpiqemi që ta arrijmë atë në fushën e koncepteve (atje ku është e mundur) dhe të terminologjisë.

Gjithashtu, duke qenë anëtar i Aleancës, na del si detyrë që të angazhohemi drejtpërdrejt në zhvillimin dhe përpunimin e botimeve doktrinale të NATO-s, si nëpërmjet pjesëmarrjes në grupet e punës që ngrihen për këtë qëllim nga Agjencia e Standartizimit të NATO-s, ashtu dhe nëpërmjet dhënies së mendimeve e të sugjerimeve për përmirësimin e tyre në procesin e hartimit e të diskutimit të këtyre dokumenteve të rëndësishme.

Natyra e luftës dhe konkurrencës së dhunshme të njeriut që është një bashkim i rrezikut, fatit dhe politikës, nuk ka ndryshuar gjatë shekujve. Por natyra e saj e bën atë të paparashikueshme dhe në mënyrë të pashmangshme edhe vazhdimisht në ndryshim. Mbrojtja evoluon si rezultat i sfidave të reja të sigurisë që kanë të bëjnë me të, sikurse edhe ajo e mjedisit të ardhshëm operativ e çon në një konflikt, nëse kjo ka gjasa të ndodhë.

Kjo është e ndërvarur gjithnjë e më shumë nga dinamika e mjedisit dhe e vetë njeriut: demografia, ndryshimet shoqërore dhe teknologjike të cilat do të ndikojnë, në mënyrë të padiskutueshme, në mënyrën si njerëzit jetojnë dhe bashkëveprojnë. Këto janë duke u bërë dominuese në dinamikën tradicionale të pushtetit global. Kjo sugjeron një balancë në ndryshim të pushtetit në nivel global e cila mund të ndikojë në zhvillimin e ngjarjeve dhe në arritjen e disa aleancave dhe partneriteteve në të ardhmen.

Gjithçka ne mendojmë për tendencat e ardhshme nuk mund t'i parashikojë me saktësi ngjarjet.

Përzjerjet e tendencave të hapësirës strategjike tashmë kanë ndryshuar në fushëbetë. Më tepër se një hapësirë sterile dhe e hapur për betejë, në të ardhmen, konflikti do të shihet në të gjitha mjediset: të gjithanshëm, të rrëmujshëm, të kondensuar, të bashkëlidhur apo dhe të kufizuar.

Një ngatërrim i dukshëm është që fusha tradicionale e konflikteve, me aktivitete të ndryshme, duke filluar nga operacionet e mëdha luftarake për të ruajtur paqen, tani është ndarë në shumë operacione, që ndodhin në të njëjtën kohë, ose njëri pas tjetrit. Gjithashtu, kompleksiteti dhe jo shkalla e tij është një nga veçoritë e konfliktit bashkëkohor në të ardhmen.

Doktrina e re për realizimin e operacioneve komplekse bashkëkohore të sigurisë dhe të stabilizimit duhet të pasqyrojë si natyrën ashtu edhe karakterin e ndryshuar të konfliktit, sot dhe në të ardhmen.

Realizimi i një konference të nivelit të lartë për zhvillimin e doktrinës sonë kombëtare, me pjesëmarrjen e komandantëve të Forcave, Drejtorive J1-J9 (SHPFA), Drejtorisë së Politikave të Mbrojtjes (Ministria e Mbrojtjes), Drejtorisë së Emergjencave Civile (Ministria e Brendshme), pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në operacion, pedagogë e përfaqësues të organizatave joqeveritare, do të ishte e domosdoshme të bëhej në kohën e duhur.

Në këtë kontekst, Qendra e Doktrinës dhe Manualeve po vlerëson dhe zhvillon një "out-line" për tematikën e kësaj Konference. Në këtë Konferencë, mendojmë se duhet të zënë vend temat për zhvillimin e doktrinës në lidhje me pjesëmarrjen tonë në operacione të përbashkëta shumëkombëshe jashtë vendit (ku tashmë kemi krijuar një përvojë të pasur e të vyer), me përbalimin e emergjencave civile dhe të sfidave e kërcënimeve të reja në fushën e sigurisë e të mbrojtjes (terrorizmi, lufta kibernetike, etj.) si dhe me konceptin e NATO-s për trajtimin gjithëpërfshirës ndaj operacioneve.

Disa doktrina bazohen në trajtimin e parimeve themelore dhe, si të tilla, kanë një natyrë të qëndrueshme në planin afatgjatë. Ky tipar i bën ato më pak të prekshme ndaj ndryshimeve afatshkurtra të politikave. Si pasojë, gjatë zhvillimit të politikave duhet të mbahet parasysh zhvillimi i doktrinave, në mënyrë që të jenë sa më të qëndrueshme ndaj kohës. Dhe së fundi, duhet të synohet që politikat dhe doktrinat të jenë sa më të harmonizuara dhe në mbështetje të njëra-tjetrës.

Bibliografia:

- AJP-1, Doktrina e Përbashkët e NATO-s.
- AAP-47, Metodologjia e zhvillimit të Doktrinës.
- AAP-6, Fjalori i Termave dhe Përkufizimeve të NATO-s.
- ListRead phoAir Vice-Marshal Paul Colley, Assistant Chief of the Defence Staff (Development, Concepts and Doctrine), United Kingdom, on “The Changing Character of Conflict and its Implications”.

Referenca

¹ Koncepti i ri strategjik i NATO-s, Lisbonë 2010.

² Doktrina e Përbashkët e Aleancës (AJP-1), 2010.

³ Lt./Gen. Markus Bentler, Commander, Response Force Operations Command, Germany, on “Doctrinal Change and Technological Change: Consequences for Arms Control, High Level Seminar on military Doctrine, Vienna, May 2011.

⁴ Maj. Gen. Pertti Salminen, “Finland’s Comprehensive and Military Defense doctrines responding to Emerging threats and new technologies”, High Level Seminar on military Doctrine, Vienna, May 2011.

⁵ Dr. Andrea Nativi, Military Expert, Italy on “New technologies, new requirements, new doctrines: how defense technology is adapting to and affecting changes in military doctrines and operations”

⁶ Prof. Dr. Holger H. Mey, Vice President of the European Aeronautic Defence and Space Company, EADS on “The Role of Technology in Future Conflicts - Limitations and Opportunities”, High Level Seminar on military Doctrine, Vienna, May 2011.

⁷ Prof. Dr. Holger H. Mey, Po aty.

Kodi etik dhe lidershipi

Dr. Edmond Braneshi,
Shef i Seksionit të Udhëheqjes Ushtarake në AM “Spiro Moisiu”

Abstrakt. *Kodi etik është një “armë e fuqishme” në duart e drejtuesit, i cili duhet ta përdorë në funksion të krijimit të një mjedisi të këndshëm dhe një klime të favorshme komandimi. Ai ka të bëjë drejtpërsëdrejti me forcimin e marrëdhënieve drejtues-vartës që, domosdoshmërisht, duhet të jenë në lartësinë e duhur dhe t’i përgjigjen realizimit të misionit.*

Për të pasur një kod etik sa më efektiv, drejtuesi duhet të mbështetet në disa piketa që do të shërbejnë si themele të forta për çimentimin e marrëdhënieve me vartësit. Për rrjedhojë, ato do të jenë në shërbim, jo vetëm të punës, por dhe të suksesit. Këto piketa janë: çmitizimi, ndjenja e vlerësimit, respektimi i mendimit, etika e komunikimit, falënderimi i vartësve, etika e grupit ose përfshirja e vartësve në projekte. Të gjitha këto përbëjnë “infrastrukturën” e nevojshme të drejtuesit për të qenë i suksesshëm dhe, njëkohësisht, këto janë sfida me të cilat ai do të përballlet vazhdimisht.

“Pa etikën, çdo gjë do të ndodhte sikur ne të gjithë të ishim pesë miliardë udhëtarë, të hipur në një makinë të madhe që nuk e drejton njeri. Ajo lëviz gjithnjë e më shpejt, por ne nuk e dimë se ku shkon...”

Zhak Kusto (Jacques Cousteau)

Hyrje

Fjalja etikë buron nga shprehja greke *ethos/ethikos* që ka domethënie e traditës, dokeve dhe shprehive. Sipas *Enciklopedisë Britanike*, etika paraqet një degë të filozofisë që merret me vlerat themelore të marrëdhënieve ndërmjetëzore që studion cilësinë dhe bazën e veprave apo sjelljeve të cilat, nga këndi i moralit, janë të mira apo të këqija, të qëlluara apo të shëmtuara¹. *Merriam Webster’s Collegiate Dictionary*, etikën e shpjegon si një disiplinë që ka të bëjë me të mirën e me të keqen dhe me detyrimet morale, si një tërësi e parimeve dhe vlerave morale, si parime të sjelljes që e qeverisin një individ ose grup, si filozofi drejtuese.

Ndërsa etika ushtarake sipas *“Military Ethics The Dutch Approach a Practical Guide”* përkufizohet si një etikë që ka të bëjë me natyrën, përmbajtjen, vlefshmërinë dhe efektet e moralit në një kontekst ushtarak². Aty jepen edhe pesë shtresat që përmbushin etikën ushtarake: 1) Sistemi i vlerave vetjake; 2) Etika e profesionit ushtarak; 3) Etika e profesioneve të veçanta brenda ushtrisë; 4) Etika organizative, e cila vendos standartet për organizatën dhe për personelin e saj; 5) Etika politike, e cila vendos standardet për prioritetet, në bazë të të cilave reparte të FA mund të dërgohen në një mision të caktuar nga lidershipi politik.

Në këtë kuadër, kodi etik synon vendosjen dhe respektimin e rregullave të sjelljes që quhet etika profesionale e punonjësve apo anëtarëve të organizatës, në shërbim të detyrës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve. Etika ndihmon që të gjithë anëtarët të përcaktojnë rolin dhe përgjegjësitë, në lidhje me vetveten, me kolegët, me partnerët dhe me organizatën ku bëjnë pjesë.

Etikë do të thotë që çdo anëtar i organizatës duhet:

- të përkrahë formalisht dhe shpirtërisht frymën që përçojnë parimet, ligjet, rregullat dhe udhëzimet që zbatohen në organizatë;
- të nxisë përgjegjshmërinë ndaj vetes, eprorëve dhe publikut;
- të eliminojë mungesën e respektit ndaj të tjerëve, padrejtësitë dhe pandershmëritë;
- të mos jetë indiferent kur duhet të përballet me probleme etike;
- të nxisë dialogun, diskutimet e hapura dhe pa paragjykime;
- të respektojë standardet bazë të sjelljes si brenda, ashtu dhe jashtë mjedisit të organizatës;
- të jetë krenar për atë që është arritur dhe se si është arritur;

Me fjalë të tjera, kodi etik është një *fushë e gjerë*, ku të gjithë elementet kanë ndikim të padiskutueshëm në marrëdhëniet e punës me kolegët, bashkëpunëtorët, eprorët, etj. Këtë *“fushë të gjerë”*, një drejtues i mençur e përdor në favor të tij, pikërisht për të realizuar detyrën me parametra optimalë dhe për të arritur objektivat në kohë. Etika është një shtyllë e fuqishme në themelin e Lidërshiptit e cila, kur funksionon siç duhet, garanton një sukses të sigurt.

Kodi etik dhe rëndësia e tij në krijimin e klimës së besimit

*“Askush nuk është nderuar ndonjëherë për atë që ka marrë. Nderimi ka qenë shpërblimi për atë që ai ka dhënë”.*³

Kelvin Kulixh

Një drejtues i mirë duhet të ruajë gjithmonë etikën, sidomos me ata që ka nën vete. Ai duhet të përçojë ngrohtësi, duke krijuar marrëdhënie partneriteti dhe duke respektuar dhe dëgjuar vartësit me vëmendje. Nuk është e thënë të pranojë çdo sugjerim të tyre, por nuk është e thënë as që të mos i dëgjojë. Në qoftë se drejtuesi është një dëgjues i vëmendshëm, ai do të pranojë ato ide, kritika dhe vërejtje që i shërbejnë përmirësimit të punës në organizatë dhe krijimit të një atmosfere mobilizimi e kujdesi.

Etika duhet të ketë marrëdhënie të dyanshme. Krijimi i një mjedisi të këndshëm, përzemërsia në të komunikuar, durimi në të dëgjuar, qartësia në të shprehur, mosndërprerja e fjalës, përqendrimi gjatë dëgjimit, vlerësimi i asaj që thuhet, sensi i të mësuarit, bindja për ato që fliten, siguria në arritjen e tyre janë tipare të etikës që drejtuesi paraqet te vartësit dhe kjo rrit respektin, vlerësimin dhe besimin për të.

Etika profesionale duhet ruajtur në çdo kohë. Shpesh ka vartës që nuk janë kompetentë për punën e tyre që shfaqin sjellje jokorrekte, apo tregojnë karakter të dobët. Në një rast të tillë, ndërhyrja e drejtuesit është e domosdoshme, duke vënë në pah të metat apo arsyet e mosrealizimit të objektivit dhe të acarimit të situatës. Gjatë përballjes me vartësin, drejtuesi duhet të zotërojë vetveten, të mos shprehë inatin, të ruajë gjakftohtësinë për të shmangur çdo thënie, për të cilat, më vonë, ai do të pendohej. Ai duhet të ruajë etikën profesionale, duke qenë i drejtë, i arsyeshëm dhe t’ia bëjë të qartë vartësit të tij që ky qortim apo dënim vjen si rezultat i sjelljes që ai demonstroi. Po aq e rëndësishme është që drejtuesi të rivendosë sa më shpejt marrëdhëniet e përzemërta e normale të mëparshme, duke u çliruar plotësisht nga mëria dhe inati. Tashmë *nuk është koha e të bërtiturave, e të thirrurave, por koha e diturisë, e arsyes, e bindjes nëpërmjet argumentit e shembullit vetjak*⁴.

Në rregulloret tona thuhet që urdhri i eprorit është ligj për vartësit. Drejtuesi duhet të jetë bindës ndaj vartësve që çdo urdhër të zbatohet, duke dhënë maksimumin, jo se këtë e kërkon drejtuesi, por sepse e kërkon misioni, detyra, organizata. Metodatat me të cilat jepen urdhrat duhet të jenë edhe në përputhje me rregullat për të mos shkaktuar mosbindje dhe acarim të

personelit. *“Mënyrat nxitëse, arrogante apo grindavece në dhënien e urdhrin duhen mënjeluar. Vartësit janë njerëz dhe duhen trajtuar si të tillë. Nuk duhet kapur pas vogëlsirave kur një vartës bën të gjitha përpjekjet e mundshme për kryerjen sa më mirë të detyrës”*⁵.

Zotërimi i një etike brilante dhe zbatimi i saj nga drejtuesi në mënyrë të vazhdueshme do të rrezatojë një marrëdhënie e bashkëpunim miqësor me vartësit, bashkëpunëtorët dhe me të tjerët që kanë apo jo lidhje pune. Kjo kërkon një angazhim vetjak të drejtuesit dhe njohje të thellë të karakterit dhe interesave të vartësve të tij. Njohja e nevojave të tyre dhe preokupimi për plotësimin e kërkesave bën që drejtuesi të komunikojë me ta dhe të fitojë nderimin e respektin e tyre. Drejtuesi duhet të dëshmojë me prova kompetencën e tij profesionale, virtytet shoqërore, thjeshtësinë, interesin dhe përkujdesjen, ruajtjen e dinjitetit të njerëzve që drejton.

Ai është përgjegjës për të krijuar dhe ruajtur një klimë besimi e mirëkuptimi me ta. Suksesi do të varet nga klima, e cila duhet të nxisë drejtuesit vartës të të gjitha niveleve të mendojnë në mënyrë të pavarur dhe të kenë nismë veprimi për realizimin e objektivave. Pra drejtuesi, me kodin e tij etik duhet të krijojë një bosht të lexueshëm marrëdhëniesh për secilin njeri, ku të pasqyrohen respekti ndaj vetes, ndaj punës dhe mendimit të vartësve, sepse kjo do të parashtrijë rrugën e suksesit. Ky bosht përbëhet nga disa piketa njerëzore të drejtuesit që shërbejnë si themele të forta për të patur një marrëdhënie të shkëlqyer me vartësit dhe që, për rrjedhojë, do të jenë në shërbim jo vetëm të punës por dhe të suksesit. Këto piketa janë:

– Çmitizimi

Drejtuesi, në radhë të parë është njeri, dhe si i tillë ai kurrë nuk duhet ta konsiderojë veten të pagabueshëm apo “Zeus”. Normalisht, si tërë të tjerët, edhe ai mund të gabojë. Por kjo nuk do të thotë që për hir të egos së tij të mos pranojë gabimet e tij apo t’ia faturojë të tjerëve. Majk Miërs (Mike Mears), në librin e tij “Elementet e Lidërshiptit”, shprehet se *pranimi i gabimeve është hapi i parë i marrjes së përgjegjësisë dhe i shmangies së gabimeve të njëjta në të ardhmen. Mospranimi i tyre të çon në mohimin apo refuzimin e gabimeve të dukshme... dhe në humbjen e besueshmërisë*.⁶ Nëse drejtuesi pranon gabimet, nëse ai vlerëson vërejtjet e kolegëve dhe të vartësve, ai e lartëson autoritetin dhe respektin e tij. Njeriu mëson nga gabimet, kështu që fshehja dhe mosreagimi ndaj tyre të çon në gabime të tjera. *“Një njeri që pranon gabimet, shfaq një karakter të fortë. Pranimi kur ju keni bërë gabime tregon guxim moral. Ne jemi të gjithë qenie njerëzore dhe bëjmë gabime, por gabimet me dashje dhe mbulimi i tyre tregojnë karakter të dobët”*⁷. Pranimi i gabimeve nga ana e drejtuesit e bën atë më njerëzor dhe largon efektin e “mitit”, e “të pagabueshmit”. Kjo reflekton mirësi edhe te vartësit që të mos i fshehin gabimet dhe të mos tremben nga to, por të mësojnë prej tyre dhe të reflektojnë për të përmirësuar punën në të ardhmen. Sipas Niçes, ai që pranon gabimet, tregon se sot është më i mirë se sa dje.

– Ndjenja e vlerësimit

Drejtuesi duhet të vlerësojë punën e vartësve. Gjatë vëzhgimit duhet të shohë përpjekjet e tyre dhe t’i përkrahë në çdo moment. Kjo do t’i motivojë vartësit për të ardhmen dhe ata do të ndjehen si partnerë të tij në realizimin e detyrave. Çdo arritje, çdo sukses në organizatë, drejtuesi gjithmonë duhet t’ua dedikojë atyre me të cilët ai punon. Respekti ndaj njerëzve, ndaj punës së tyre, ka të bëjë me anën e tyre shpirtërore, i dyfishon punonjësve energjitë në çdo lloj situatë dhe ndikon pozitivisht në suksesin e pritur.

Duke iu referuar jetës dhe përvojës së drejtuesve të suksesshëm të cilët arritën majat e karrierës ushtarake, shohim se një nga pikat kyçe të suksesit të tyre ishte pikërisht adresimi i arritjeve të organizatës vartësve dhe thjeshtësia e tyre në komunikim. Kështu, B. Montgomeri, projektuesi i fitores së betejës së El Alameinit në Afrikën Veriore, gjatë bilancit të bërë për këtë betejë theksonte: "... *Fitorja e madhe u arrit në sajë të cilësive të larta të ushtarëve, sesa në sajë të çdo arsyeje tjetër*".⁸ Duajt Ajzenhauri, më 7 shkurt 1948, i dorëzoi detyrën e tij si shef shtabi gjeneralit Omar Bredli në një ceremoni të thjeshtë. Ai i adresoi "ushtarakut amerikan" duke vlerësuar dukshëm rolin e tij në arritjet e ushtrisë amerikane. Në fund ai tha: "*Unë nuk mund të rri pa iu thënë luftëtarëve, atyre që kanë lënë radhët dhe juve që akoma mbani uniformën, që mburrja ime më e madhe do të jetë gjithnjë: Unë isha shoku i tyre ushtar*".⁹ Ky është një mësim me vlera për çdo drejtues.

– Respektimi i mendimit

Drejtuesi është i rrethuar nga një staf me përvojë që, po t'i mbledhësh vitet e tyre të punës bëjnë një shumëllojë të përvojës së drejtuesit. Kjo përvojë vlen të merret në konsideratë për zgjidhjen e problemeve të ndryshme dhe njëkohësisht i bën ata bashkëpërgjegjës dhe partnerë. Të drejtosh njerëzit do të thotë të respektosh vartësit, mendimin e tyre, vlerat që ata mbartin, t'iu krijosh hapësirën e nevojshme për diskutim, të "vjelësh" mendimet e tyre për probleme të vogla ose të mëdha qofshin. Respekti për të tjerët i rrit vlerat një drejtuesi. Stili bashkëpunues i drejtimit, që mbahet sot si më i suksesshmi në botën demokratike, ka në themel pikërisht faktin që në marrjen e çdo vendimi, bazë është logjika, argumenti, mendimet e vartësve, besimi reciprok dhe në momentin që ai kthehet në vendim, drejtuesi ka përgjegjësinë absolute për zbatimin e tij. Shtefën Ambroz, në librin e tij "Duajt Ajzenhauer", thekson: "Ajzenhaueri përzihej lehtë me shtabin e tij dhe i diskutonte vendimet me vartësit. Ai priste derisa arrihej marrëveshja e plotë nga i gjithë shtabi dhe në fund urdhëronte oficerin operativ të shkruante direktivën përfundimtare"¹⁰.

Tërheqja e mendimeve të vartësve është jo vetëm apel ndërgjegje për drejtuesin por edhe një detyrim ligjor për respektimin e ideve të tyre. Është e mira që për çdo problem të rëndësishëm drejtuesi të fusë frymën e debatit. "*Debati është mënyra më frytdhënëse për arritjen e rezultateve të dëshiruara. Vetëm nëpërmjet debateve për problemet që shqetësojnë shtabin, për rrjedhojë dhe drejtuesin, bëhet e mundur të gjendet zgjidhja më optimale*"¹¹. Gjatë shkëmbimit të mendimeve për probleme të ndryshme, drejtuesi duhet të krijojë një mjedis ku të gjithë pjesëmarrësit ta ndiejnë veten të barabartë dhe të japin me ndershmëri mendimet e tyre. Kolin Pauell, kur u emërua komandant i Korpusit të pestë në Frankfurt, në takimin e parë me komandantët vartës, ndër të tjera, iu shpjegoi dhe konceptin e tij për besnikërinë: "*Kur jemi duke debatuar për një çështje, besnikëri do të thotë të më jepni mua opinionin tuaj të ndershëm, sido që ta mendoni, e pëlqej unë apo jo. Mendimet e ndryshme, në këtë fazë, më stimulojnë mua. Por sapo të jetë marrë vendimi, debati mbaron. Që nga ky çast e tutje besnikëri do të thotë zbatimi i vendimit, sikur atë ta kishit marrë vetë*"¹².

Drejtuesi gjithmonë duhet t'iu japë mundësi vartësve për të shprehur mendimet e tyre sikurse ata i ndiejnë. Kjo do të thotë që drejtuesi të jetë një dëgjues aktiv. Ai duhet të dëgjojë me vëmendje, të bëjë pyetje sqaruese kur është e nevojshme dhe të japë të kuptojë që ai dëgjoi të gjitha çka vartësi dëshironte të shprehte. Në qoftë se një vartës sugjeron për të ndryshuar diçka, mos e kundërshtoni menjëherë, lëre të paraqesë plotësisht propozimin e tij. Më pas, nëse nuk jeni dakord, jepni arsyet dhe argumentet tuaja. Vartësi duhet të ndjehet i lirë të paraqesë idetë e tij pa patur frikë se do ta kundërshtoni flakë për flakë. Vetëm në këtë mënyrë ju do të nxisni mendimin krijues dhe novator.

Drejtuesi duhet të jetë një moderator i shkëlqyer, i cili duhet të orientojë opinionet e vartësve në mënyrë të tillë që të dalë atje ku ai dëshiron, duke i bërë ata bashkëpjesëtarë dhe bashkëpërgjegjës të asaj çka vendoset. Madje kur drejtuesi miraton dhe shfrytëzon mendimin e vartësit, ai duhet ta bëjë të ditur këtë, duke identifikuar edhe personin që e ka dhënë mendimin, sidomos kur zbatimi i këtij mendimi del me sukses.

– Etika e komunikimit (ose të lutem, nëse...)

Siç u theksua dhe më lart, drejtuesi, në çdo kohë, duhet të ruajë etikën me njerëzit. Pavarësisht se marrëdhëniet epror-vartës janë të përcaktuara në rregulloret tona, drejtuesi nuk humbet asgjë nëse përdor fjalët “të lutem, nëse” por, përkundrazi ato do të kenë karakter shoqëror dhe civilizues, ku raportet drejtues-vartës do të përputhen me ato njerëzore, ku dhe vartësi më i pabindur, i ndodhur përballë këtij realiteti do të tundohet dhe do të bëjë të gjitha përpjekjet të zbatojë në mënyrë korrekte atë që i ngarkohet. Këto fjalë, të thëna herë pas here nga drejtuesi, nuk janë lutje për vartësin por, duke i parë në raport me personalitetin e tij, vijnë natyrshëm, duke mbartur brenda edhe urdhrin, edhe bindjen, edhe mirësjelljen... Kjo, natyrisht, do të sjellë rritjen e besimit dhe besnikërisë së tyre ndaj drejtuesit, gjë për të cilën ai ka nevojë. Besimi nuk mund të kërkohet, por ashtu si respekti duhet të fitohet. Besimi i dyanshëm është parakusht për sukses.

– Falënderimi i vartësve

Drejtuesi duhet t’i kushtojë një vëmendje të madhe përgëzimit dhe falënderimit të njerëzve që punojnë me të. Ai, pas çdo detyre të kryer, pas çdo suksesi, duhet t’i falënderojë ata. Shija e ëmbël që lë te vartësit një falënderim i drejtuesit, i bën ata më të përgjegjshëm dhe më të përkushtuar për të ardhmen. Peri Smith (Perry Smith) te “Përgjegjësia” shkruan: “*Drejtuesit duhet të çohen në mëngjes, duke falënderuar njerëzit, në drekë duhet të falënderojnë më shumë njerëz dhe para se të shkojnë në shtëpi në mbrëmje akoma më shumë. Falënderimi i njerëzve është pjesë e rëndësishme e kujdesit për ta, sepse është kujdesi për shëndetin psikologjik të tyre dhe të organizatës*”¹³. Drejtuesi, duke falënderuar vartësit herë pas here, bën që ata të mendojnë që janë dikush, kanë një rol të caktuar në organizatë dhe njëkohësisht ndodhen nën vëmendjen e tij, për rrjedhojë ata janë të vlerësuar. Kjo do të rrisë dukshëm te vartësit besimin tek vetja dhe kënaqësinë në punë.

Që një falënderim të japë ndikimin e duhur te vartësi, ai duhet të ketë një logjikshmëri përkatëse. Ka disa hapa që duhen patur parasysh në dhënien e falënderimeve nga drejtuesi: *së pari, falënderimin bëjeni në kohë, mundësisht sa më afër ngjarjes që të jetë e mundur; së dyti, falënderimin bëjeni në mënyrë të sigurtë; së treti, shoqërojeni falënderimin tuaj edhe me arsytet se përse po e falënderoni personin përkatës.*¹⁴ Në përgjithësi, njerëzit punojnë me devotshmëri për të plotësuar detyrën dhe për t’i shërbyer sa më mirë organizatës apo institucionit. Ata dëshirojnë të marrin pjesë në sukses. Është e rëndësishme që drejtuesi t’i kujtojë vetes vazhdimisht se vartësit e tij janë duke u përpjekur diku, janë duke bërë sakrifica për të bërë një punë të mirë. Prandaj, ai duhet të takohet e të rrijë shpesh me ta dhe t’i përgëzojë e falënderojë për punën. Herë pas here, drejtuesi, duhet të zhvillojë teknikat për të falënderuar vartësit individualisht dhe kolektivisht. *Nga të gjitha aftësitë e komunikimit që duhet të ketë një drejtues, aftësia për të dhënë lavdërime emocionale duhet të jetë në krye të listës.*¹⁵

– Etika e grupit ose përfshirja e vartësve në projekte

Drejtuesi duhet të ketë të qarta parimet e punës në grup. Veprimtaria nuk do të ketë sukses nëse ajo do të përqendrohet e gjitha në një dorë. Puna në grup vazhdimisht ka qenë më

rezultative, kur të gjitha hallkat funksionojnë si një zinxhir, të cilat nuk bëjnë dot pa njëra-tjetrën dhe drejtuesi është një rregullator. Në librin “Komunikimi në biznes” theksohet: *“Etika në grup është veçanërisht e rëndësishme, pasi aftësia për të ruajtur marrëdhënie të mira me të tjerët ndikon në arritjen e suksesit”*.¹⁶ Drejtuesi, duke ditur si të silllet dhe ndërveprojë me të tjerët, shfaqet si njeri i kulturuar, profesionist dhe i besueshëm. Përshtypja që lë tek të tjerët dhe aftësia për t’i bërë ata të ndjehen mirë. Kur bashkëpunojnë me të janë përbërës të rëndësishëm të një karriere të suksesshme.

Për këtë arsye, një drejtues i zgjuar, për çdo detyrë të marrë, duhet të thotë: “Ne kemi marrë “x” detyrë e...” dhe jo “Unë kam marrë “x” detyrë...”. Duke u shprehur “Ne” do të thotë që ekipi ku përfshihen dhe vartësit, është përgjegjës për realizimin e këtij projekti dhe drejtues e vartës janë një dhe punojnë për të njëjtin qëllim. Për rrjedhojë, edhe sukseti i përket ekipit, ku secili ka meritat e veta. Sipas Smith drejtuesi duhet që *të kalojë çdo lavdërim te vartësit e tij sepse, pothuajse kurdoherë, sukseset janë të tyre, idetë të tyre, efektiviteti dhe puna e vështirë janë të tyre, krijimtaria është e tyre, gjithçka, një kombinim i mrekullueshëm, është i tyre*¹⁷

Kjo tregon jo vetëm mirësjellje por dhe fisnikëri. Prandaj drejtues dhe vartës duhet të jenë pjesë përbërëse e të njëjtit ekip. Fjala “Ne” i shkrin në një të vetme dhe nuk bën ndarje apo dallime, por të gjithë së bashku janë për një qëllim.

Përfundime

Fryti i suksesit në realizimin e misionit të organizatës është i lidhur katërcipërisht me aftësitë që drejtuesi duhet të paraqesë në marrëdhënie me të gjitha hallkat bashkëpunuese, eprore dhe vartëse. Rrezatimi i tipareve dalluese të personalitetit, zbatimi brilant i kodit etik, komunikimi i ngrohtë dhe shoqëror luajnë një rol shumë të rëndësishëm në krijimin e një imazhi pozitiv të drejtuesit.

Drejtues i mirë është ai që kryen detyrën e ngarkuar, por kurrë nuk harron vartësit e tij. Thelbi i artit të drejtimit është të kuptosh qartë detyrën, të planëzosh me kujdes e maturi, të trajtosh vartësit mirë, të krijosh një mjedis të përshtatshëm, ku ata, me dëshirë, gjithçka personale ta shikojnë si pjesë të përmbushjes sa më mirë të misionit. Kjo e fundit do të jetë sfida më e madhe për të. Ajo (sfida) kapërcehet suksesshëm kur drejtuesi di të bëjë vartësit për vete, është një njeri me karakter dhe ndikon gjithnjë për të mirë te ata, duke orientuar drejt interesat e tyre në funksion të misionit.

Kjo ndodh kur ai është i pranueshëm nga organizata jo vetëm si “autoritet zyrtar”, por edhe si “autoritet shoqëror”. Pikërisht, zbatimi i normave të etikës ta ofron këtë “pranueshmëri”, të jep kurdoherë përparësi mbi të tjerët, të krijon mundësi për gjykime e vendime të drejta, për saktësi e paanshmëri, të bën të ndjehesh fizikisht dhe shpirtërisht pranë vartësve, të njohësh në çdo kohë gjendjen e tyre moralo-psikolo-gjike, duke qenë vazhdimisht më pranë rezultatit. Kjo është arsyeja që drejtuesi, veprimtarinë e tij, gjithnjë duhet ta shohë në baraspeshë me atë të vartësve dhe asnjëherë nuk duhet të mendojë për “unin” e tij, por për ngritjen e dinjitetit të tyre, për suksesin e tyre, e lidhur kjo me përmbushjen e objektivave.

Bibliografia:

- Shtefën Ambroz, “Duajt D. Ajzenhauer”, SHBU, Tiranë 1995.
- Th. A. van Baarda and D. E. M. Verweij, “Military Ethics, The Dutch Approach a Practical Guide”, Martinus Nijhoff Publishers Leiden, Boston 2006.

- Mehmet Ali Birand, “Urdhëroni komandant”, SHBU, Tiranë, 1994.
- Ervin Demo (MA), Petrit Dollani (MSc), “Komunikimi në biznes”, UT, Fakulteti i Ekonomisë, Departamenti i Menaxhimit, Tiranë 2007.
- Mike Mears, “Leadership Elements, a guide to building trust”, i Universe, Inc. New York Bloomington 2009.
- Bernard Montgomer, “Fushëbeteja” (kujtime), SHBU, Tiranë 1994.
- Ali Pajaziti, Murtezan Ismaili, Mentor Hamiti, “Etika: Sfidë e Mileniumit të tre-të”.
- Kolin Pauell, “Udhëtimi im amerikan”, SHBU, Tiranë 1999.
- L.A. Penigton, Romeyn, B. Hought, H.W. Case “Psikologjia e drejtimit në ush-tri, SHBU, Tiranë 1993.
- Perry M. Smith, “Taking Charge, a practical guide for leaders”, National Defense University Press, Washington, D.C. 1986.
- “Komandimi e kontrolli dhe procedurat e punës në shtab” (MP 3-1), QSHBPU, Tiranë, 2004.
- “Sfidat e jetës, 2001 mendime nga personalitete”, SHB “Iliri”, “Tiranë 1999”.
- “Udhëheqja ushtarake”, SHBU, Tiranë 1995.

Referenca

- ¹ Ali Pajaziti, Murtezan Ismaili, Mentor Hamiti, “Etika: Sfidë e Mileniumit të tretë”, faqe 3.
- ² Th. A. van Baarda and D. E. M. Verweij, “Military Ethics The Dutch Approach a Practical Guide”, Martinus Nijhoff Publishers Leiden, Boston 2006, faqe 2.
- ³ “Sfidat e jetës, 2001 mendime nga personalitete”, SHB “Iliri”, “Tiranë 1999, faqe 4.
- ⁴ Mehmet Ali Birand, “Urdhëroni komandant”, SHBU, Tiranë 1994, faqe 142-143.
- ⁵ L.A. Pennington, Romeyn, B. Hought, H.W. Case, “Psikologjia e drejtimit në ushtri”, SHBU, Tiranë 1993, faqe 154.
- ⁶ Mike Mears, “Leadership Elements, a guide to building trust”, Universe, Inc. New York Bloomington 2009, faqe 92.
- ⁷ “Udhëheqja Ushtarake”, SHBU, Tiranë 1995, faqe 73.
- ⁸ Bernard Montgomeri, “Fushëbeteja” (kujtime), SHBU, Tiranë 1994, faqe 13.
- ⁹ Shtefën Ambroz, “Duajt D. Ajzenhauer”, SHBU, Tiranë 1995, faqe 72.
- ¹⁰ Po aty, faqe 105-106.
- ¹¹ “Komandimi e kontrolli dhe procedurat e punës në shtab” (MP 3-1), QSHBPU, Tiranë 2004, faqe 35.
- ¹² Kolin Pauell, “Udhëtimi im amerikan”, SHBU, Tiranë 1999, faqe 238.
- ¹³ Perry M. Smith, “Taking Charge, a practical guide for leaders”, National Defense, University Press, Washington, D.C. 1986, faqe 8-9.
- ¹⁴ Mike Mears, “Leadership Elements, a guide to building trust”, Universe, Inc. New York Bloomington 2009, faqe 101.
- ¹⁵ Perry M. Smith, “Taking Charge, a practical guide for leaders”, National Defense, University Press, Washington, D.C. 1986, faqe 71-72.
- ¹⁶ Ervin Demo (MA), Petrit Dollani (MSc), “Komunikimi në biznes”, (Cikël leksionesh), Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, Departamenti i Menaxhimit, Tiranë 2007, faqe 29.
- ¹⁷ Perry M. Smith, “Taking Charge, a practical guide for leaders”, National Defense, University Press, Washington, D.C. 1986, faqe 72.

“Doktrina Obama”- Liderhipi strategjik global amerikan në skenën ndërkombëtare

MSc. Granit Zela,
Pedagog në Qendrën e Gjuhëve të Huaja
Akademia e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”

Abstrakt. *Përdorimi i Soft Power (Fuqisë së Butë), si instrument i rëndësishëm i Diplomacisë, rorientimi i fuqisë ushtarake amerikane “Hard Power” (Fuqia e Fortë) në Afganistan, Irak, Pakistan dhe më gjerë, bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare dhe partneriteti, si nevojë e diktuar prej realitetit global kanë shërbyer si pikënisje për shumë akademikë, studiues dhe analistë të marrëdhënieve ndërkombëtare që të përvijojnë parimet udhëheqëse të “Doktrinës Obama”.*

Sipas “Doktrinës Obama” liderhipi i hiperfuqisë amerikane në botë nuk konsiderohet gjithmonë si i mirëqenë (rasti i Libisë dhe nivelit të ndryshëm të përfshirjes së SHBA-së në trazirat e vendeve të Lindjes së Mesme), por mbështetet në bërjen e zgjedhjeve të zgjuara të një fuqie të zgjuar (smart power), zgjedhje të paramenduara se si, kur dhe me kë duhet të udhëhiqet në skenën ndërkombëtare. Analiza nuk mund t’i shpëtojë krahasimit me doktrinën e presidentit paraardhës Xhorxh W. Bush, parimet kryesore të së cilës u shtjelluan në numrin e kaluar të Revistës Ushtarake (Qershor 2011).

Hyrje

Termi “Doktrina Obama” është përdorur që në fillim të fushatës presidenciale ku, në një nga debatet mes kandidatëve demokratë, Obama u përgjigj se doktrina e tij “nuk do të ishte aq doktrinale sa e Bushit, sepse bota është e ndërlkuar.” Vizionin për politikën e tij të jashtme dhe të sigurisë, Obama e paraqiti në artikullin e botuar tek revista “Foreign Policy” me titull “Ripërtëritja e liderhipit amerikan”. Duke iu referuar trashëgimisë së Ruzveltit (Roosevelt), Trumanit (Truman) dhe Kenedit (Kennedy), Obama e përshkroi doktrinën e tij në një mënyrë klasike liberale, uillsoniane, duke theksuar që “siguria dhe mirëqenia e amerikanëve lidhen fort me sigurinë dhe mirëqenien e popujve që jetojnë përtej kufijve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës”.¹

Pas ceremonisë së betimit si President në janar 2009, analistët nisën të hamendësojnë për një “Doktrinë Obama”, duke iu referuar objektivave kryesorë të politikës së tij të jashtme: përfundimi i përgjegjshëm i luftës në Irak dhe rifokusimi tek sfidat më të rëndësishme në rajon; përdorimi i mençur i ushtrisë përballë sfidave të shekullit të XXI; realizimi i një përpjekjeje globale për t’u përballur me ndalimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, krijimi i aleancave të nevojshme për t’u përballur me kërcënimet dhe krizat globale.”² Kur u pyet të përshkruante “Doktrinën Obama”, në prill të vitit 2009, ai u përgjigj se ndërsa SHBA mbesin të fuqishme në skenën ndërkombëtare, ato janë vetëm një komb, vende të tjera gjithashtu kanë ide të mira, vendet e tjera përfaqësojnë kultura dhe histori të ndryshme dhe kanë interesat e tyre.

Ndërsa Presidenti Obama ka shpallur rikandidimin për një mandat të dytë presidencial, “Doktrina Obama” është një term që përdoret sikurse në këtë shkrim, për të përshkruar kolonat kryesore unifikuese të politikës së jashtme dhe të sigurisë të cilat përcaktojnë liderhipin amerikan në skenën ndërkombëtare.

1. Diplomacia e “Soft Power”(Fuqia e butë)

Megjithëse luftërat e trashëguara në Lindjen e Mesme do të kërkonin një kohë më të gjatë për t'u përfunduar, Obama luftoi që të përmirësonte imazhin e SHBA-së në botë. Ai shpalli transformimin e “fuqisë së fortë” (hard power) në “fuqi të butë” (soft power), duke parapëlqyer diplomacinë në vend të ndërhyrjes ushtarake si dhe duke përdorur një retorikë politike miqësore ndaj vendeve të botës myslimane.

I vendosur për të përcjellë mesazhin e tij në botën arabe dhe myslimane, Obama e dha intervistën e tij të parë si president në një stacion televiziv arab që transmeton me satelit, në të cilën theksoi se pjesë e punës së tij të re ishte të “komunikonte faktin që SHBA është e interesuar për mirëqenien e botës myslimane, se gjuha që ne përdorim duhet të jetë gjuhë e respektit”. Presidenti Obama e përsëriti këtë mesazh me një efekt shumë më të madh, gjatë fjalimit të tij të mbajtur në universitetin e Kajros, pak muaj më vonë ku përsëriti citime nga Kurani, duke bërë thirrje për “një fillim të ri mes Shteteve të Bashkuara dhe myslimanëve”, duke kërkuar ndjesë për veprimet amerikane në të kaluarën dhe bëri thirrje për reforma në vendet jodemokratike nga brenda vetë vendit.

Lindja e Mesme. Presidenti Obama emëroi një të Dërguar Special për Lindjen e Mesme, ditën e tij të dytë si President. Objektivi i SHBA-së në rajonin e Lindjes së Mesme ishte sigurimi i një paqeje të qëndrueshme mes izraelitëve dhe fqinjëve të tij. SHBA u shpreh në mbështetje të ekzistencës së dy shteteve, Izraelit dhe Palestinës, fqinj dhe në paqe me njëri tjetrin por rruga për të arritur këtë mbetet për t'u përshkuar dhe Obama u angazhua që në fillim për të patur progres në bisedimet mes Izraelit dhe Palestinës.

Irani. Një zhvendosje më e madhe në politikën e jashtme amerikane ndodhi në qëndrimin e SHBA-së ndaj Iranit. Në fjalimin e 23 janarit 2009, Obama përmendi “zgjatjen e dorës” për vende si Irani, në mënyrë që të gjendet një zgjidhje në lidhje me çështjen e prodhimit të materialeve nukleare. Në mënyrë paralele me sanksionet kërcënuese, administrata hartoi një strategji të frenimit.

Obama zhvendosi dislokimin e mburojës europiane kundër-raketë, në favor të forcimit të një sistemi mbrojtës kundër-raketë në Lindjen e Mesme, në gjendje për të frenuar më mirë kapacitetet e Iranit. Pavarësisht shqyrtimit të shumë alternativave, ndër to dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, angazhimit diplomatik, Obama ka pasur si reagim një Iran më konfrontues ndërsa Shtëpia e Bardhë është e vetëdijshme për mos-efikasitetin e sanksioneve. Ndërsa të gjitha opsionet mbeten të hapura, angazhimi dhe trysnia në administratën e Obamës për të arritur një zgjidhje mbeten të për-hershme.

Riformësimi i marrëdhënieve me Rusinë

Gjatë vitit të parë të presidencës, marrëdhënia amerikano-ruse pati progres por, më pas, progresi mbeti në vend. Në Afganistan, marrëveshja e Ruisë për të siguruar transport për furnizime të NATO-s është dubluar nga një alternativë e rëndësishme e cila ka të bëjë më një rrugë “jugore”, potencialisht të rrezikshme nëpërmjet Pakistanit. Në Iran, pjesëmarrja e Moskës ishte vendimtare në prag-marrëveshjen e arritur në tetor 2009, sipas së cilës karburanti që vinte nga reaktorët iranianë do të shkonte në Rusi, e cila do ta kthente në Iran në një formë të përshtatshme vetëm për qëllime civile. Rusia mirëpriti braktisjen e mburojës raketore, të planëzuar nga administrata e Presidentit Bush, për t'u vendosur në Republikën Çeke dhe Poloni dhe, si këmbim, Moska hoqi dorë nga kërcënimi për të vendosur raketa Iskander në Kalingrad, të cilat dukej se do të përbënin kërcënim për Europën Lindore.

Marrëdhënia me Europën

Marrëdhënia me aleatët europianë mbetet gur themeli për angazhimin amerikan në botë dhe katalizator i veprimit ndërkombëtar. SHBA shpall si synim të saj që, së bashku me 27 aleatët e NATO-s dhe shumë partnerë me të cilët NATO bashkëpunon, të forcojë aftësinë kolektive për të nxitur sigurinë, parandaluar kërcënimet dhe mbrojtur popujt.³ SHBA mbetet e angazhuar në përkrahjen e aspiratave të Bashkimit Europian, sidomos në nxitjen dhe përhapjen e demokracisë në vendet e Europës Lindore, për të plotësuar tranzicionin e tyre demokratik si dhe e përkushtuar në mbështetjen e stabilitetit dhe demokracisë në Ballkan, zgjidhjen e konflikteve në Kaukaz dhe Qipro. SHBA është e interesuar që të forcojë marrëdhëniet me Turqinë në lidhje me stabilitetin në rajon. Kjo politikë e formuluar në dokumente të rëndësishme zyrtare për “mbështetjen e stabilitetit dhe demokracisë në Ballkan” u materializua me vizitat historike të Zëvendës/presidentit Xhozef Bajdën dhe Sekretares së Shtetit Hillari Klinton në Kosovë.

Çmimi Nobël

Senatori dhe më pas Presidenti Barak Obama, para mijëra adhuruesve të tij në Londër, Ankara, Spanjë, Kajro, Berlin, etj. vazhdon të ringjallë besimin e kombeve dhe popujve tek Amerika, vendi më i fuqishëm mbi tokë, tek idealet e saj të lirisë, demokracisë dhe paqes, për të cilat ka nevojë bota e shekullit XXI.⁴ Aq i madh ishte ndikimi i retorikës dhe kursit të ri të “Soft Power” të Obamës, sa pak muaj pas zgjedhjes së tij si President, iu akordua Çmimi Nobël për Paqen “*për përpjekjet e tij të jashtëzakonshme për të forcuar diplomacinë ndërkombëtare dhe bashkëpunimin mes popujve.*” Zgjedhja e Komitetit të Nobelit reflektonte shpresën e madhe për një fillim të ri të marrëdhënieve mes SHBA-së dhe pjesës tjetër të botës.

Në maj 2010, administrata publikoi Strategjinë e Sigurisë Kombëtare. Një nga qëllimet strategjike të SSK 2010 ishte përpjekja për të ribalancuar politikën e jashtme amerikane nëpërmjet zhvendosjes prej projektimit të fuqisë së fortë (hard power), duke kthyer kahun drejt një angazhimi më të madh diplomatik dhe zhvillimi, e ashtuquajtura “fuqi e zgjuar”, në mënyrë që të arrihet një politikë e integruar e sigurisë kombëtare.

2. Riorientimi i “Hard Power” (Fuqia e Fortë)

Rezultati i konflikteve të sotme do të formësojë në mënyrë të drejtpërdrejtë mjedisin e sigurisë globale për dekadat që vijnë dhe triumfi në operacionet aktuale përbën prioritetin kryesor të SHBA-së. Më shumë se tetë vjet luftë në Afganistan, Irak dhe kundër Al Kaedas dhe aleatëve të saj, kanë kërkuar një sakrificë të vazhdueshme të SHBA-së dhe ushtrisë amerikane. Ndërsa epiqendra e luftës ndaj kërcënimit terrorist ndaj Shteteve të Bashkuara është përqendruar në Afganistan dhe Pakistan, gjë që çoi në vrasjen e liderit të Al-Kaedas, Osama Bin Ladenit, lufta kundër Al Kaedas dhe aleatëve të saj vazhdon përreth botës. SHBA duhet të garantojë suksesin e forcave ushtarake në terren: në Afganistan, në Irak dhe në botë. Bashkë me aleatët dhe partnerët e saj, SHBA ka ripërtërirë përpjekjet për të ndihmuar qeveritë e Afganistanit dhe Pakistanit për të penguar, çmontuar dhe shkatërruar Al Kaedan dhe për të eliminuar parajsat e sigurta terroriste në të dyja kombet.⁵

Iraku

Obama kishte argumentuar qysh në fillim të fushatës presidenciale që lufta në Irak ishte një luftë e gabuar ndërsa ajo në Afganistan një luftë e nevojshme. Iraku kishte qenë çështja kryesore që kishte destabilizuar presidencën e Xhorxh W. Bushit dhe u kthye në një histori sukseesi gjatë vitit të parë në Shtëpinë e Bardhë. Në Irak, megjithatë, Obama arriti të bënte realitet premtimin kryesor të fushatës së tij, reduktimin e shpejtë të angazhimit amerikan

duke tërhequr forcat amerikane dhe për të shumëfishuar përpjekjet për rindërtimin e Irakut. Kjo u arrit, ndërsa dhuna e motivuar politikisht në Irak pësoi rënie.

Në Irak, vite përpjekjesh dhe një zhvendosje kritike drejt një strategjie të luftës kundërguerrile, të përqendruar tek popullsia, kanë ndihmuar qeverinë irakene për të marrë rol udhëheqës në mbrojtjen e popullit të saj dhe garantimin e shërbimeve thelbësore. Një shtet sovran, i drejtë dhe llogaridhënës iraken, në gjendje të ruajë unitetin kombëtar, mund të shërbejë si partner afatgjatë amerikan dhe do të mbështesë objektivat strategjike të Amerikës dhe ato të aleatëve të saj. Ndërsa reduktimi i përgjegjshëm i ushtrisë amerikane vazhdon, forcat amerikane do të vazhdojnë të luajnë role të rëndësishme në këshillimin, trajnimin dhe mbështetjen e forcave irakene.

Afganistani

Obama përvijoi kursin e ri në Afganistan. Administrata refuzoi mendësinë e “fitores me çdo kusht” të epokës së Bushit sepse vendoste objektiva përtej asaj që mund të arrihej, me një kosto të arsyeshme dhe asaj që ishte e nevojshme të arrihej për të siguruar interesat e SHBA-së. Me këtë qasje Obama, ndryshe nga Iraku, nuk shfaqti ndonjë synim për t’u larguar pasi, sipas tij, “duhej t’i mohohet Al-Kaedës një parajsë e sigurtë. SHBA duhet të zhdukë mundësitë e rikthimit të Talebanëve, bashkë me mundësinë për të përmbysur qeverinë e Kabulit. Në të njëjtën kohë, Obama shpalli synimin për forcimin e kapacitetit të forcave afgane të sigurisë dhe qeverisë, në mënyrë që ato të marrin përgjegjësi në të ardhmen. Ndërtimi i një shteti demokratik mund të merrte të paktën dhjetë apo njëzetë vjet, pa qenë në gjendje ta përcaktosh nëse kjo është arritur, ndërsa objektiva si mohimi i një parajse të sigurtë për Al-Kaedën dhe përmbysja e kundërsulmit të talebanëve ishin objektiva të matshme.

Obama e ka përshkruar luftën në Irak si unilaterale, paraprake (pre-emptive) dhe në dhunim të së drejtës ndërkombëtare, ndërsa konfliktin e Afganistanit si një shembull se kur duhet zhvilluar një luftë, luftë e zhvilluar me miratimin e OKB-së, si reagim ndaj një sulmi të drejtpërdrejtë ndaj SHBA-së si dhe sulm i realizuar me anë të një koalicioni të gjerë ndërkombëtar dhe në partneritet me Europën. Në fakt, arsyet se përse Obama përqendrohet fuqimisht tek Afganistani ka të bëjë me kushtet në të cilat ai mendon se SHBA mund të angazhohet në një luftë, të cilat përbëjnë qasjen e tij ndaj politikës së jashtme: qasje multilateraliste, në përputhje të përpiktë me të drejtën ndërkombëtare, (“luftë e nevojshme” dhe jo “luftë e zgjedhur” si në rastin e Irakut.)

Të pranuarit që fitorja në Afganistan më së fundi ka të bëjë me popullin e tij, forcat amerikane dhe aleatë janë fokusuar në sigurimin e qendrave kyçe të popullsisë, trajnimin e forcave kompetente afgane të sigurisë dhe partneritetit me ta, ndërsa ato luftojnë për të ardhmen e vendit. Në terma afat-shkurtër, pjesëtarë thelbësorë të forcave amerikane ka gjasë të operojnë në Afganistan dhe forcat amerikane në Irak do të vazhdojnë një reduktim të përgjegjshëm. Këto përpjekje do të përcaktojnë, në mënyrë thelbësore, masën dhe formën e elementëve madhorë të forcave amerikane për vite me radhë. Në terma afat-gjatë, SHBA pret që atje të përballojnë kërkesat operacionale në Afganistan dhe kudo tjetër për të mposhtur Al Kaedan dhe aleatët e saj.

Pakistani

Presidenti Obama deklaroi, në 1 maj 2011, që Osama Bin Laden ishte vrarë. Shtetet e Bashkuara ndërmorën një operacion ndaj një garnizoni në Pakistan ku pas një një shkëmbimi zjarri mbeti i vrarë udhëheqësi i Al-Kaedës Osama Bin Laden, kryeterroristi përgjegjës për sulmet e 11 shtatorit 2001, para dhjetë vjetësh.

Vdekja e Bin Ladenit përbën arritjen më të rëndësishme ndër përpjekjet e Amerikës për të luftuar dhe eliminuar rrjetin terrorist të Al Kaedas. Në fjalimin e tij para kombit amerikan, Obama deklaroi që vdekja e tij nuk shënon fundin e përpjekjeve ndaj terrorizmit pasi Al Kaeda do të ndërmernte sulme të tjera ndaj SHBA-së. Obama theksoi që “SHBA nuk është dhe nuk do të jetë kurrë në luftë me Islamin. Bin Laden nuk ishte një udhëheqës mysliman. Ai ishte një vrasës masiv i myslimanëve. Në të vërtetë, vdekja e tij duhet mirëpritur nga të gjithë ata që besonin tek paqja dhe dinjiteti njerëzor”.⁶

Megjithëse partneriteti me Pakistanin fokusohet në konfrontimin urgjent të Al Kaeda-s dhe aleatëve të saj, interesi i Amerikës në sigurinë dhe prosperitetin e Pakistanit do të vazhdojë shumë gjatë. Presidenti Obama e paraqiti këtë qasje gjithashtu në “*Strategji për Afganistanin dhe Pakistanin*”, të publikuar në mars 2009. Ai e përshkroi përfundimin e pranisë ushtarake në Irak dhe riorientimin e fokusit drejt Afganistanit si një *sine qua non* të rivendosjes së lidhshpimit amerikan në botë.⁷ Në këtë strategji të sigurisë cilësohet se fuqia amerikane nuk duhet të bazohet ekskluzivisht në përdorimin e armëve dhe se opsioni ushtarak do të merret në konsideratë vetëm kur të gjitha opsionet e tjera të kenë dështuar. Në këtë mënyrë kuptohet se flasim jo vetëm për privilegjimin e një parimi diplomatik, por edhe për shkak se operacionet e luftës kërcënojnë të gjymtojnë vendin, duke i marrë energji (ri-ndërtimit të një horizonti të ri).⁸

3. Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare

Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Presidentit Obama deklaroi, në tre faqe, që “ne duhet të fokusojmë angazhimin amerikan në forcimin e institucioneve ndërkombëtare dhe galvanizimin e një veprimi kolektiv që i shërben interesave të përbashkëta. Deklarata të mëtejshme shpjegojnë se si administrata planifikon ta bëjë këtë në mënyrë që: “Institucionet ndërkombëtare duhet të përfaqësojnë, në mënyrë më të efektshme, botën e shekullit të 21-të, me një zë më të gjerë dhe përgjegjësi më të mëdha për fuqitë në ngritje dhe ato duhet të modernizohen për të prodhuar rezultate të frytshme në çështje të interesit global. Presidenti Obama theksoi në fjalimin e tij në Uest Point nevojën për ripërtëritjen e aleancave të Amerikës dhe “formësimin e një rendi ndërkombëtar për të përmbushur sfidat e brezit tonë.”

Sfida e parë është mbështetja në organizata ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara. Duke e ngritur rolin e ambasadorit të OKB-së në pozicionin e kabinetit përbën një shenjë në këtë drejtim. Kanalizimi i objektivave të Këshillit të Sigurimit nëpërmjet Këshillit të Sigurisë, pavarësisht të drejtës së vetos, ka qenë një fokus qendror i administratës. Në këtë mënyrë është vepruar në lidhje me negociatat izarelito-palestineze, sikurse përpjekja për të parandaluar ambiciet nukleare të Iranit. Shtesa kryesore e këtij qëndrimi është besimi që globalizimi, mbështetja në marrëveshjet multilaterale, do të garantojnë siguri më të madhe për SHBA-në krahasuar me problemet e sigurisë që shkaktonte mbështetja e politikës unilaterale të SHBA-së në skenën ndërkombëtare.

SSK 2010 shkon përtej paradigmeve dominuese dhe unilaterale të paraardhësit të tij dhe përfshin mbrojtje të së drejtës ndërkombëtare. Kjo, në mënyrë të veçantë, ka një vlefshmëri të madhe, duke marrë për bazë që asnjë prej traktateve të mëdha për krijimin e një gjykate ndërkombëtare penale dhe të një gjykate ndërkombëtare për krime lufte nuk është nënshkruar nga ish-presidenti Xhorxh W. Bush.⁹

Partneriteti

Përhapja e fuqisë globale politike, ekonomike dhe ushtarake po bëhet më e shpërndarë. Ngritja e Kinës, vendit me popullsinë më të madhe në botë dhe Indisë, demokracisë më të

madhe në botë, do të vazhdojë të formësojë vazhdimisht një sistem ndërkombëtar në të cilin Shtetet e Bashkuara do të mbeten aktori më i fuqishëm por duhet që të punojnë gjithnjë e më shumë me aleatë dhe partnerë kyç nëse do që të ruajnë paqen dhe stabilitetin. Mënyra se si fuqitë në ngritje do të integrohen plotësisht në sistemin global do të jetë një nga çështjet përcaktuese të këtij shekulli dhe, kështu, përbën një nga interesat e rëndësishme të Amerikës.¹⁰

Presidenti Obama e ka karakterizuar vazhdimisht Amerikën si një komb mes të tjerëve dhe një partner “të barabartë” më shumë se një komb i domosdoshëm, me burime dhe përvojë unike të cilat Amerika do t’i ndajë me botën. Obama e zgjeroi temën e tij të Amerikës si një “partner i barabartë” në Kajro, korrik 2009. Po atë muaj, në Samitin e Amerikave, në Trinidad dhe Tobago, prill 2009, Presidenti Obama u pyet përsëri që të përkufizonte “Doktrinën Obama”. Presidenti u përgjigj që “Shtetet e Bashkuara mbeten kombi më i fuqishëm, i pasur në Tokë, por ne jemi një komb dhe problemet me të cilat përballemi, qofshin kartelat e drogës, ndryshimi klimaterik, terrorizmi, pavarësisht nga emri që kanë, nuk mund të zgjidhen vetëm prej një vendi të vetëm. Ai tha që Amerika do t’i konsideronte vendet e tjera si “partnerë të barabartë” dhe Amerikën jo si një vend “i jashtëzakonshëm” mes tyre, gjë që konsiderohej si e tillë nga shumë prej paraardhësve të tij”.

Gjatë vizitës së tij të parë me Grupin e 20 ekonomive në Europë, Obama shkoi më tej, duke theksuar, se megjithëse supremacia ushtarake amerikane nuk rrezikohet, marrëveshje të reja ndërkombëtare të tilla si zhvendosja e fokusit nga vendet e fuqishme të klubit G-8 në një klub më gjerë si G-20, i cili përfshin vende në ngjitje si Kina dhe Brazili, e nevojshme kjo në mënyrë që kostot dhe përfitimet e një rendi të qëndrueshëm ndërkombëtar të ndahen. Shtetet e Bashkuara nuk mund të zgjidhin pjesën më të madhe të kërcënimeve globale pa ndihmën e vendeve të tjera dhe nuk duhet që të mbajnë këtë barrë vetëm.

Ekonomia

Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Obamës njeh realitete të reja dhe reflekton të kuptuarit që SHBA përballet me sfida të qëndrueshme; përhapjen e armëve nukleare, terrorizmin dhe konfliktet rajonale për të cilat përgjigja më e mirë është një kthim në çështjet themelore. Njëra prej tyre është fuqia ekonomike. Në një kohë kur kriza financiare dhe barra fiskale e dy luftërave të gjata kanë shtuar frikën e një Amerike të tejshtirë, administrata përkrah ripërtëritjen ekonomike dhe teknologjike si një kolonë themelore e sigurisë amerikane. Një komb me vitalitet të zvogëluar ekonomik nuk mund ta ruajë supremacinë e tij ushtarake dhe politike. SHBA nuk mund të ketë nivel të madh deficiti dhe borxhesh, pa humbur ndikimin e saj, pa u bërë e kufizuar rreth vendimeve të vështira që duhet të marrë, ndër të cilat ishte edhe niveli i përfshirjes në “pranverën arabe” në Lindjen e Mesme.

Shumëkombësia

Libia

Mbështetësit e patundur të ndërhyrjes së komunitetit ndërkombëtar në Libi vazhdojnë të lavdërojnë operacionin në Libi si shembull se si mund të ndërtohet një koalicion me të vërtetë shumëkombësh. Kjo qasje e posaçme shumëkombëshe siguroi mbështetjen e Ligës Arabe, Këshillit të Sigurimit në Kombet e Bashkuara dhe NATO. Zyrtarët e lartë të administratës së Obamës argumentojnë se ndryshe nga lufta në Irak, koalicioni shumëkombësh krijoi një “legjitimitet” shumë më të madh i cili është thelbësor për të ruajtur mbështetjen e publikut dhe atë ndërkombëtare.

SHBA ndërmori këto hapa për të zgjidhur krizën në Libi: ngrirjen e aseteve të Kolonel Gadafit (Qaddafi) pas fillimit të protestave, mbështeti vendosjen e sanksioneve të forta, siguroi një rezolutë të fortë të Këshillit të Sigurimit, rezolutë e cila përcakton një zonë ndalim-fluturimi, organizoi një koalicion ndërkombëtar, realizoi ndërmarrjen e një fushate ushtarake, neutralizoi mbrojtjen ajrore të Kolonel Gadafit dhe fitoi terren ndaj forcave të tij tokësore. Dhe e gjithë kjo, jo vetëm pa asnjë viktimë në radhët amerikane por edhe me kontributin në ulje të SHBA-së, duke ia lënë komandën NATO-s dhe aleatëve europianë, në një kohë shumë të shkurtër krahasuar me krizën e stërzgatur të Bosnjës në vitin 1990-të.¹¹

Sipas Doktrinës Obama, SHBA nuk ka të drejtën e përcaktimit të lidhshimit të një vendi tjetër. Nëse në rastin e Libisë kërkohet largimi i kolonel Gadafit, kjo bëhet për të mbrojtur popullin libian nga masakrat ndaj civilëve dhe jo me qëllimin parësor ndryshimin e regjimit në Libi sikurse synonte Doktrina Bush e cila mëtonte të përhapte liberal-demokracinë me anë të fuqisë ushtarake. Ndërhyrja amerikane në krizat globale, si në rastin e Libisë, mbështetet në një politikë humanitare e cila kurdo që është e mundur mbron popujt e kërcënuar nga “mundësia e një dhune në shkallë të tmerrshme.” Kjo është arsyeja se përse SHBA është pjesë e një ndërhyrjeje ushtarake në një vend tjetër mysliman në Lindjen e Mesme.

Ndryshe nga Presidenti Bush, Presidenti Obama nuk synon ruajtjen dhe demonstrimin e një “superfuqie dominante ushtarake”. SHBA nuk ka drojë të veprojë në bashkëpunim me aleatët, të ndajë me ta barrën e veprimeve ushtarake, pasi lidhshimi i vërtetë kërkon që edhe kombet e tjera ta kenë gjithashtu mundësinë e ndarjes së përgjegjësisë ndërkombëtare dhe ky është lidhshimi që SHBA po demonstroi në Libi.¹²

“Pranvera arabe”- qasje rast pas rasti

Presidenti Barak Obama e konsideron qasjen ndaj krizës në Libi si qasje ndaj “këtij vendi specifik, Libisë, në këtë moment specifik” dhe shmanget nga deklaratat e bujshme për rolin e Amerikës në botë apo parimet e mëdha që udhëheqin vendimet për përdorimin e forcës ose reagimin e SHBA-së ndaj “pranverës arabe”. Për ata që përsiasin në lidhje me mundësinë e dislokimit të forcave amerikane në Siri, Jemen, Arabi Saudite apo madje edhe në Iran, sipas Obamës, kjo nuk mund të ndodhë thjesht duke zbatuar rastin e Libisë pasi SHBA nuk kërkon ndryshimin e regjimeve në të gjithë botën, kudo ku ka regjime shtypëse, nuk mbështet ndërhyrjen unilaterale, ndërsa Libia përbën një rast të ngjashëm me Ruandën dhe Bosnjën, vende në të cilat është ndërhyrë me vonësë për të shmangur gjakderdhje, masakra dhe varre masive. Por Libia nuk është për SHBA-në modeli i zbatueshëm kudo. SHBA reagon në varësi të kërcënimeve.

Obama është i përkushtuar ndaj të drejtave të njeriut por në mishërimin në realitet të këtyre parimeve ai është pragmatist. Ai e di se ajo që mund të bëhet në Egjipt nuk është e njëjtë me atë që mund të bëhet në Libi dhe ajo që mund të bëhet në Libi nuk është e njëjtë me atë që mund të bëhet në Bahrain. Obama është mësuar me faktin që ai ka kundërshtuar me forcë ndërhyrjen amerikane në Irak, ka marrë Çmimin Nobël për Paqe dhe ka mbështetur përdorimin e forcës në Libi. Ai është mësuar me këtë kundërshti, të qenit komandant i përgjithshëm i një superfuqie ushtarake dhe të aspiruarit e paqes në botë.

Përfundime

Presidenti Obama hoqi dorë nga unilateralizmi i Bushit, doktrina e luftës parandaluese që i jepte të drejtën të hynte në luftë me çdo shtet të botës që mendohej se kërcënon SHBA-në, pa

përfillur institucionet ndërkombëtare dhe të drejtën ndërkombëtare, duke ndjekur një politikë multilaterale që respekton institucionet ndërkombëtare, NATO, OKB, etj.

“Doktrina Obama” ndryshoi vizionin strategjik të rolit të Amerikës në botë, rol me anë të të cilit ai ndikoi në ndryshimin e marrëdhënieve mes kombeve si President i SHBA-së. Ndryshimet më të mëdha mes SSK 2002 (duke përfshirë SSK 2006, e cila është e ngjashme me SSK 2002 në shumë aspekte) dhe SSK 2010 në disa çështje shumë të rëndësishme janë:

SSK 2002

- Fokusim tek “Hard Power”. Rriten shpenzimet në mbështetje të një SHBA-je me fuqi të pakrahueshme ushtarake e cila përdoret në sulme parandaluese (preventive) dhe luftëra paraprake (pre-emptive) ndaj shteteve që paraqesin rrezik për sigurinë kombëtare, rasti i Irakut (2003).
- SHBA mban qëndrim të njëanshëm (unilateral) në skenën ndërkombëtare. Nuk merren përsipër detyrimet që rrjedhin nga nënshkrimi i traktateve ndër-kombëtare si “Traktati i Koyoto-s”, “Traktati i Minave Tokësore të Otavas”, anëtarësimi në Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve etj. SHBA, në mbrojtje të interesave të saj mund të ndërhyjë ushtarakisht pa miratimin e Këshillit të Sigurisë në OKB.
- Prioritizim i kërcënimeve të jashtme, kërcënimeve të mëdha të sigurisë në për-gjithësi dhe i rrezikut të vënies në zotërim prej terroristëve të armëve të shkatërrimit në masë në veçanti. SHBA mbështet përhapjen e demokracisë dhe lirisë në të gjithë botën.
- Vizion i ngushtë i përdorimit të instrumenteve të sigurisë kombëtare; përdorim i arsenalit të fuqisë ushtarake për një mbrojtje më të mirë të vendit, përdorim energjik i institucioneve të shërbimeve inteligjente dhe atyre të zbatimit të ligjit për të ndërprerë financimin e terroristëve.

SSK 2010

- Fokusim tek “Soft Power”. SHBA ndjek politikën e tre D-ve; Diplomacia, Mbrojtja, Zhvillimi (Diplomacy-Defense-Development). Forcat e Armatosura mbështeten fuqimisht nga diplomacia dhe mbështetja e zhvillimit ekonomik të vendeve të tjera. Siguria amerikane varet prej diplomatëve të cilët mund të veprojnë në çdo cep të botës, që nga kryeqytetet e mëdha deri tek vendet e rrezikshme; ekspertët e zhvillimit mund të forcojnë qeverisjen e këtyre vendeve dhe të mbështesin zhvillimin ekonomik dhe forcimin e demokracisë së tyre.
- SHBA pranon nevojën për të pranuar bashkëpunim ndërkombëtar, angazhohet për partneritet dhe sistem ndërkombëtar që respekton rregullat;
- U kushtohet më shumë vëmendje komponentëve të brendshëm të sigurisë dhe një vizioni më të gjerë të sigurisë kombëtare i cili përfshin edhe sfida të politikës së brendshme (p.sh. mjedisi, teknologjia dhe zhvillimi);
- Liderhipi i hiperfuqisë amerikane në botë nuk konsiderohet gjithmonë si i mirë-qenë (rasti i Libisë dhe nivelit të ndryshëm të përfshirjes së SHBA-së në trazirat e vendeve të Lindjes së Mesme), por mbështetet në bërjen e zgjedhjeve të zgjuara të një fuqie të zgjuar (smart power), zgjedhje të paramenduara se si, kur dhe me kë duhet të udhëhiqet në skenën ndërkombëtare.

Kontrasti mes Presidentit Obama që e konsideron Amerikën si një komb mes kombeve të tjera dhe përkufizimeve të mëparshme të paraardhësve të tij që e konsideronin “një komb i domosdoshëm”, si komb që “iu shërben objektivave që shkojnë përtej kombit amerikan” dhe kanë të bëjnë me misionin dhe rolin e tij në botë është e dallueshme. Në të vërtetë, është e vështirë të imagjinohet një përkufizim kaq i kufizuar i strategjisë madhore amerikane, i

shpallur prej ndonjë presidenti që prej kohës së administratës së Franklin Ruzveltit (Franklin Roosvelt). Megjithatë, ky përkufizim nuk largohet plotësisht nga tradita historike e politikës së jashtme amerikane dhe rolit të SHBA-së si superfuqi, gjë që analistët e marrëdhënieve ndërkombëtare e vunë në pah me përshkrimin e politikës së jashtme të Barak Obamës si politikë e jashtme e Xhorxh W. Obamës, çka do të thotë një shartesë e realizmit të politikës së jashtme të presidentit republikan amerikan Xhorxh Herbert Uoker Bushit (George Herbert Walker Bush) i cili ishte president në vitet 1989-1993, me idealizmin uillsonian të presidentëve paraardhës demokrat.

Kapitulli i parë i SSK 2010 bën një përshkrim të “botës siç është” dhe pastaj artikulon botën që SHBA kërkon. Ky fenomen është specifikisht i lidhur me SHBA-në e cila historikisht ka luftuar ndërmjet dy vizioneve shumë të ndryshme përsa i përket rolit të saj në botë: vizionit të një lidheshipi aktiv, global si një model ndriçues dhe një vizioni më izolacionist që mbështet shmangien e përfshirjes në çështjet jashtë vendit. Artur Shlesinger (Arthur Schlesinger) e quajti këtë fenomen pjesë të “cikleve të historisë amerikane,” në të cilat politika e jashtme luhet mes tërheqjes dhe kthimit në skenën botërore.

Bibliografia:

- Barack Obama “Renewing American Leadership”, Foreign Affairs, July/August 2007. <http://www.foreignaffairs.com/articles/62636/barack-obama/renewing-american-leadership>
- National Security Strategy of United States of America, May, 2010.
- http://www.defense.gov/qdr/images/QDR_as_of_12Feb10_1000.pdf
- <http://www.guardian.co.uk/world/2008/jul/16/uselections2008.barackobama>
- http://www.economist.com/blogs/lexington/2011/03/libya_4
- Aaron Blake and Chris Cillizza, The Obama doctrine, 03/29/2011
- Havier Solana, Një strategji sigurie për shekullin njëzet e një, 18 qershor 2010. <http://www.koha.net/index.php?cid=1,12,25395>
- http://www.barackobama.com/2007/04/23/the_american_moment_remarks_to.php/
- Foreign Policy, shkrimi me intervista “George H.W.Obama?”, April 14, 2010. http://www.foreignpolicy.com/articles/2010/04/14/george_hw_obama?page=0,0
- George Friedman, Elections and Obama’s Foreign Policy Choices.
- <http://www.guardian.co.uk/world/2008/jul/16/uselections2008.barackobama>
- Granit Zela, Politika e jashtme amerikane pas Luftës së Ftohtë: 1999-2009, Shtëpia Botuese Emal 2011.
- Strategic Leadership: Framework for a 21st Century National Security Strategy, July 2008.
- <http://news.discovery.com/history/bin-laden-911-obama-speech-05022011.html>

Referenca

¹ Barack Obama “Renewing American Leadership”. Foreign Affairs, July/August 2007.

<http://www.foreignaffairs.com/articles/62636/barack-obama/renewing-american-leadership>

² <http://www.guardian.co.uk/world/2008/jul/16/uselections2008.barackobama>

³ Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Shteteve të Bashkuara, f. 42, Maj 2010.

⁴ Granit Zela, Politika e jashtme amerikane pas Luftës së Ftohtë: 1999-2009, Shtëpia Botuese “Emal” 2011.

⁵ Quadrennial Defense Review 2010. http://www.defense.gov/qdr/images/QDR_as_of_12Feb10_1000.pdf

⁶ <http://news.discovery.com/history/bin-laden-911-obama-speech-05022011.html>

⁷ Barack Obama "Renewing American Leadership". Foreign Affairs, July/August 2007.

⁸ Linjat e përgjithshme të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare amerikane, tërhequr më 31 Maj 2010.

⁹ Javier Solana, Një strategji sigurie për shekullin e 21-të, publikuar më 18 qershor 2010. <http://www.koha.net/index.php?cid=1,12,25395>

¹⁰ Quadrennial Defense Review 2010. http://www.defense.gov/qdr/images/QDR_as_of_12Feb10_1000.pdf

¹¹ http://www.economist.com/blogs/lexington/2011/03/libya_4

¹² Aaron Blake and Chris Cillizza, The Obama doctrine, 03/29/2011.

Emigracioni ilegal, krimi i organizuar & terrorizmi

Nën/Komisar Renaldo Ndoni,
Specialist në Qendrën e Mbyllur për të Huaj

Abstrakt. Në këtë shkrim do të trajtohet fenomeni i emigracionit të paligjshëm, si dukuri shoqërore dhe problem shqetësues për të gjithë vendet e rajonit, si dhe lidhja e tij me krimin e organizuar, trafikimin e qenieve njerëzore dhe terrorizmin. Krimi i organizuar çdo ditë dhe më shumë po rrezikon shoqërinë ndërsa terrorizmi po vë në rrezik funksionimin normal të shteteve të ndryshme. Mendimet të cilat i kam shprehur në lidhje me problemet që vijnë si pasojë e emigracionit ilegal në Shqipëri, për mungesë literature i kam nxjerrë nga përvoja ime profesionale, nga intervistat e të huajve të ndaluar në Qendrën e Mbyllur.

Shqipëria, një urë lidhëse midis lindjes dhe perëndimit, pozita gjeografike e favorshme për t'u përdorur si vend tranzit nga emigrantët e parregullt pritet që të sjellë probleme në sigurinë e brendshme. Parandalimi i pasojave të cilat vijnë nga emigracioni i parregullt arrihen duke rritur nivelin e bashkëpunimit midis të gjithë sektorëve të policisë, në rang kombëtar dhe ndërkombëtar.

Emigracioni

Në ditët e sotme, kur shoqëria në mbarë botën është në proceset e globalizmit, emigracioni i parregullt paraqitet si një fenomen i përhapur dhe shqetësues për shumë vende që kanë nivel ekonomik të lartë. Nivelet ekonomike jo të barabarta, në vende të ndryshme, kanë bërë që njerëzit të lëvizin nga vendet e varfra drejt vendeve më të zhvilluara, për të gjetur një jetesë më të mirë.

Emigracioni mund të paraqitet në dy forma: legal ose ilegal. Emigracioni është akti i lënies ose i daljes së njerëzve nga një shtet për t'u vendosur në një shtet tjetër. Këtu nënkuptohet vendi i tij ose një vend tjetër ku shtetasi i huaj ka shkuar për të kaluar tranzit brenda rregullave të përcaktuara nga ai vend.

Në vendet demokratike emigracioni legal është i lejuar dhe për mbarëvajtjen e tij hartohen plane dhe strategji. Në të kundërt, në vendet në të cilët konceptet demokratike janë zhdukur dhe mbizotëron diktatura, emigracioni legal dhe ilegal janë të ndaluar dhe përbëjnë vepër penale. Sanksionet janë të ndryshme në varësi të legjislacionit të vendeve përkatëse.

Konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, emigracionin legal e përcaktojnë si të drejtë themelore, në të cilën është përcaktuar qartë që njerëzit duhet të jenë të lirë të largohen nga një shtet për të shkuar dhe jetuar në një shtet tjetër. Njerëzve, në kushte të veçanta, mund t'i kufizohet e drejta për t'u larguar nga vendi i tyre ose nga një vend tjetër kur ligji në fuqi e përcakton këtë. Kategori personash të një shtetësie të caktuar, mund t'u kufizohet e drejta për tu larguar nga vendi i tyre ose nga një vend tjetër, kur në vendin e destinacionit aplikohet vizë dhe këta persona nuk janë të pajisur me një të tillë. Në pikat e kalimit kufitar personat që janë nën moshën 18 vjeç nuk u lejohet dalja të pashoqëruar nga prindërit ose pa prokurë të lëshuar nga ata për të autorizuar një person tjetër për kujdestarinë e personit minoren¹.

Emigracioni i parregullt

Politikat në lidhje me migracionit që ndjekin vendet e zhvilluara si dhe kuotat për pranim e punësim të emigrantëve të rregullt, janë shumë herë më të vogla se numri i emigrantëve që kërkojnë të përcjellin vendet e pazhvilluara.

Në rastet kur priset raporti midis kërkesës për pranim dhe ofertës për të dërguar emigrant legal, lind fenomeni i emigracionit të parregullt bashkë me ndikimet negative në sigurinë e brendshme të një vendi.

Emigrant i parregullt është çdo shtetas i huaj që ndalohet përgjatë vijës kufitare ose në brendësi të territorit të një vendi tjetër, pa dokumentacionin e nevojshëm për të hyrë ose për të qëndruar në atë vend. Kur vende të ndryshme ndodhen në gjendje të jashtëzakonshme, flukset e emigrantëve të parregullt tregojnë tendencë në rritje. Konkretisht kur ndodhin fatkeqësi natyrore, luftëra, trazira të brendshme e në periudha tranzicioni, fenomeni i emigracionit të paligjshëm që vjen për arsye ekonomike dhe të sigurisë së jetës, shfaqet në përmasa të jashtëzakonshme.

Kategoritë e emigrantëve ilegalë

Emigrantët e parregullt ndahen në kategori të veçanta sipas qëllimit që kanë kur ndalohen nga policia në territorin e një vendi tjetër, si:

- Personat që kanë për qëllim kalimin tranzit për të shkuar në një shtet tjetër;
- Personat që kanë synim të jetojnë dhe të punojnë përkohësisht në atë vend;
- Shtetas të huaj që kanë hyrë të rregullt dhe vazhdojnë të qëndrojnë pasi i ka mbaruar afati i vizës ose i lejes së qëndrimit;
- Azilkërkuar që iu është refuzuar kërkesa për azil;
- Emigrantë klandestin që kanë përdorur territorin e një vendi për të shkuar në një vend tjetër (ata pranohen në bazë të kërkesës për ripranim);
- Kategori personash që pas kryerjes së një veprë penale i hiqet e drejta e qëndrimit me vendim të gjykatës.

Gjithmonë e më shumë mënyrat e kalimit të kufirit nga ana e emigrantëve të parregullt po bëhen më të ndërlikuara². Ndër metodat më të përdorura nga emigrantët klandestin

për të kaluar kufirin që të hyjnë në territorin e një vendi tjetër janë:

- 1) Kalimi në pikat e kalimit kufitar të fshehur në mjetet e transportit, si:
 - Kalim në pikat e kalimit kufitar tokësor të fshehur në mjetet e transportit rrugor autobusë, trena, kamionë, autovetura, etj.;
 - Kalim në pikat e kalimit kufitar ujor të fshehur në anije ose në mjete të transportit rrugor që gjenden në to;
 - Kalim në pikat e kalimit kufitar ajror të fshehur në pakot e avionëve kargo.
- 2) Kalimi në të gjitha llojet e pikat e kalimit kufitar duke përdorur dokumente false ose identitet të një personi tjetër.
- 3) Kalim përgjatë vijës së kufirit blu duke përdorur mjete të ndryshme lundruese.
- 4) Kalim përgjatë vijës së kufirit të gjelbër.

Emigracioni i parregullt dhe lidhja me krimin

Rrugët që po ndjekin emigrantët ilegal nuk janë të rastësishme. Çdo ditë e më shumë metodat dhe taktikat që ndiqen bëhen më përsosura në përshtatje edhe me ndikimin e kohës në të cilën jetojmë. Krimi si fenomen shqetësues për shoqërinë e sotme ka dalë nga kornizat e të qenurit kombëtar dhe ka marrë përmasa me shtrirje globale.

Organizata dhe grupe të ndryshme të krimit po bashkëpunojnë në nivel ndërkombëtar për të rritur përfitimet në rrugë të jashtëligjshme. Në kohën tonë emigracioni klandestin po kontrollohet nga organizatat e krimit të organizuar dhe po përdoret nga organizatat terroriste për të konkretizuar qëllimet e tyre.

Filozofia mbi të cilën janë formuar organizatat e krimit të organizuar kanë në plan të parë fitimin e parave me anë të aktiviteteve të kundërligjshme. Funksionimi, organizimi dhe qëllimi i organizatave të krimit të organizuar ngrihen në bazë të aktivitetit të paligjshëm për të përfituar vlera monetare pa pasur si objektiv të shkatërrojë shtetin por të ekzistojë dhe të funksionojë brenda tij.

Organizatat terroriste për nga organizimi dhe funksionimi janë të njëjta me organizatat e krimit të organizuar por subjekti i tyre është i ndryshëm. Qëllimi i organizatave terroriste është të destabilizojnë funksionimin e shtetit, të cenojnë rendin kushtetues, të krijojnë anarki që të realizojnë qëllimet e tyre fetare, etnike ose politike në përputhje me bazën e ideologjisë me të cilën është formuar kjo organizatë.

Aktiviteti i organizatave të krimit të organizuar përbën vepër penale kundër shoqërisë, kurse aktiviteti i organizatave terroriste përbën vepër penale kundër shtetit. Organizatat terroriste janë formuar mbi ideologjinë për të cilën ato punojnë që të realizojnë objektivat e tyre politike, fetare ose etnike. Të dyja organizatat e sipërpërmendura janë të lidhura ngushtësisht me emigracionin e paligjshëm sepse nëpërmjet tij realizojnë objektivat e tyre.

Krimi i organizuar kontrollon emigracionin klandestin, ku me anën e kontrabandimit të nxirren përfitime monetare nga shumat që paguajnë emigrantët ilegal për transportin që iu mundësohet për arritjen e tyre në destinacionin përkatës³.

Kontrabandimi është transporti ilegal i një personi me dëshirën e tij nga një shtet në një shtet tjetër kundrejt një shume të caktuar parash. Veprimtaria e emigracionit të paligjshëm në vetvete përfshin edhe trafikimin e qenieve njerëzore e cila është një nga arteriet kryesore që furnizon krimin e organizuar me lëndë të parë.

Trafikimi i qenieve njerëzore që kryhet nëpërmjet emigracionit të parregullt, pasuron tregun e prostitucionit me element që merren nga vende të varfra me anë të mashtrimit, forcës ose metodave të tjera shtrënguese që të prostitutojnë në vende të pasura ku fitimet janë më të mëdha. Emigracioni i parregullt duke pasur si pjesë përbërëse të tij trafikimin e qenieve njerëzore, sjell kontingjente njerëzish që shfrytëzohen nga krimi i organizuar për tregtinë dhe transplantimin e organeve, i cili përbën një burim të ardhurash kolosale⁴.

Organizatat e krimit të organizuar pasurohen me elementë të rinj, nëpërmjet emigracionit të parregullt, të cilët përdoren si rekrut, për të kryer shërbime të rëndomta që bartin rrezik. Elemente të dekonspiruar të krimit të organizuar ose të dënuar në mungesë, emigracioni i parregullt iu mundëson largimin nga vendi dhe fshehjen nga organet e drejtësisë.

Krimi i organizuar nuk mund të nënkuptohet dot pa emigracionin e paligjshëm, i cili ka rol të pazëvendësueshëm për mbarëvajtjen dhe funksionimin e organizatës. Organizatat terroriste po përdorin organizatat e krimit të organizuar si mjet për të fituar para, të cilat i përdorin për vetëfinancim.

Terrorizmi, si problem shqetësues për mbarë botën, tashmë po trajtohet në një spektër global, duke nxitur bashkëpunim ndërkombëtar me shërbimet informative dhe forcat e sigurisë. Shtetet që investojnë në fushën e sigurisë, të vlerësuara si vende elitë, nuk lenë hapësira që organizatat terroriste të përgatisin elementë brenda vendit. Emigracioni ilegal përdoret si mjet për të dërguar elementë, që të përgatiten në shtete të tjera dhe më pas të përdoren për sulme

terroriste. Ashtu, si tek krimi i organizuar, emigracioni ilegal mundëson furnizimin e organizatës terroriste me elementë të rinj dhe fsheh në vende të ndryshme elementë të dekonspiruar që janë në kërkim ndërkombëtar⁵.

Shqipëria dhe emigracioni i parregullt

Duke ju referuar pozitës gjeografike, Shqipëria ka qenë dhe është urë lidhëse midis Europës perëndimore dhe asaj lindore, kalimi legalisht i njerëzve dhe mallrave, pagimi taksave, shpenzimi i vlerave monetare gjatë kalimit në territor, ka efekte pozitive në rritjen ekonomike të vendit. Nga ana tjetër, kalimi i mallrave dhe i njerëzve në rrugë jo ligjore sjellë pasoja në sigurinë e brendshme të vendit.

Gjatë periudhës së tranzicionit nga vitet 90' afërsisht deri në vitet 2000' Shqipëria është përdorur si vend trampolinë nga vendet e bllokut të lindjes për të dërguar emigrantë ilegal për në Europën perëndimore, si dhe për t'u përdorur si vend tranzit për trafiket ndërkombëtare. Në këtë periudhë në të cilën lulëzonte emigracioni klandestin nga vendet e lindjes, kryesisht nga vendet e ish Bashkimit Sovjetik, Shqipëria ishte pjesë e tranzitit të trafikut të qenieve njerëzore.

Nga këto vende trafikoheshin vajza të cilat bliheshin nga grupe të krimit të organizuar shqiptar dhe dërgoheshin në perëndim për tu përdorur në tregun e mishit të bardhë. Pasi vendet e lindjes dhe Shqipëria kaluan periudhën e tranzicionit, u ndërmorën masa serioze për luftën kundër trafikeve të paligjshme.

Shqipëria vendosi memorandumën për skafet, trajnoi personelin që do të luftonte këtë fenomen, për të njohur trafikun e qenieve njerëzore si vepër penale e cila nuk njihej para viteve 90', ngriti njësinë e specializuar brenda strukturës së Policisë Kufitare dhe Migracionit për luftën kundër trafikut *Delta Forcë*, shtoi bashkëpunimin me njësinë e specializuar italiane *Guardia di Finanza*.

Aktualisht, në lidhje me emigracionin e paligjshëm dhe trafikun e qenieve njerëzore, që kishte origjinën nga vendet e lindjes, Shqipëria ka arritur ta minimizojë në nivele të pranueshme. Pas trazirave që po kalojnë vendet e Lindjes së Mesme si dhe krizës ekonomike botërore e liberalizimit të vizave, në Shqipëri, emigracioni klandestin ka marrë tjetër drejtim. Emigrantët e parregullt nga vendet e Lindjes së Mesme, kryesisht nga Afganistani, Iraku, Siria, Tunizia, Palestina, Maroku, Libia kanë tendencë në rritje për të kaluar tranzit nga Shqipëria drejt perëndimit.

Krimi i organizuar në kushtet e krizës ekonomike globale po shfrytëzon dy mundësi për të nxjerrë përfitime nga emigrantët klandestinë. Mundësia e parë është mos aplikimi i vizave midis Turqisë dhe një pjese të mirë të vendeve të Lindjes së Mesme. Kontingjentet e emigrantëve ilegalë vijnë të rregullt nga vendet e tyre deri në Turqi, më pas atyre iu merren pasaportat nga udhërrëfyesit dhe kalohen ilegalisht përgjatë kufirit blu ose të gjelbër Turqi-Greqi kundrejt shumës 1000-1500 euro.

Mundësia e dytë janë marrëdhëniet diplomatike dhe politike jo të mira midis Greqisë dhe Turqisë, që kanë bërë mos firmosjen e marrëveshjes së ripranimit midis këtyre dy shteteve, grupet e krimit të organizuar kanë siguri për të mos iu kthyer mbrapsht emigrantët nga territori i Bashkimit Europian. Pjesa më e madhe e emigrantëve ilegal nga Lindja e Mesme që gjenden në Greqi të ardhur tranzit nga Turqia, në pamundësi kalimi në Itali, shohin si mundësi tranziti Shqipërinë.

Në kontingjentet e emigrantëve klandestinë me origjinë nga Lindja e Mesme nuk përjashtohet mundësia që të ketë elementë të organizatave terroriste me ideologji fetare, të cilët kanë qenë

aktiv në vendet e tyre. Shumë prej emigrantëve të parregullt nga vendet e Lindjes së Mesme që ndalohen nga policia shqiptare, gjatë intervistimit deklarojnë se janë të peregjistruar në vendet e tyre dhe kërkojnë shtetësi. Kërkesat për azil në Shqipëri vijnë në rritje sepse emigrantët e parregullt mendojnë strategji afatgjatë. Duke parashikuar se Shqipëria në një të ardhme jo të largët do të jetë vend me të drejta të plota në Europën e Bashkuar dhe nëse këta azilkërkues fitojnë të drejtën e azilit, më mbas të nënshtetësisë, rrjedhimisht ata do të përfitonin të drejtat të njëjta si shtetas të Bashkimit Europian.

Qëndrimi i parregullt ose legalizimi i emigrantëve që vijnë nga Lindja e Mesme, paraqet rrezik potencial për Shqipërinë sepse shumica dërrmuese e popullsisë është e besimit mysliman, feja për vite me radhë ka qenë e ndaluar dhe shoqëria shqiptare aktualisht nuk ka orientim të caktuar në aspektin e besimit. Duke shfrytëzuar, besimin mysliman të shumicës së popullsisë tonë, nivelin ekonomik jo të mirë, emigrantët e parregullt me origjinë nga Lindja e Mesme mund të formojnë organizata terroriste me ideologji fetare si në vendet e tyre me element shqiptar.

Lufta për të parandaluar emigracionin ilegal dhe pasojat që vijnë prej tij, mundësohet nëpërmjet bashkëpunimit ndërpolicor me vendet e rajonit dhe më gjerë, për të mundësuar parandalimin që në vendin e origjinës së kondrbandimit, për të vënë përpara organeve të drejtësisë personat që e drejtojnë atë, si dhe për identifikimin dhe ndalimin e emigrantëve të parregullt përgjatë rrugës derisa ata të mbërrijnë në vendin e destinacionit.

Rol të domosdoshëm në parandalimin e emigracionit të parregullt ka trajnimi i personelit të Policisë Kufitare dhe Migracionit me bazën ligjore, përgatitja për të kryer punë operacionale përgjatë vijës kufitare dhe pajisja me bazën materialo-teknike.

Bibliografia:

- Bülent Çiçekli, *Yabancılar ve Polis*, (Seçkin Yayınları, Ankara 2003).
- Manual për Rojet e Policisë Kufitare dhe Migracionit mbi atributet e policisë gjyqësore në përzgjedhjen e të Huajve të Parregullt. (Botimi i dytë 2006).
- Aytekin Geleri & Hasan Hüseyin Çevik, Editorleri. *Organize Suçlar Mücadele ve Polis* (Seçkin Yayınları, Ankara 2003).
- Adil Serdar Saçan, *Ak Babalar Orgütü*. (Birharf Yayınları, İstanbul 2001).
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë. Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, (Ribotim 2004).

Referenca

¹ Bülent Çiçekli, *Yabancılar ve Polis*, (Seçkin Yayınları, Ankara 2003), f.113.

² Manual për Rojet e policisë Kufitare dhe Migracionit mbi atributet e policisë gjyqësore në përzgjedhjen e të Huajve të Parregullt. (Botimi i dytë 2006). f. 99

³Aytekin Geleri & Hasan Hüseyin Çevik, Editorleri. *Organize Suçlar Mücadele ve Polis*. (Seçkin Yayınları, Ankara 2003). f.25

⁴ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë. Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare (Ribotim 2004). f.63

⁵ Adil Serdar Saçan, *Ak Babalar Orgütü*. (Birharf Yayınları,Ankara 2001) f.139

RUBRIKA E KATËRT

STUDIME HISTORIKE

Në këtë rubrikë të kësaj reviste do të gjeni edhe çështje që trajtojnë aspekte historike që kanë të bëjnë me sigurinë dhe mbrojtjen.

Autorët sjellin fakte që kërkojnë të bëjnë paralele në histori dhe përsiatje lidhur me tipare e cilësi të historisë dhe popujve të Ballkanit.

Revista Ushtarake ka mirëpritur e mirëpret shkrime që i përkasin fushës së historisë, me vlera për historinë e sotme e të nesërme, në mënyrë që këto vlera t'i shërbejnë brezit të ardhshëm për dije të mëtejshme.

Beteja e Fushë-Kosovës e vitit 1389 dhe arti i saj ushtarak

Nënkolonel (R) Kadri Dauti

Abstrakt. *Beteja e Fushë-Kosovës, e vitit 1389, mes ushtrive të koalicionit ballkanik dhe asaj osmane zë një vend të rëndësishëm në historinë e Ballkanit. Ajo përbën një ndër betejat më të diskutueshme për rolin dhe vendin që zunë e që luajtën ushtritë e koalicionit ballkanik në të.*

Autorë ballkanikë i kanë kushtuar vëmendje aspektit historik dhe eposit të kësaj beteje. Në trajtesat e tyre vihen re jo vetëm njëanshmëria por te disa edhe subjektivizmi. Në kohën e sotme, kur popujt e Ballkanit janë përfshirë në një proces bashkëpunimi dhe integrimi në Evropën e qytetëruar, kjo betejë duhet të shërbejë si një bazë e vjetër e bashkimit të tyre, nën interesa të përbashkëta.

Ky punim synon të japë një trajtim të plotë dhe të analizojë artin ushtarak të përdorur në këtë betejë nga dy ushtritë më të fuqishme dhe moderne të kohës. Trajtesa e fokuson vëmendjen në strategjinë dhe taktikat që u zbatuan nga palët ndërluftuese dhe ndikimin e tyre në rezultatin e betejës. Autori gjykon se një trajtim i tillë objektiv i gjithë spektrit ushtarak të betejës do t'i shërbente jo vetëm ushtarakëve, por do të mundësonte rritjen e respektit për kontributin e secilit vend Ballkanik për lirinë e popujve të tij. Mbi përvojën e kësaj beteje, vendet e Ballkanit do duhet të rrisin përpjekjet e përbashkëta për ndërtimin e strategjive më të efektshme në konsolidimin e sigurisë dhe për një zhvillim politik të qëndrueshëm dhe të ardhme Euro-Atlantike të rajonit.

Si një nga betejat me eposin më të diskutuar në historinë Ballkanike, beteja e Fushë-Kosovës (serbisht: *Éîñîãñèà áèðèà*, Kosovska bitka; dhe turqisht: *Kosova Meydan Savayı*) e 28 qershorit të vitit 1389 (15 qershor sipas kalendarit julian) ka edhe vlerat e saj ushtarake. Ajo, si beteja legjendare e shumë betejave historikisht të zhvilluara në këtë fushë, mbart tiparet themelore të artit ushtarak të popujve ballkanas, por njëkohësisht dhe të artit ushtarak të Perandorisë Osmane të kohës.

Situata ballkanike në prag të betejës

Duke shfrytëzuar situatën e rëndë administrative, ekonomike dhe ushtarake që po përjetonte Perandoria Bizantine në shek. e XIV-të, ku ekzistenca e saj tashmë ishte vënë në pikëpyetje, si dhe gjendjen konfliktuale të brendshme në trojet ballkanike, Perandoria Osmane, që ishte në një fazë fuqizimi, kërkonte të shtrihej më në perëndim të saj. Shpërbërja e shtetit Mongol, të cilit osmanët ia kishin njohur suzerenitetin, dhe marrja e Ankarasë më 1354 iu dha mundësi osmanëve të përqendronin forcat për pushtimin e Ballkanit¹.

Realizimit të këtij synimi i shërbeu fushata e gjysmës së dytë të shek. të XIV-të për pushtimin e territoreve të brendshme të Gadishullit të Ballkanit, duke zhvilluar një sërë betejash në këto territore. Dalja e osmanëve në brigjet e Dardaneleve dhe pushtimi i Adrianopolit e shpallja e tij kryeqytet me emrin Ederne, në 1361, krijuan kushtet për të ndërtuar një strategji dhe për të organizuar një fushatë të posaçme për pushtimin e territoreve të Ballkanit. Beteja që hapi siparin e kësaj fushate ishte beteja pranë lumit e Marica e vitit 1371, në zonën e sotme kufitare turko-greke, në të cilën ushtria e sundimtarëve sllavë, vëllezërve serbë *Vukašin dhe Uglësja Mrnjavëviç*, në krahë të të cilëve qe edhe Aleksandri i Vlorës,² pësoi një humbje të rëndë me ushtrinë osmane të Sulltan *Murat I*. Fitorja në këtë betejë iu hapi rrugën turqve për në drejtim të Bullgarisë dhe Maqedonisë.

Fushata turke në Ballkan mori hov të ri pas vitit 1380. Grumbullimi i trupave elitë të jeniçerëve (trupat e reja këmbësore osmane të përbëra nga djem të familjeve kristiane apo të kapur rob, të krijuar si ushtri e përhershme rreth vitit 1330) i shërbente posaçërisht këtij qëllimi. Rreziku nga pushtimi turk i Ballkanit erdhi duke u rritur, gjë që tronditi elitën

politike drejtuese ballkanase dhe natyrisht edhe atë shqiptare. Në betejën e 1381 në *Paraëin* doli fitimtare ushtria e Llazar Hrebljanoviçit.

Sundimtarët shqiptarë organizuan qëndresën ndaj rrezikut osman dhe u ndeshën në betejën e Savrës e vitit 1385 me osmanët, betejë që përfundoi me humbjen e ushtrisë arbërore. Në fushatën e tyre ballkanike, ushtritë osmane të kryesuar nga Sulltan Murati I, më 1386, depërtuan në Serbi, duke pushtuar Nishin. Më pas, në Ploçnik, Murati u ndodh përpara sundimtarit të Serbisë. Llazari nuk guxoi të përballej në një betejë të hapur me Sulltanin, por i premtoi Muratit dhënien e një tributi si dhe të një trupe ndihmëse ushtarake prej 1.000 vetësh, mirëpo shumë shpejt hoqi dorë nga premtimi i dhënë. Në betejën e 1387 në Hercegovinë përsëri doli fitimtare ushtria e Llazarit. Në verën e vitit 1388, forcat osmane që kishin depërtuar në Bosnjë, nën komandën e L'alla Shahinit, u thyen rëndë nga forcat aleate të Tvërtkos, Gjergjit II Balshës dhe Llazarit në Bileqe të Bosnjës, duke lënë të vrarë më se 15.000 vetë.

Grupimet e rëndësishme që u krijuan nga sundimtarët feudalë, me përfaqësues më konsekuentë Balshët në veri dhe Shpatajt në jug, të detyruar nga nevoja objektive, nuk ishin në gjendje të përballonin rrezikun osman për trevat shqiptare. Beteja e Savrës më 18 shtator 1385 dëshmoi përfundimisht se e vetmja rrugë për të mbrojtur trevat shqiptare nga osmanët ishte bashkimi me fqinjët kundër një armiku të përbashkët. Në të njëjtin konkluzion kishin arritur edhe mbretërit e fisnikët serbë, boshnjakë, bullgarë e rumunë, të cilët i fashitën mosmarrëveshjet dhe grindjet ndërmjet tyre dhe krijuan në vitin 1387 një koalicion antiosman. Në të bënë pjesë personalitete të shquara shqiptare si Gjergji II Balsh-sundimtar i Shkodrës, Teodor II Muzaka-zot i Beratit dhe Myzeqesë, Dhimitër Jonima-zot i trevave përgjatë rrugës tregtare Lezhë-Prizren, Andrea Gropa-zot i Ohrit dhe i rajoneve rreth tij, Gjergj Kastrioti, sundimtarë të Shqipërisë së Poshtme etj.³

Qëllimi i luftës

Krijimi i koalicionit antiosman në Ballkan i shqetësoi pa masë osmanët për shkak të fuqisë së tij. Prandaj osmanët u detyruan të ndërmarrin një fushatë luftarake të gjerë në Ballkan, nën drejtimin e vetë Sulltan Muratit I.

Mospërmbushja e detyrimeve nga ana e Llazarit, disfata në Bileqe të Bosnjës dhe roli vendimtar i Gjergjit II Balshës në atë disfatë, bënë të “domosdoshme dhe detyrë ndaj vullnetit perandorak përgatitjen për të vënë në vend nderin e ushtarëve të vrarë dhe likuidimin e intrigave dhe ngatërresave të kokëfortëve” siç thotë kronisti osman Idris Bitlisi. Pra, në Fushë-Kosovë, në vitin 1389, duhet të përcaktohej nëse osmanët do të mundësonin zgjerimin e ndikimit të tyre mbi tokat ballkanike duke thyer sundimtarët ballkanikë. Këtu luhej fati i Perandorisë më të fuqishme të kohës, luhej fati i Ballkanit. Një asgjësim i fuqive ushtarake të principatave shqiptare dhe serbe do t'i hapte rrugën Perandorisë Osmane për të depërtuar drejt Evropës.

Përgatitjet për luftë

Beteja midis këtyre dy koalicioneve ishte e një rëndësie tepër të veçantë, prandaj dhe përgatitjeve të dy ushtrive iu kushtua gjithë vëmendja e duhur. Prandaj të dy koalicionet

ushtarake ishin përgatitur seriozisht për luftime, pasi secili kërkonte fitoren e shumëdëshiruar të betejës.

Për këtë ndeshje vendimtare, përgatitjet e ushtrisë osmane kishin filluar që në fund të vitit 1388. Murati I dha urdhër perandorak, ku iu bënte thirrje komandantëve të Anadollit dhe të Rumelisë, respektivisht të gjithë bejlerbejve të vilajeteve, djemve të tij, Bajazitit dhe Jakupit, disa princave nga Azia e Vogël si dhe sundimtarëve të krishterë, të cilët kishin pranuar vasalitetin ndaj shtetit osman, që me forcat e tyre të mblidheshin dhe të drejtoheshin për t'i mposhtur sundimtarët ballkanikë. Sulltanit i erdhi ndihmë “edhe nga persët, edhe nga arabët” dhe, në këtë mënyrë, u krijua një ushtri e madhe, në krye të së cilës qëndronin Sulltan Murati I dhe dy djemtë e tij, Bajaziti dhe Jakupi. Me qëllim që ta kishin më të lehtë këtë fushatë, forcat e mbledhura të ushtrisë osmane mendonin që atë ta nisnin në pranverë, prandaj u përqendruan dhe dimrin e kaluan në Filipopoli, Plovdiv (sot në Bullgari).

Përgatitjet e Muratit I i shqetësuan dhe i vunë në lëvizje sundimtarët e vendeve të ndryshme të Ballkanit. Për t'i bërë ballë rrezikut, zotërit e tyre lanë mënjanë grindjet dhe konfliktet e vjetra dhe iu përgjigjën thirrjes së knjazit serb të Rashës Lllazar Hrebljanoviçit. Formuan një koalicion nën kryesinë e Gjergji II Balsha, i cili që prej kohësh e kishte ndërre rrezikun osman, siç duket shumë kohë përpara Betejës së Kosovës. Që në vitin 1388, ai ishte angazhuar në përgatitjen e koalicionit antiosman. Lllazar Hrebljanoviçit, duke mos llogaritur kaq shpejt një përballje me osmanët, ndërmoi një fushatë pak para betejës së Fushë-Kosovës kundër Hungarisë. Kështu

u ndodh i befashuar kur mori vesh marshimin e osmanëve në drejtim të trevave ballkanase.

Pjesëtarët e koalicionit patën kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur dhe për t'u mbledhur në momentin e duhur. Kjo dëshmohej nga vetë kronistët osmanë, të cilët flasin mbi tratativat diplomatike ndërmjet të deleguarve të Muratit I dhe udhëheqësit të koalicionit, Lllazarit, ku preken çështjet për zgjidhjen e konfliktit të tyre dhe ku njëkohësisht mësohet për përgatitjet ushtarake të palëve kundërshtarë. Një rol udhëheqës në përgatitjen e koalicionit ballkanik patën edhe arbërit.

Zgjedhja e vendit dhe kohës së betejës

Përse u zgjodh Fushë-Kosova si vendi i betejës? Faktorët që çuan në përcaktimin e vendit të betejës, në Fushë-Kosovë, rreth 5 km në veri-perëndim të Prishtinës së sotme, ishin të karakterit strategjik, ushtarak dhe historik, të tillë si: mundësia më e mirë për organizimin e ushtrive feudale ballkanike, pozicioni strategjik ku kryqëzoheshin rrugët nga mund të marshonin më tej osmanët si dhe fakti që ushtria osmane kishte ndërkohë në kërcënim këtë trevë të Ballkanit. Terreni në jug të Fushë-Kosovës, të Malit të Sharit, ofron mundësi për depërtim të mbrojtur në zonën e Kaçanikut dhe Preshevës, duke dalë ushtritë direkt në Fushë-Kosovë.

Nga pikëpamja strategjike-ushtarake, Kosova zë një nga pozicionet më të rëndësishme në Ballkan, si pozicion strategjik, që përcakton në një shkallë të konsiderueshme fatin e Ballkanit Qendror. Kjo ka qenë arsyeja që shumë beteja me rëndësi, vendimtare për fatin e Ballkanit si ajo e Nemanjës kundër ushtrisë së Perandorisë Bizantine në vitin 1167, e Huniadit kundër turqve në vitin 1448 etj. janë zhvilluar pikërisht në Fushë-Kosovë. Nga zotërimi i kësaj treve do të varej shumë kontrolli i shteteve të Ballkanit dhe ndikimi në zhvillimet gjeopolitike dhe ekonomike të tyre.

Vetë Lllazari përcaktoi Fushë-Kosovën si vend beteje duke u mbështetur jo mbi bazën e kushteve që krijonte për suksesin e betejës, por duke “zgjedhur ndërmjet një perandorie

tokësore dhe një qiellore dhe mbi këtë vendosi përjetësinë e tij".⁴ Sipas përvojës serbe, ushtritë e tyre kanë shfrytëzuar këtë fushë-betejë për ndeshje, me qëllim që t'i ndalonin në fund të fundit ushtritë armike në lartësitë e Kopanikut.

Përcaktimi i datës u bë pikërisht nga serbët, pasi ajo ishte data e mbretit sllav më të lartë të luftës Svantovit (Sveti Vid) ose në shqip "*fitimtari/sunduesi i shenjtë*".

Strategjia e përdorur

Mbështetur në interesa të përbashkëta, koalicioni zgjodhi strategjinë e bashkëpunimit dhe të luftës së përbashkët të popujve ballkanas për të ndaluar marshimin osman. Kjo strategji, që kishte filluar të kristalizohej që në ndeshjet e para të zhvilluara në gjysmën e dytë të shek. të XIV-të, si në betejën e Maricës, u sintetizua plotësisht në betejën e Fushë-Kosovës (Prishtinë). Bashkimi dhe organizimi i forcave politiko-ushtarake në planin ballkanik, krahas atij të çdo vendi të veçantë, karakterizoi këtë bashkëpunim gjithnjë në rritje midis sundimtarëve feudalë ballkanas.⁵

Në prag të betejës u zhvillua një mbledhje e këshillit të luftës për të përcaktuar strategjinë luftarake që do të zbatohet në betejë. Bazuar në faktorët favorizues luftarakë dhe cilësitë luftarake të ushtrive ballkanase, u vendos që beteja të zhvillohet ditën, sipas propozimit të princit shqiptar, që në literaturë gjendet me emrin Gjergj (por ka të ngjarë të jetë Gjergji, gjyshi i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut) dhe jo natën, siç kishte propozuar udhëheqësi i koalicionit. Jo vetëm që gjykimi i tij qe i drejtë, por edhe miratimi i propozimit të tij në mënyrë unanime nga sundimtarët pjesëmarrës (duke përfshirë këtu edhe vetë Llazarin), është një dëshmi tjetër se sa autoritar kishte qenë ai në mesin e pjesëmarrësve të koalicionit, aq më tepër kur dihet se kishte një forcë të rëndësishme ushtarake.⁶

Në aspektin ushtarak, bazuar në qëllimin e luftës, strategjia e dy forcave ndërluftuese ishte ajo e shkatërrimit të forcave ushtarake të kundërshtarit, për t'i hapur rrugë objektivave të secilës palë.

Forcat pjesëmarrëse

Ndonëse të dhënat rreth sasisë së forcave janë kontradiktore, për shkak të burimeve dokumentare të pa-mjaftueshme, më e pranueshme për kohën është se ushtria osmane përbëhej nga 40.000 mijë luftëtarë, ndërsa forcat e koalicionit ballkanik prej 25.000 luftëtarë. Në përbërje të forcave osmane përfshiheshin jo më shumë se 2.000 jeniçerë,⁷ kavaleria roje e Muratit prej 2.500 vetë, 6.000 spahi, 20.000 azapsë dhe akinxhi si dhe rreth 8.000 mercenarë nga vasalët e tij nga Germianidia, Sarukhanidia, Perandoria Byzantine, Bullgaria, principatat jugore serbe në Maqedoni, të cilat ishin bërë vasalë të osmanëve.⁸

Në këtë betejë morën pjesë, si forca kryesore, ato të shtetit serb të Moravës, nën komandën e knajz Llazar Hrebljanoviçit, rreth 12.000 vetë, të shtetit feudal shqiptar të Balshajve, nën komandën e Gjergji II Balsha dhe të mbretërisë së Bosnjës nën komandën e mbretit Tvrtko I Kotromanië, i cili dërgoi në Fushë-Kosovë Vojvodën *Vlatko Vukoviëa*. Ndërsa si forca ndihmëse morën pjesë trupat kroate, rumune, bullgare, hungareze, vllehe, çeke, polake, etj. Feudalët shqiptarë Gjergji II Balsha, Gjon Kastrioti, Dhimitër Jonima, Theodhori II Muzaka dhe feudalë nga trevat e Himarës e të Epirit morën pjesë me forca të bashkuara, duke pasur rreth 6.000 luftëtarë,⁹ që përbënin një të katërtën e forcave koalicionit.

Forcat shqiptare ishin të organizuara mirë në formacione të rregullta ushtarake, të cilat i ruajtën gjatë zhvillimit të luftimit. Luftëtarët kosovarë morën pjesë të organizuar nën komandën e princit serb Vuk Mlladenoviç (i njohur Vuk Brankoviç), sundimtarit të Kosovës, njeriu i dytë në shtetin serb pas Llazarit. Gjithsej, nën komandën e Brankoviçit, ishin rreth

10.000 forca. Forcat e koalicionit i drejtonte këshilli i luftës, i cili përgatiti edhe planin e luftimit, ndërsa komandoheshin nga knjaz Lllazar Hrebeljanoviç.

Për të ardhur në Fushë-Kosovë, forcat osmane marshuan normalisht nga Plovdivi, në pranverë të 1389, në *Ihtiman*, përgjatë Velbuzhdit dhe Kratovo në Maqedoni, duke mos ndjekur rrugën kryesore të Ballkanit, atë nga Sofja përgjatë Luginës Nishava. Pas një pushimi në Kratovo për një kohë, Murati me trupat e tij marshuan nga Kumanova, Presheva dhe Gjilani dhe, më 14 qershor, mbërritën në Prishtinë.


Renditja e forcave

Më 28 qershor 1389 forcat e koalicionit ballkanik u gjendën përballë ushtrisë osmane në Fushë-Kosovë (Prishtinë). Pavarësisht se nuk ka burime të detajuara për zhvillimin e betejës, janë të njohura rreshtimet e forcave para fillimit të betejës, veprimet kryesore luftarake të dy koalicioneve si dhe përfundimi i betejës.

Ushtritë e koalicionit zunë nga një pozicion të veçantë në fushën e Kosovës. Vendosja e forcave të koalicionit për zhvillimin e luftimit u bë në përshtatje me idenë luftarake, organizimin ushtarak të formacioneve të secilës palë dhe cilësive individuale luftarake të tyre.

Forcat e koalicionit ballkanik patën këtë vendosje: Forcat luftarake shqiptare në formacione të rregullta u vendosën në krahun e djathtë të rendimit të luftimit, së bashku me ushtrinë kosovare, nën drejtimin e Vuk Brankoviçit; në qendër u vendosën forcat serbe që i drejtonte princi Lllazar; në krahun e majtë u vendosën forcat boshnjake dhe forcat e tjera ndihmëse nën drejtimin e prijësit Vlatko Vukotiç. Nisur nga aftësitë e spikatura luftarake, shqiptarët mbushnin, gjithashtu, edhe radhët e shigjetarëve të ushtrisë së koalicionit, që drejtoheshin nga prijësi Gjergji II Balsha. Në frontin e ushtrisë së serbe ishte kalorësia e rëndë dhe kalorësia e shigjetarëve në krahët, të mbuluar pas nga këmbësoria. Ndonëse paralele, formacionet e renditura të ushtrive nuk ishin simetrike. Ushtria e koalicionit si qendër kishte një front më të gjerë se qendra osmane.¹⁰

Forcat turke u rreshtuan: në qendër drejtonte vetë sulltan Murati I, në krahun e djathtë të rendimit të forcave turke drejtonte djali i madh i tij, Bajaziti I dhe në krahun e majtë djali i vogël, Jakubi. Rreth 1.000 shigjetarë ishin rreshtuar në vijë frontale në krahët, mbuluar nga azapët dhe akinxhinjtë; në frontin qendror ishin jeniçerët, pas tyre vinte Murati, i rrethuar nga garda e tij kavaleri; së fundi, një karvan furnizimi në pjesën e pasme ruhej nga një numër i vogël trupash.¹¹ Greku Evremos Beg ishte specializuar në kundërspiunazh dhe rezistencë ndaj strategjisë kristiane. Komandant i artilerisë osmane ishte i ashtuquajtur Haidar. Artileria ishte vendosur pas trupës luftarake, goditjet e së cilës në këtë betejë u përdorën si asnjëherë tjetër më parë.



Trupa luftarake e të dy palëve përbëhej nga këmbësoria, kalorësia dhe shigjetarët. Të dy palët ndërluftuese zotëronin artileri. Edhe ushtria serbe kishte artilerinë e saj, topat e parë të së cilës i kishte importuar dhe vendosur në ushtrinë që më 1373, ndërsa 1385 u derdhën në Serbi. (skema nr. 1).

Zhvillimi i betejës

Duhet thënë se është shumë e vështirë të rindërtosh skenën dhe rrjedhën e veprimeve luftarake. Por besohet se beteja nisi më 28 qershor 1389, me sulmin e shigjetarëve të koalicionit, nën komandën e Gjergji II Balsha. Më pas kalorësia e koalicionit ballkanas u hodh në sulm. E pozicionuar në një formacion në formë V-je, kalorësia arriti të thyejë krahun e majtë të osmanëve, por nuk ishte njëllëj e suksesshme kundër qendrës dhe krahut të djathtë. Artileria osmane hapi zjarr duke hedhur gjyle dhe gurë në afërsi të vijave para kalorësisë të forcave të koalicionit (kristiane). Qëllimi i artilerisë osmane ishte të bënte goditje të saktë për të ndaluar përparimin e kalorësisë. Ajo nuk synonte rrënimin e luftëtarëve, por ishte parashikuar veprimi psikologjik i saj. Breshërinë e artilerisë e ndoqi një shi shigjetash të shigjetarëve osmanë, goditje që pati vetëm veprim të dobët, më shumë psikologjik, duke trembur vetëm kuajt e kalorësisë së koalicionit.

Kalorësit e rëndë kalëruan me galop të madh mbi shigjetarët osmanë, të cilët kërkuan të shmangeshin dhe pastaj të kërcenin. Në këtë kohë shpërtheu kalorësia osmane, e cila kërkonte të kapte këmbësorinë pas kalorësisë së koalicionit ballkanik. Forcat e krahut të majtë thyen tentativat e Bajazitit, si dhe korrespondencën e tij për në krahun e majtë të ushtrisë osmane, nën Jakubin që ishte kërcënuar rëndë. Në qendër kalorësit e koalicionit ballkanik shpërthyen shtigje të gjera në radhët osmane. Fillimisht veprimi i krahut të djathtë osman, nën komandën e Bajazitit e shmangu një humbje të sigurt të osmanëve.¹² Më pas, të dy krahët qëndruan në pozicionet e tyre për rigumbullimin e tyre.

Disa autorë tregojnë se në mes të veprimeve luftarake, Brankoviçi i largoi trupat e veta (rreth 7.000 veta) nga koalicioni, me pretekstin për të ruajtur trupat meqenëse humbja dukej se ishte e afërt, siç duket në zbatim të një qëllimi të fshehtë të tij për të ardhur në krye të mbretërisë serbe.

Beteja vijoi gjatë gjithë ditës. Afër mbrëmjes ende nuk ishte përcaktuar fati i betejës. Kundërshtari i mblodhi forcat e i tërhoqi në kampin e tij. Ka të ngjarë që vazhdimi i luftimeve të jetë ndikuar nga interesa e veprime individuale të drejtuesve të formacioneve luftarake të të dy palëve, gjë që përcaktoi edhe rezultatin e betejës. Njihet fakti se një rol domethënës për fatet e betejës luajti shqiptari Millosh Kopili, heroi kryesor i betejës, i cili arriti të depërtojë deri në çadrën e sulltan Muratit I dhe ta vrasë atë. Llazari, i ndodhur në mendime në çadrën e tij, u ndodh papritur para një kalorësi të fuqishëm osman, pa shanse të luftonte ose të largohej. Ai u morr prej tij dhe përfundoi i zënë rob në kampin osman, ku u verbua me zjarr nga rrëmbyesit. Ai nuk mund ta besonte që përpara tij, në anën e osmanëve, ndodhej dhëndri i tij Vuk Brankoviçi, tradhtar.¹³ Car Llazari u ekzekutua aty pranë kufomës së sulltan Muratit I, në hakmarrje.

Përfundimi i betejës

Njoftimet mbi përfundimin e betejës janë kontradiktore. Francezi Meziers, prifti rus i quajtur Ignatij, anale raguziane anonime nga Dubrovniku dhe lajme nga mbreti Tvrtko I në *Florenz* dhe *Trogir* trumbetonin fitoren e kristianëve. Edhe në Paris kambanat e Kishës *Notre Dame* njoftonin fitoren e Kristianizmit. Kjo betejë u trumbetua si beteja mes Europeanëve dhe Aziatikëve, apo mes myslimanëve dhe katolikëve.

Për shkak të epërsisë ushtarake dhe ekonomike, me gjithë qëndresën heroike të pothuajse të gjithë ushtrive të koalicionit, ballkanasit pësuan disfatë të rëndë. Të dy ushtritë i humbën prijësit e tyre, ndërsa nga prijësit shqiptarë u vra, në fushën e betejës, Theodhori II Muzaka. Më tej flitet për humbje të mëdha nga të dy palët për të cilat ka të dhëna se kanë qenë në shifra pothuajse të barabarta: d.m.th. në rreth 30 përqind të efektivit të ushtrisë osmane kundrejt rreth 50 përqind të koalicionit ballkanas.

Përfundime për artin luftarak:

- Ndërtimi i formacioneve të të dy ushtrive për zhvillimin e betejës u bazua në strategjinë e mbrojtjes aktive, duke synuar asgjësimin frontal të armikut, fillimisht me zjarrin e shigjetarëve dhe më pas me luftime të ashpra. Strategjia e zgjedhur dhe zotërimi i informacionit të plotë mbi forcat dhe mjetet e kundërshtarit duket se kanë qenë faktorët që kanë ndikuar në mos mbajtjen e rezervës nga asnjëra palë ndërluftuese.
- Ndonëse forcat që u ndeshën në këtë betejë vendimtare përbënin ushtritë më moderne të kohës, me një përvojë të pasur në luftëra, janë disi të pakuptueshme mungesa e disa elementëve taktikë. Në veprimet luftarake të të dy ushtrive u dallua një manovër e lehtë për krahëmarrje, por pa forcën dhe momentin e duhur për sukses taktik apo epërsi në një drejtim të caktuar. Asnjëra palë nuk zbatoi elementin e befasisë për t'i diktuar kundërshtarit përparësi taktike, ashtu sikurse nuk dallohet asnjë element i përdorimit të maskimit e të mashtrimit të kundërshtarit.
- Thelbësore për fitoren e osmanëve ishte, sidoqoftë, “ushtria e skalionuar”,¹⁴ nënrepartet e bashkuara kundërshtarë të së cilës nuk ishin në numër të madh për krijimin e epërsisë numerike, si dhe thellësia e tyre e skalionimit nuk siguronte forcën e duhur në kundërpërgjigje ndaj forcave osmane.
- Sidoqoftë, rezultati i betejës nuk ishte rrjedhojë e artit luftarak të përdorur nga palët ndërluftuese. Ai nuk ishte përfundim logjik i planit operacional të përpunuar dhe

strategjisë së zgjedhur për betejën në kushtet konkrete të terrenit, kohës dhe forcave ndërluftuese.

Fakte të tilla si: koha relativisht e gjatë e përgatitjeve për betejën; tërheqja e një pjese të madhe, por jo asaj të udhëhequr nga princa shqiptarë, të forcave të Vuk Brankoviçit vetëm pak kohë pas fillimit në të betejës; mungesa e disa elementëve taktikë të kohës në veprimet luftarake të të dy palëve si dhe vrasja e të dy prijësve të ushtrive dhe ekzekutimi i disa princërve serbë, në përfundim të betejës nga osmanët; fshehja apo zhdukja e pothuajse të të gjithë dokumenteve të betejës; mungesa e theksuar e tyre për veprimet luftarake, në fazën përfundimtare të betejës, me gjithë prezencën e kronistëve dhe të vëzhguesve madje edhe nga Venecia, na japin të drejtën të arrijmë në përfundimin se fati i betejës ishte i paracaktuar në skenarë të fshehtë, të organizuar nga princa të interesuar për fron të të dy palëve në betejë.

Kështu, veprimet e fundit të betejës nuk u mbështetën në strategjinë e zgjedhur. Mbi këtë bazë, nuk mund të thuhet me siguri se cili art ushtarak fitoi: arti ushtarak ballkanas apo ai i osman.

- Informacione të tilla si paniku dhe dezertimi i një pjese të forcave të koalicionit ballkanik, vrasjet e disa princërve etj. të çojnë në përfundimin se uniteti i komandimit dhe kompaktësia e trupave të këtij koalicionit në fazën e fundit të betejës duket se është shkatërruar, faktorë që kanë ndikuar ndjeshëm në rezultatin përfundimtar të betejës.
- Pavarësisht se rezultatet e kësaj beteje u trumbetuan në perëndim si triumf i krishterimit, ndërsa në lindje si triumf i muhamedanizmit, vlerat politike-ushtarake të kësaj beteje përbëjnë një gur themelor në zhvillimet Ballkanike të 4-5 shekujve që pasuan dhe më tej deri në ditët e sotme.

Vlerat dhe rrjedhojat e më pasme

Beteja e Fushë-Kosovës e vitit 1389, si pika kulmore e qëndresës së popujve të Ballkanit Qendror dhe Perëndimor kundër vërshimit osman, të zhvilluar në vitet '70-80-të të shek. të XIV-të, është faqja më e ndritur e bashkëpunimit ushtarak midis popujve ballkanikë, nën interesa të përbashkëta. Krahas ushtrive të tjera, ushtria shqiptare dhe arti i saj luftarak, nën udhëheqjen e prijësve të saj, luajtën një rol të rëndësishëm në zhvillimin e betejës, duke dëshmuar shpirtin liridashës e atdhetar shqiptar. Kontributi shqiptar në këtë betejë ishte pa rezerva, duke i qëndruar besnik koalicionit, pavarësisht nga përfundimi i betejës, për të cilin ata nuk janë përgjegjës në asnjë rrethanë.

Fitorja e osmanëve në betejën e Fushë-Kosovës ishte me pasoja katastrofale për Ballkanin. Me marshimin e pandalshëm të ushtrive osmane i erdhi fundi pavarësisht së shteteve feudale të Gadishullit, të cilët u bënë vasale të Perandorisë Osmane. Djali i L Lazarit, princi Stefan Llazareviç u detyrua të lidhte paqe e të pranonte vasalitetin, duke paguar tribut vjetor dhe të dërgonte trupa ndihmëse për osmanët për çdo fushatë. Në vitin 1405, ushtria e Stefan Llazareviç u ndesh fitoi me ushtrinë e djalit të Vuk Brankoviçit, Gjurarxh Brankoviçit, i cili u detyrua të pranojë sundimin e xhaxhait të tij.¹⁵ Kjo fitore i hapi rrugën sulltanit pasardhës, Bajazitit I, për pushtime të reja në Ballkan, duke pushtuar tërësisht Bullgarinë në vitin 1393, Rumaninë në 1394 etj.

Gjatë sundimit të tij, turqit arritën të vendoseshin diku përkohësisht e diku përgjithmonë, në viset e tjera shqiptare, që nga Shkodra e Kruja dhe deri në rajonet e Korçës e të Përmetit. Vendi ynë pësoi një copëzim të madh politik. Duke qenë ushtarakisht të pafuqishëm përgjithësisht, feudalët shqiptarë hynë nën vasalitetin e sulltanëve dhe nxituan të lidheshin me vende të tjera. Sapo erdhi në pushtet, sulltan Mehmeti I (1413-1421) mori masa energjike për rivendosjen e zgjerimin e pushtetit osman ndaj sundimtarëve shqiptarë që përkohësisht i

kishin forcuar pozitat e tyre dhe, gjatë viteve 1415-1417, ushtritë e tij pushtuan një tërësi të rëndësishme shqiptare.

Në betejën e dytë të Fushë-Kosovës, në vitin 1448, midis osmanëve dhe hungarezëve fituan përsëri osmanët, të cilëve iu hap rruga në drejtim të Evropës, deri në Vjenën Habsburge.

Pavarësisht nga përfundimi dhe pasojat e saj që përcaktuan pothuajse fatin e popujve të Ballkanit, beteja e Fushë-Kosovës përbën një kapitull brilant në historinë ballkanike të mesjetës. Sikurse shprehet studiuesi shqiptar Stefanaq Pollo, ajo është një dëshmi e shpirtit lirisht të popujve të Ballkanit, të cilët kishin krijuar tashmë një bazë për bashkimin e tyre, të godisnin përsëri agresorët dhe të mbronin pavarësinë e vendeve të tyre.¹⁶

Bibliografia:

- Historia e Popullit Shqiptar I. Botim i Akademisë së Shkencave. Botimet Toena. Tiranë, 2002.
- Hans-Henning Kortüm, *Transcultural Wars from the Middle Ages to the 21st Century*, Akademie Verlag, 231.
Cituar në http://en.wikipedia.org/wiki/Battle_of_Kosovo.
- Matthias Schoenfeldt, *Die Schlacht auf dem Amselfeld*.
- Petrika Thëngjilli, Historia e Perandorisë Osmane. Botimi shblu. Tiranë, 1997.
- Pjetër Hidri & Kadri Dauti, Historia e Artit Ushtarak e Popullit Shqiptar, pjesa I. Botim i MM. Tiranë, 2006.
- Qerim Dalipi, artikull, tetor 2007.
- Selami Pulaha, Shqiptarët dhe beteja e Fushë-Kosovës e vitit 1389. *Studime Historike*, Nr. 4/1990.
- Stefanaq Pollo, *Shqiptarët dhe beteja e Fushë-Kosovës*. Revista “Shqipëria sot”. Nr. 3/1989.
- Kosovska bitka, *Enciklopedia ushtarake*. Beograd, 1972.
Cituar në http://en.wikipedia.org/wiki/Battle_of_Kosovo.
- http://www.kalkriese.de/Schlacht_auf_dem_Amselfeld.html,

Referenca

- ¹ Thëngjilli, Petrika: Historia e Perandorisë Osmane. Botimi shblu. Tiranë, 1997. fq. 20.
- ² Historia e Popullit Shqiptar I. Botim i Akademisë së Shkencave. Botimet Toena. Tiranë, 2002. fq. 374.
- ³ Po aty, fq. 377.
- ⁴ http://www.kalkriese.de/Schlacht_auf_dem_Amselfeld.html, datë 10.08.2011.
- ⁵ Hidri, P. & Dauti, K.: Historia e Artit Ushtarak e Popullit Shqiptar. Botim i MM. Tiranë, 2006. fq. 93.
- ⁶ Dalipi, Qerim: artikull në www.albforumi.com, tetor 2007.
- ⁷ Hans-Henning Kortüm, *Transcultural Wars from the Middle Ages to the 21st Century*, Akademie Verlag, 231.
- ⁸ Kosovska bitka” (në Serbo-kroatisht). *Vojna Enciklopedija*. Belgrade: Vojnoizdavacki zavod. 1972. fq. 659, cituar në http://en.wikipedia.org/wiki/Battle_of_Kosovo.
- ⁹ Pulaha, Selami: Shqiptarët dhe beteja e Fushë-Kosovës e vitit 1389. *Studime Historike*, Nr. 4/1990, fq. 169.
- ¹⁰ Kosovska bitka” (in Serbo-Croatian). *Vojna Enciklopedija*. Belgrade: Vojnoizdavacki zavod. 1972. fq. 660, cituar në http://en.wikipedia.org/wiki/Battle_of_Kosovo.
- ¹¹ Kosovska bitka, *Vojna Enciklopedija*.
- ¹² http://www.kalkriese.de/Schlacht_auf_dem_Amselfeld.html, datë 10.08.2011.
- ¹³ Schoenfeldt, Matthias: *Kosovo für Anfänger. Die Schlacht auf dem Amselfeld*.
- ¹⁴ http://de.wikipedia.org/wiki/Schlacht_auf_dem_Amselfeld, datë 15.08.2011.
- ¹⁵ http://www.kalkriese.de/Schlacht_auf_dem_Amselfeld.html, datë 10.08.2011.
- ¹⁶ Pollo, Stefanaq: *Shqiptarët dhe beteja e Fushë-Kosovës*. Revista “Shqipëria sot”. Nr. 3/1989.

Summary in English of the Military Review

Strategic Defence Review

What set of scenarios will the AAF be prepared for, as an allied country?

Col. (R) Thimi Hudhra,
Chief of the Centre for Defence Analyses, TRADOC

MA Adriatik Mema,
General Director of Security and Defence Policies, MoD

Abstract. The readers of the Military Review are informed over the process of the Strategic Defence Review which is being conducted in the Republic of Albania. This Review is being carried on in close compliance to the messages of the New Strategic Concept of Lisbon and Political Guidance of the Alliance.

The Strategic Defence Review is led by the MoD Group for the Strategic Defence Review (SDR) with the participation of all the other security institutions of the country and in collaboration with an US team, supported by the US Department of Defence.

The Strategic Review is actually in its Third Phase: development of strategic Scenarios the Armed Forces will be engaged in the forthcoming years. Up to nowadays, Albania has used certain scenarios as a partner and candidate country, but they are not actualized to the new NATO membership situation.

The aim of the authors is to give an overall planning framework of the strategic and operational scenarios regarding the engagement of Armed Forces of the Republic of Albania, as a member country of NATO. The development of a set of real future scenarios will guide the reforms ahead for the development of the military and civil capabilities for the next decade.

This article precisely deals with the followed approximation in this phase of the Strategic Defence Review as for the development of a package of future scenarios. This package will drive the process organization, training and equipment of the future force. We welcome all the readers to give their opinion in this process.

The Review of Defence Strategy

Colonel Tonin Marku,
Military Representative of RA in ACT, Norfolk, USA

Abstract. The impact of NATO New Strategic Concept is of an important value for Albania, as the youngest member of the Alliance. One of the main declared issues of both political and military levels of our country in NATO is the Defence Planning Review Process.

Now, AAF are in the phase of the development of the Strategic Defence Review which focuses on the review of the documents of the National Security Strategy (NSS), the Military Strategy (MS), the Long-Term Development Plan (LTDP), together with the development of Capability Targets with the Alliance.

Generally speaking, the Military Strategy derives from the National Security Strategy, which is by so far the fundamental document at the national security level. It brings under common denominator all other instruments of the national power, such as the political, diplomatic, economic, military and information, together with the moral values to successfully accomplish the national objectives.

To develop a stable NSS, it is thereby equally important to reach a political consensus. The latter is regarded as one of the cornerstones of NSS. The defence strategy and its review follow the same periodic phases of the process: initiation, formulation, analysis, approval, publication, implementation, review and follow-on improvement.

The follow-on implementation of the Military Strategy (MS) and its transformation to an active document is a very important moment. This occurs only if the process is performed by including all the interested actors, by following the pre-allocated processes and by setting up a special structure as for the monitoring of all its phases.

Reflections over Education in the European Defence Academies

Major General (R) Shpëtim Spahiu

Col. Prof Kristaq Xharo,
NATO Advisor to the Chief of General Staff of AAF

Abstract. The military education has called the attention of the intellectual and political elites of the west for the special importance and effects it convey to major issues such as security and defence. In spite of the methods used, the mere fact that the philosophies of the military education of the main Western and Eastern schools are thereby brought closer in their operational and strategic level, shows that they have definitely produced a common standard tendency.

The mission of education, in general, and more specifically of the military education, together with the reflection after great important events in the history of society, has been to anticipate quite proportionally, over the events which may be part of the history.

The aim of this research paper is to reflect the tendencies of the education philosophy, particularly in the last 100 years, and, based on these grounds, to express their reflection in the short and midterm future, in order to give a modest contribution to the approximation of our education philosophy with that of the Alliance. We do hereby think that two will be the most interesting developments which will surely make it possible for reflections in the future: the first will be the “*Military Erasmus*” program - the programme which is under-way in NATO countries, under the Consortium of military Academies, as a philosophy of the European countries’ development for the level of junior officers.

On the other hand, the 100% upturn in the “Master” level and the full integration of defence and security issues for the college studies at staff level. All these tendencies and philosophies shall be assessed and reflected upon while following the same rhythm and standard.

The Albanian Military Education vis-a-vis Integration Challenges

Dr. Simon Gega,
Lecturer in the Academy of Defence “Spiro Moisiu”

Abstract. The Albanian military education, and more specifically, the education of young officers has been amongst the most disputable issues of this period of democratic developments. Under this framework, in assessing the military education to be far from ready-made copies and clichés, I have therefore considered it as the most important aspect of the national identity. This makes me observe, now and then, the military education as a part of our national education, and in no way, as a copy of other countries.

At the same time, while we talk about solutions as products of an all-inclusive participation and productive experiences, it often dominates a “surprising solution” which is based on the slogan “this is well known by somebody else”, the name of whom is never made public. However, the desire of swiftly reaching the same standards with those of our partners has often imposed us to adopt cliché models, which because of different social conditions and economic and social level of development, have no chance to succeed.

Personally, I do thereby estimate the good will to find such a model, but the real mistake is that we tend to overestimate the cost to the quality of these models. In this context, we very often argue by saying “we can not afford that, there is a high cost, we have no need of such officers”, etc, and always and forever being trapped in this sort of cycle.

Two years ago, TRADOC developed a wide scientific debate in Vlora, concerning the long term vision of military education. The brainstorming method of the discussions was the best – it favoured the inclusion of the military education as a constituent part of the higher education system of the country. It was therefore highlighted the importance of the development of an all-inclusive concept in which the Armed Forces should have the most attractive system for our society. Further, the brainstorming generated new ideas regarding the inclusion of civilians of the security sectors in the higher level courses of the Defence Academy.

With this vision, the first efforts to build an higher accreditation education system were successfully completed. The education programs were built up in modules, with completely clear objectives, placing the entire system at a logical building block policy. Study programs were later opened and attended by a great number of civil and military personalities of different levels. Then, the classes and auditoriums of the military education will be attended by other civilian citizens of various security sectors.

Calories of Physical Training and Exercises

MSC Valbona Zeka,
Lecturer in MA “Skënderbej”

Abstract. The physical performance level of a soldier influences directly on the preparedness of combat. The medical research studies headed by medical experts concerning the effects which regularly participate on the physical programs of maintenance and development of physical capacities have concluded that a healthy physical program increases a person’s life

quality, his productivity and brings about physical and mental changes in such a way that a person seems, lives and is thereby healthy to perform his duty.

The commanders and leaders may heretofore utilize this information in presenting an intelligent development, programs for maintenance, development of the physical capabilities and alimentation of the detachment or unit. Officers in command responsible for the training, lecturers and even instructors (assistant instructors) of the physical preparation shall ensure that all the military officers (officers, NCO-s and professional soldiers) maintain a high physical level in accordance to these instructions, policies and procedures for a new program of maintenance and development of physical capabilities of the Armed Forces personnel.

Importance of Strategic Communication

Docent: Jaup Zenuni,
Chief of Written Documents Translation Section in the Foreign Language Centre,
Academy of Defence “Spiro Moisiu”

Abstract. Strategic communication is an important aspect of the communication science with a growing priority in the last years. In theory, it has been treated and developed only in the second half of the XX century, precisely in the formulation of the Marshall Plan as a way of confronting the communism in the post Second World War Europe. In practice, it is recognized since the tribal and pre-modern societies.

By origin, the term strategic communication is a military term, but as time passed by, it has widened its domain in housing other terms such as: information operations, propaganda, public affairs, public diplomacy, or media operations.

Nowadays it is recognized as very prominent component of Soft Power. In this context, NATO, US and Great Powers along the years have dedicated peculiar importance to this component. Particularly after the 9/11 attacks, it has been given a high priority not only in the academic circles, but mostly in the compilation of strategies, plans, policies and institution development, which above all deal with strategic communication.

As a NATO member country, Albania shall accept the principles of strategic communication and undertake appropriate steps for the implementation of the strategic communication theory.

Fushë-Kosova' Operation of 1389 and its Military Art

Lieutenant Colonel (R) Kadri Dauti

Abstract. Fushë-Kosova Operation (1389), between the Balkan coalition armies and the Ottoman Empire occupies a very important part in the history of the Balkans. It comprises one of the most questionable operations ever happened, due to its role and place of the Balkan coalition armies in it.

Many Balkan authors have stressed the importance of the historic aspect and epos of this operation. Nonetheless, their works are depicted as biased and subjective. Nowadays, at a time when the Balkan peoples are connected with cooperation and integration processes in the civilized Europe, this operation shall well serve as a vintage basis of their unity, under mutual interests.

This article aims to give a full treatment and analysis of the military art as utilised in this battle by two of the most powerful and modern armies of the time. The attention is paid to strategies and tactics conducted by the belligerent parties and their impact on the operation end states.

The author judges that such an objective treatment of the entire military spectrum of this operation would serve not only to the military officers, but it would also make it possible for the outgrow of respect as for the contribution of each Balkan country for the liberty of their own peoples. The Balkan countries, based on the experience ashes of this combat shall tent to enhance the mutual efforts as for the development of more effective strategies on consolidation of security, for a stable political development, and a secure Euro-Atlantic future of the region.

The Development of the Military Doctrine in a Transformed Security Environment

Colonel Ahmet Leka,
Chief of Doctrines and Manuals' Centre

Abstract. The development of the Joint Doctrine of the Armed Forces of the Republic of Albania is being performed based on the concepts of the Military Strategy and the activity of the Armed Forces during the preparation and development of the operations. The Military Strategic Concept constitutes the basis of the Joint Doctrine. The Joint Doctrine shall be a standardized document employed by the Armed Forces. Based on the Joint Doctrine and AAF organization structure requirements for doctrine documents, it is necessary to formulate and approve the entire AAF doctrine hierarchy.

New risks and threats to security and defence and the change on the nature of conflicts are imposing related changes in the doctrine hierarchy. Change of the nature of wars are closely linked with their character, their dimensions and effects, growth of non-conventional risks and threats, terrorism, energy security, cyber threats and climate changes, hybrid challenges, growing widespread of asymmetric warfare.

Along with the conventional and unconventional arms and tactics in the battlefield, they do thereby require an outgrowing commitment of our Armed Forces and an all-inclusive treatment towards the operations in order to face these brand new threats and risks, as well as reflect this new reality of challenges on the development of the new military doctrines.

The Ethics Code and Leadership

Dr. Edmond Braneshi

Chief of the Military Leadership Section, Academy of Defence “Spiro Moisiu”

Abstract. The Ethics Code is a “powerful weapon” on the leader’s hands. The latter shall utilize it for the establishment of a rather pleasant environment and a favourable command climate. It has to do directly with the strengthening of leader-subordinate relationships, which shall be of the superior level and responsive towards the mission accomplishment.

In order to have an effective Ethics Code, the leaders shall be based on some keystones which may serve as strong foundations for cementing the relationships with their subordinates. Consequently, they will not be based only on duty service but even on the progress achieved. These keystones consist of: de-mystification, estimation, mutual respect on thoughts, communication ethics, being thankful to the subordinates, group ethics or inclusion of subordinates in projects. All these do constitute the necessary “infrastructure” of the leader to be successful and, at the same time, these are challenges which he will be constantly exposed.

“Obama Doctrine” – The American Global Strategic Leadership

Granit Zela,

Lecturer in the Foreign Language Center
Academy of Defence “Spiro Moisiu”

Abstract. The use of Soft Power, as a very prominent instrument of Diplomacy, the reorientation of the American military power in Afghanistan, Iraq, Pakistan and even broader, the cooperation with international organizations and the partnership - the latter as a dictated need by the global reality - have well served as starting point for a great number of academics, researchers and analysts of International Relations in pursuing the outline of the guiding principles of “Obama Doctrine”.

In accordance with “Obama Doctrine”, the leadership of the US superpower in the world is not always considered as taken for granted (the case of Libya and the different engagement levels of US in the uprising events of Middle East countries), but is widely based on the performance of smart choices by a smart power, premeditated choices of how, when and who is it to be led within the international arena. The analysis has also to be placed under comparison with the doctrine of his forerunner US president, George W. Bush, which main doctrinal principles were explored in the previous edition of the Military Review (June, 2011).

Illegal Emigration,

Organized Crime and Terrorism

Sub/Commissar Renaldo Ndoni
Specialist in the Closed Centre for Foreigners

Abstract. This research paper shall dwell the illegal emigration phenomena, as a social phenomenon and disturbing problem for all the region countries and even its relation to the organized crime, trafficking of human beings and terrorism. The organized crime is placing the society at growingly higher stake every day, while terrorism is threatening the normal functioning of various countries. The opinions expressed in this article are lessons learned from my professional experience in my duty dealing with the illegal emigration in Albania. In absence of related literature, they are mostly based on interviews given by detained foreigners at the Closed Centre.

Albania is a linking bridge between east and west. Its geographical position may favour the illicit trafficking phenomenon as a transit country. Irregular emigrants are expected to bring problems to the internal security. The prevention of the consequences of irregular emigration is achieved only by enhancing the collaboration level between all the police sectors of national and international level.

KUJTESË

PËR BASHKËPUNËTORËT E REVISTËS USHTARAKE

Të nderuar bashkëpunëtorë të Revistës Ushtarake!

“Revista Ushtarake” është një Revistë kërkimore me fokus teoriko-shkencor. Ajo është revistë e elitës ushtarake të FA dhe e analistëve të spikatur civilë që, nëpërmjet shkrimeve të tyre synojnë jo vetëm të informojnë, por në radhë të parë të ofrojnë zgjidhje për çështjet më të rëndësishme të reformës së sigurisë dhe të mbrojtjes në nivel strategjik, operacional dhe taktik. Pra, prioriteti numër një i RU janë vlerat aplikative të krijimtarisë origjinale të autorit.

Edhe njëherë ftojme studentët e talentuar ushtarakë, akademistët e sistemit të kurseve të larta të AM, studentët e Programit të Masterit Shkencor, doktorantët e ardhshëm, instruktorët, pedagogët, punonjësit kërkimorë, analistët, komandantët, shefat dhe trajnuesit e të gjithë institucioneve e njëjësive të FA të RSH, analistët e pavarur civilë apo ushtarakë në fushën e sigurisë e të mbrojtjes, që të angazhohen dhe organizohen për ndërtimin e komunitetit të tyre tepër të nderuar e të respektuar të punës kërkimore.

Në vijim Redaksia e RU jep disa udhëzime e të dhëna teknike për strukturën e artikujve të autorëve (bashkautorëve) të Revistës Ushtarake, të cilat duhet të respektohen prej tyre.

Struktura e artikullit

Titulli. Emërtimi i artikullit.

Autori, Bashkautori: Jepet autori apo bashkautorët e artikullit.

Abstrakti: Është pjesa që paraprin një artikull (trajtesë). Tek abstrakti/përmbledhja autori shkurtimisht duhet të paraqesë karakteristikat e artikullit (thelbin apo çështjet themelore të trajtesës, synimet e autorit, këndvështrimin, përfundimet apo rekomandimet, etj.). Abstrakti nuk zëvendëson parathënien e vetë artikullit. Ai zë rreth 1/2 e faqes dhe nuk duhet t’i kalojë 400 fjalë.

Paraqitja, gjatësia: Pjesa kryesore e shkrimit (përfshirë parathënien dhe përfundimet) shkruhet në gjuhën shqipe dhe duhet të jetë maksimumi 6-8 faqe kompjuterike (15 000-25 000 shkronja e shenja, duke përfshirë edhe boshllëqet) përfshi edhe “endnotes” dhe informacionin shtesë.

Formati: Faqja duhet të jetë e formatit A4; Lloji i shkrimit: “Times New Roman”; Madhësia e shkrimit 11.5. Kryeradha (Paragrafi i ri) përcaktohet me një rresht bosh. Paraqitja e tekstit të jetë e thjeshtë dhe në minimum të alternativave të stileve dhe formatimit. Kapitujt nuk duhet të jenë të numëruar; teksti duhet të jetë një strukturë me maksimumin 3 nivele. Duhet të shmangen tekstet e theksuara me bold apo shkronjat me ngjyra. Shkrimi i pjerrët dhe thonjëzat duhet të përdoren vetëm për citimet e burimeve të përdorura dhe literaturës.

Grafikët, tabelat dhe imazhe të tjera duhet të bëhen të formatuara në grup duke evituar shpërbërjen e tyre. Ato duhet të vendosen sa më qartë në një pozicion të përshtatshëm pranë tekstit që i shpjegon ato. Të gjitha imazhet duhet të pasqyrohen në mënyrë të tillë që lexueshmëria të mos ndikohet nga reduktimi i madhësisë dhe printerët bardhë e zi. Nëse një imazh është marrë nga një burim tjetër, është e domosdoshme që të citohet burimi respektiv i tij.

Artikujt duhet të dërgohen të printuar dhe në mënyrë elektronike në Redaksinë e Revistës Ushtarake. Për ato artikuj që nuk i plotësojnë kërkesat e mësipërme të formatit dhe të gjuhës, Redaksia vendos nëse do t'i rikthehen autorëve për përmirësim, apo do të përjashtohen nga procesi i paraqitjes në Bord.

Dokumentacioni: Redaksia e RU vlerëson me rëndësi të veçantë paraqitjen nga çdo autor të artikujve e trajtesave me referenca dhe “footnote” si dhe në fund të materialit të vendosë literaturën e shfrytëzuar. “Footnote” duhet të respektojnë në mënyrë korrekte rregullat kombëtare e ndërkombëtare ku të përfshihen; Mbiemri, emri (autorit që i referohet), titulli i materialit të referimit, emri i entit botues, vendi i botimit, viti i botimit, numri i faqeve ku referohet, numrin ISBN, website-in ku ndodhet artikulli. (*p.sh. Smith, James. Siguria në Shekullin e 21-të: Histori e panjohur. 2nd edition. New York, London: Oxford University Press, 2006. 235 p. ISBN 0071448209, <http://www.iir.cz/display.asp?lng=uk&ida=>*)

Biografia: Së bashku me shkrimin, autori të dërgojë edhe një përshkrim të shkurtër biografik me rreth 100 fjalë ku të përfshijë: emrin, mbiemrin, gradën, pozicionin e punës, arsimimin, angazhimet kërkimore, fotografinë, numrin e telefonit dhe adresën elektronike.

Stili: Shkrimi duhet të prezantojë një strukturë të thjeshtë, duke përdorur tituj dhe nëntituj. Është e rëndësishme që në fund të shkrimit autori ta mbyllë me disa përfundime dhe rekomandime nga ky artikull.

Artikulli nuk duhet të përmbajë material të klasifikuar dhe duhet të zbatohet rregullat e klasifikimit të informacionit.

Artikulli nuk duhet të përmbajë ngjyrim/qëndrime politike apo partiake.

Për çdo shkrim autorët do të marrin edhe shpërblimin përkatës, sipas ligjeve në fuqi.

Për informacion të mëtejshëm, mund të kontaktoni me:

Dega e Botimeve (Redaksia e RU), Qendra e Analizave të Mbrojtjes, Komanda e KDS

Mail: Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes, QAM, Dega e Botimeve

Kutia Postare 24 23, Rruga e Dibrës, Tiranë, Shqipëri

Nr. Tel: 00355(4)23 63 465 ose 516/ 1037, 516/1076

Nr. Fax: 00355(4)23 69 179

Mobile: 0674066411

Email: revistaushtarake@aaf.mil.al

Redaksia e Revistës Ushtarake

Shtypur në shtypshkronjën “Grand Prind”
Rruga “Mihal Grameno”, Nr.180, Tiranë
Tel.&Fax.+355 4 2452701